



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT PËR ADMINISTRATË PUBLIKE,
PUSHTET LOKAL, MEDIA DHE ZHVILLIM RAJONAL,
E MBAJTUR MË 20 DHJETOR 2022**

**SA SEDNICE KOMISIJE ZA JAVNU ADMINISTRACIJU, LOKALNU
SAMOUPRAVU, MEDIJE I REGIONALNI RAZVOJ,
ODRŽANE 20. DECEMBRA 2022. GODINE**

**DHJETOR - DECEMBAR
2022**

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Komisionit, z. Valon Ramadani.

Kryetari, Valon Ramadani: Përshëndetje për të gjithë,

Mirë se keni ardhur në këtë vazhdim të mbledhjes.

Sot na u ka bashkangjitur edhe Fidani, se dje nuk ka qenë Fidan Jilta edhe Agim Veliu.

Ne dje u dakorduam që për sot me vazhduar mbledhjen në orën 9:00. Sot kanë me u shqyrtuar amendamentet të cilat kanë ardhur krejt.

Fillimisht para se me filluar amendamentet kisha filluar me raportet e analizës të projektligjit që e kanë bërë këshilltarët e Kuvendit edhe me propozimet që ata i kanë dhënë për këto dy ligje.

Fillimisht të fillojmë me zyrtarët publik, nëse jeni gati i keni fletat përpara të gjithë, kush si ka i përcjellim, po duket që i kanë të gjithë edhe pa humbur kohë kishim filluar.

Unë po vazhdoj me i lexuar këto pjesë ku e shohim që ka nevojë për sqarim shtesë ose nëse e shihni të nevojshme ju me reaguari diçka e ngritni dorën është mirë edhe për neve që i kemi këtu, edhe se ne i kemi lexuar se këto i kemi pas prej dje.

Atë pjesën e falënderimeve po e kalojmë. Kjo na ka mbet prej dje se kemi pas shumë.

Pika një, është data, ju veç i paskeni datat kur ka ardhur kjo një pjesë e falënderimeve. Mirë se erdhe, zoti deputet Bekim!

Te pika 2, unë s'po shoh.

Vazhdojmë te pjesa e rekomandimeve ose pika e 4.

Rekomandimi, lidhur me përmbajtjen e projektligjit, strukturën dhe formulimin gjuhësorë juridikë.

4.1. Vërejtjet e përgjithshme

Nuk janë identifikuar vërejtjet e theksuara të cilat do të kishin nevojë me u paraqit në këtë pjesë të raportit me përjashtim të disa të metave teknike të cilat nuk janë përmbajtur me udhëzimin administrativ numër 03/2013 për standardet e hartimit të akteve normative numrat duhet të shkruhen me shkronja, ndërsa numrat që vendosur në kllapa, nenet kanë më shumë paragraf se sa i parasheh ky udhëzim administrativ. Shkurtesa për KPMSHCK në shumë raste është shkruar KMPHCK, nënparagrafi i është referuar në shumë nene si paragraf apo anasjelltas po ashtu përkundër që neni 4, paragrafi 2 të këtij ligji thuhet që përdorimi i emrit në njërin gjini nënkupton edhe gjininë tjetër.

Kjo rregull, tash kjo rregull, po mendoj që është dashtë me qenë ky rregull po nejtse, nuk është respektuar po thujse në tërë tekstin e projektligjit sikurse që njëjtë nuk janë përdorur drejtë në gjini apo edhe diku apo diku jo, konsiderojmë që këto vërejtje duhet të merren parasysh gjatë takimit të grupit punues me qëllim që të shmangen këto të meta dhe ligji të miratohet në përputhje me udhëzimin e lartpërmendur.

Nëse ka dikush prej deputetëve me diskutu për këtë temë, unë po e shoh që kjo KPMSHCK është e arsyeshme nëse diku keni has ose ku janë pjesë qysh e rregullojmë tash KMPSHCK është gabim me u përdorë në fakt është gabim teknik po duhet me bë amendament edhe unë mendoj që duhet me përmirësuar.

A ka dikush prej deputetëve që e donë fjalën te kjo pikë.

Ok, atëherë në rregull jemi. Domethënë a është fjala veç për këtë KPMSHCK-së apo edhe te pjesa e dytë.

Faton Hamiti: Me që mos me bë shumë amendamente janë të natyrës teknike kishim kërkuar që ju të na autorizoni që ne gabimet teknike t'i korrigjojmë në bazë të Udhëzimit administrativ kështu që ne kemi bazë për mos me kontestue dikush ose në seancë ose diku, sepse ka shumë dhe sikur t'i vendosim atëherë ju shkaktojmë probleme.

Kryetari, Valon Ramadani: Ju çka mendoni për këtë çështje, zoti Muzaqi e ka kërkuar fjalën.

Besim Muzaqi: Nëse mundet me e sqaruar këshilltari a nënkupton këtu edhe zvogëlimin e numrit të paragrafëve se aty u përmend që ka. E po në rregull.

Faton Hamiti: Nuk është dëm i madh po është një nga vërejtjet që është identifikuar.

Ne nuk mund ta bëjmë atë sepse ka shumë dhe atëherë struktura e projektligjit ndryshon në tërësi dhe duhet me u kthye pas po ky ishte vetëm vërejtje që s'është përmbajte udhëzimit administrativ. Kuptohet që është e vështirë me ju përmbajt gjithë po ne duhet me adresuar.

Kryetari, Valon Ramadani: Faleminderit, i nderuar deputetë!

E kemi fjalën për dy çështjet për KMPSHCK edhe përdorimi i emrit në njërën gjini nënkupton edhe gjininë tjetër.

Po deputeti Shabani e ka fjalën.

Isak Shabani: E ka pyetje. A do të bëhet amendament a kanë autorizim këta drejtpërdrejtë me intervenue në këtë projektligj, këtë duhet me e sqaruar se a do të shkon si amendament se ne të autorizuar nuk është problem kjo po me duket krejt është e qartë.

Faton Hamiti: Ku është përmbajtja e tekstit ne nuk prekim sepse ashtu kështu ne nuk guxojmë.

Kryetari, Valon Ramadani: A ke me thanë diçka.

Mirjeta Heta (zyrtare, Administrata e Kuvendit): Jo veç në fund e shkruajmë komisioni e autorizon Drejtorinë për Standardizim që t'i përmirësojë gabimet teknike.

Kryetari, Valon Ramadani: Në fund a mundesh me e sqaruar Mirjeta edhe një herë këtë.

Mirjeta Heta (zyrtare, Administrata e Kuvendit): Zakonisht kur e bëjmë në fund veç e autorizojmë njësinë që bënë spastrimin e tekstit final që për çështje teknike edhe këto i ndryshojnë ata, s'ka nevojë amendament.

Isak Shabani: Po para se me shkue në seancë duhet me na ardhur një deklaratë prej atyre që janë bërë këto përmirësime, nëse nuk gaboje te ligjet tjera është.

Mirjeta Heta (zyrtare, Administrata e Kuvendit): Teksti final, pasi të miratohet në seancë bëhet spastrimi i tekstit final.

Isak Shabani: Jo, jo ne kemi deklarata që vjen prej asaj zyrës që është për lektorim.

Kryetari, Valon Ramadani: Zoti Haxhiu!

Bekim Haxhiu: *(Diskutim pa mikrofon, nuk dëgjohet për transkriptim)*

Kryetari, Valon Ramadani: Ok-ej.

Faton Hamiti: Nëse bënë këto presje këto normal që një presje ndryshon shumë, është ajo maksima falet jo dënohet me presje edhe anasjelltas po arsyeja është që ne për mos me e ngarkuar kur e dimë që nuk është paragraf po është nënparagraf ajo është e kuptueshme po ai që e lexon mos me u fut në lajthitje, kështu që në një farë forme ne po duam me kontribue pak me ju kursye kohën se përndryshe ne kemi mujtë të gjitha me i radhit këto po ju vlerësojeni, ju jeni ata që vendosni nëse duhet t'i përmbahemi ne çka mund ta thoni ju është kështu që këshilltarët juridikë autorizohen që gabimet teknike të cilat vërehen në bazë të udhëzimit administrativ për hartimin e akteve normative mund të bëhen, sepse nuk mundet me qenë ndryshe, nëse është paragraf nuk mund me qenë nënparagraf, kjo është arsyeja. Po te presja, te përmbajtja asnjë nga ne se ka atë kompetencë as nuk guxojmë me u leshu.

Kryetari, Valon Ramadani: Konkret qysh po vazhdojmë prej deputetëve.

Po i patëm 2-3 dilema e mundemi me e bë me një amendament qysh po thonë këshilltarët.

Faton Hamiti: Ju mendoni që është në rregull, atëherë ne vetëm KPMSHCK-në nëse doni edhe pse është gabim ekstrem teknik bëni amendament të tjerat i lëmë si është në projektligj nëse ju pajtoheni.

Kryetari, Valon Ramadani: Po vazhdojmë. Fjalën e ka kërkuar Besnik Tahiri, pastaj Besim MUSAQI.

Besnik Tahiri: Mirëmëngjesi, kolegë

Po mendoj që jem tu humb shumë kohën që këto çështje që realisht nuk janë çështje. Jemi tu fol për amendamentin që .. ndërhyrje të cilat nuk ndikojnë në përmbajtje të këtij ligji.

Kryetar, po mendoj që jemi tu humb shumë kohë në elemente që nuk kanë farë ndikimi në përmbajtje të ligjit. Po ne nuk e kemi nisë ligj bërjen për herë të parë ky komision gjithë kemi bë ligje edhe e dinë këta procedurën qysh është, domethënë mbi procedurën e cila është praktikë veç e ndërtume në bërjen dhe këqyrjen e gabimeve mbi atë praktikë ndërtoni edhe punoni dhe mos të humbim kohë se praktika nuk është e para unë dy ligje i kem udhëheq këta i kanë këqyrë ku janë gabimet, kanë thanë këtu janë gabimet edhe i kem miratuar. Propozoj me shku në amendamente, ndërsa intervenimet prej këtyre bëhen në praktikën e cila është e ndërtuar që 20 vjet në Parlament të Kosovës. Faleminderit!

Besim MUSAQI: Krejt ky diskutim po shkon në këtë frymë edhe unë s'po dua me zgjatë më shumë, ne mund ose të votojmë një amendament apriori e me ja dhënë të drejtën që këta t'i bëjnë ndërhyrjet ose mundemi me ju dhënë mundësinë që këta gjatë ditës derisa e përfundojmë t'i përmbledhin gabimet teknike apo çfarëdo që i shohin edhe të na i prezantojnë këtu ne e votojmë në fund të ditës me një amendament të vetëm ku edhe rirenditja përcaktohet ose ndoshta me një renditje nuk di teknikisht a kemi të drejtë.

Kryetari, Valon Ramadani: Këshilltarë, a mundeni me e krye këtë që e tha.

Florent Mehmeti: Faktikisht këtë që e tha edhe deputeti, ne në bazë të praktikës që kemi faktikisht nëpër komisione tjera ku punojmë për çështje puro teknike domethënë u kon një nënparagraf i caktuar për shembull në vend se me qenë 4.2 është 4.3 ose është 4.2 me dy pika ne duhet me ja heqë një pikë, faktikisht ne në këso raste autorizohemi që me ndërhy në tekst që është puro teknike absolutisht në presje, në përmbajtje ku ndikon në përmbajtje të projektligjit në pikësim e këto jo.

Ose mund të ndodhë për shembull në vend se me fillue me shkronjë të madhe pas pikës saktësim është me shkronjë të vogël ne ato automatikisht e bëjmë me shkronjë të madhe e ke parasysh

sepse nëse shkojmë me amendament për me i rregulluar të gjitha çështjet teknike atëherë dalin shumë amendamente në një.

Edhe nën dy, është vështirë se e kemi kohën e shkurtë, gjithë këtë përmbajtje që e ka edhe vëllim projektligji atëherë nëse ne nuk shohim diçka për nguti atëherë ne kufizohemi që atë pjesë që është gabim më mos me e prek ta keni parasysh na kufizoni tani, domethënë tani bëjmë veç ndërhyje që është në amendament ta keni parasysh.

Kryetari, Valon Ramadani: Edhe Besniku qysh e tha në rregull është. Besimi që fol më në fund domethënë i autorizojmë jo autorizojmë që këto teknike çka janë me i përfunduar, qysh është në praktikë edhe në ligje tjera.

Isak Shabani: Kryetar po pajtohem unë me këtë, po një gjë unë po e arsyetoj atë që e kam thënë në ditën e parë që për këtë ligj jemi ngutë edhe kemi me leshu lëshime. Unë po them si në çdo projektligj që jam edhe në komisione tjera na ka pru deklarata prej atyre që është në përputhje për lektorim që i ka kaluar të gjitha procedurat është në rregull, tash na del që s'është.

Ajo deklaratë na mungon në këtë projektligj, po sido kudo nuk kemi me e bllokue këtë punë po përpara çdo projektligj u pru deklarata që ka kaluar nëpër ato lektorime e krejt, këtu nuk e kem për ata tash po vërehen për këtë KPMSH këtu duhet me qenë amendament pa diskutim me e pru edhe me votue.

Kryetari, Valon Ramadani: Për këto teknike..

Isak Shabani: Për teknike prapë vazhdoni veç është dashtë përpara me shkue në lektorim.

Kryetari, Valon Ramadani: Mirë, faleminderit!

Atëherë po vazhdojmë.

Vazhdojmë te 4.2

Vërejtje konkrete:

Neni 2

Fusha e zbatimit

Rekomandojmë që sipas paragrafit 3 të këtij neni të shtohet një paragraf i ri 4, Propozimi ynë ka për qëllim arritjen e qëllimit të dispozitës së paragrafit 3.

Paragrafi 4 i propozuar do të dukej si në vijim:

Dispozitat e këtij ligji vlejnë deri në nxjerrjen e ligjit të veçantë që e rregullon marrëdhënien e punës në institucionet e përmendura në paragrafin 3 të këtij neni.

A ka dikush najë koment për këtë propozim?

Isak Shabani: Një pyetje e kam për propozuesin.

Më intereson a nuk u parapa në fund te dispozita kalimtare që vlejné ato derisa .. pos po precizojmë tash çdo nen me e përshkruar këtë. Nëse në fund u precizua që vlejné këto dispozita s'ka nevojë...

Kryetari, Valon Ramadani: Ka të drejtë deputeti.

Mirë nëse ka dakordim që kjo nuk ka nevojë me u shtu. Vazhdojmë tutje, në rregull është kjo nuk kalon.

Nuk di a ka nevojë me qitë në vota këtë a s'ka nevojë, u bë. Nëse ka konsensus nuk ka nevojë me qitë në vota.

Neni 6.

Nëpunësi civil me status të veçantë, rekomandojmë që gjatë grupit punues të sqarohet ky nen nga sponsorizuesi rreth kategorive apo institucioneve që paraqitet të ketë statusin e veçantë paraparë me këtë ligj kryesisht rreth ku qëndron dallimi ndërmjet një zyrtari të punësuar në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe zyrtarit iks ministri. Pse në këtë rast përjashton nga kjo kategori Policinë e Kosovës, Inspektoratin në Policinë e Kosovës në këto dy institucione apo stafin civil.

Po ashtu si ka mundësi të rregullohet në këtë mënyrë statusi i zyrtarëve të parashihet të punoj në institucione të cilat nuk janë akoma funksionale por aktualisht vetëm projekte.

Kjo vërejtje i referohet nënparagrafit 1.8, i cili parasheh si në vijim:

Të punësuarit në Byronë Shtetërore për Verifikim dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme.

Te kjo e para edhe e dyta mendoj që e kemi sqaruar dje, kemi diskutuar goxha shumë për këtë pikë edhe është përfunduar.

Te cila pikë mendoni që ka nevojë për sqarim. Te 1.8.

Besnik Tahiri: Të tjerat janë të sqaruara. 1.8 ne jemi në proces.

Kryetari, Valon Ramadani: Byrosë Shtetërore të Verifikimit të Konfiskimit të Pasurisë.

Po, fjalën e ka kërkuar deputeti Tahiri.

Besnik Tahiri: Se ne i kemi diskutuar shumicën e këtyre elementeve po pika e parë dhe pika e fundit është e rëndësishme.

Kryetari, Valon Ramadani: E para, po e para u përfundua dje, e keni sqaruar ndoshta 2-3 herë.

Besnik Tahiri: Jo, e kem sqaruar për shkak se nuk janë fol, se këtu po thotë.

Kryetari, Valon Ramadani: Bile para mediave.

Besnik Tahiri: Ku qëndron dallimi ndërmjet një zyrtari domethënë një i punësuar në ministri me një ministri tjetër. Kjo është.

Kryetari, Valon Ramadani: U tha kjo dje, jo, jo u thonë sigurt dje, e kemi sqaruar po nëse ka nevojë me e sqaruar e sqarojmë prapë.

Besnik Tahiri: Nejse nëse e keni sqaruar ju unë s'kam nevojë se unë e di, po veç po pyes.

Kryetari, Valon Ramadani: Po e kuptoj, po nëse ka nevojë për të tjerët mundet zëvendësministri.

Besnik Tahiri: Çështja e dytë është kjo puna për këtë Byronë, asnjë njeri nuk është hy në punë edhe ligji është te pjesa tek trajtimi në Komisionin e Venecias ky tash bie ndesh me ato zëvendësministër me këtë që e kemi diskutuar më herët për punë për shembull të Ligjit për Administratën Tatimore që thojshim është tu e trajtuar si status special këtu nuk e kije, qysh e keni menduar këtë.

Kryetari, Valon Ramadani: Mirë fjalën e ka zëvendësministri për sqarimin e 1.8 ose zyrtari apo Meliza.

Meliza Qorraj: Si Qeveri në këto drafte kemi punuar me draftet të cilat janë miratuar në Qeverinë e Republikës së Kosovës tu marrë parasysh që kemi menduar që me qenë se Ligji për Byronë me aq sa ne jemi të njoftuar ka mëri në Kuvend përmirësomëni nëse jam gabim.

Fitim Haziri: s'ka mbërri.

Meliza Qorraj: S'ka mbërri hala. Nuk ka mëri akoma në proces, ama është në Kuvend po ka shkuar në Komision të Venecias për atë është.

(Polemikë)

Meliza Qorraj: ka kaluar në Qeveri, kjo ka qenë e rëndësishme për neve.
A ka ardhur në Kuvend a s'ka ardhur.

Besnik Tahiri: Veç një sqarim kështu se tash masi po flasim po flasim saktë.
Nuk ka mundësi një ligj me u bazu në një draft që është gabim pikë, nuk ekziston një ligj i cili vjen thotë filane drafti që u miratua...

(Ndërprerje e incizimit)

... për shkak se referencë nuk mundet me na...

(Ndërprerje e incizimit)

Meliza Qorraj: Ndoshta veç me sqaruar.
Ne kemi punue që draftet prej Qeverisë në Kuvend me ardhë draftet e harmonizuara dhe jo draftet një ligj ndryshe një ligj ndryshe, është normalisht në kompetencën e juaj se a doni me lënë apo me heq. Ne mundemi me e rregulluar edhe ekuivalencë në rastin kur miratohet Ligji për byronë.

Kryetari, Valon Ramadani: Kështu, ta zëmë ky ligji që është në procedurë edhe është sot në Venecia, a muj me vazhdua tani ja kaloj fjalën secilit.

Qysh po thua Besnik pasi ta kryejmë këtë ligj edhe ky është paraparë që me kon masi të kalon kjo ne duhet me bë plotësim ndryshim në këtë ligj veç për këtë nen.

Atëherë e ka fjalën Besim Muzaqi, Bekim Haxhiu, pastaj këshilltari.

Besim Muzaqi: Në mënyrë që të mos përsëritet e mos të ketë nevojë me ardhë edhe një herë në rishikim për një çështje si kjo, këtu duhet mu amendamentu në mënyrë të tillë që të formulohet të punësuarit në Byronë Shtetërore për verifikim dhe Konfiskimin e Pasurisë së pajustificueshme pas miratimit të ligjit. Nëse ai miratohet i bie që është, nëse nuk miratohet i bie që...

Kryetari, Valon Ramadani: Fjalën e ka deputeti Haxhiu, pastaj këshilltarët.

Bekim Haxhiu: Veç një gjë, do të thotë që mos me pas konfuzione ose nesër nëse themelohet një agjenci i cili mundet me pas statusin e veçantë që jo vetëm kjo qeveri po mund të ketë qeveri tjera të cilat projeksionet e tyre munden me i pas te statusi i veçantë duhet me e përcaktua, ju mundeni me e shti që i përcakton Qeveria agjencitë me status të veçantë. Unë mendoj që këtë është dashtë me e formuluar që mos me pas ndërhyrje në ligj sa herë që të formohen agjencitë të cilat munden me pas status të veçantë atëherë ato me i formuluar brenda kësaj që me ja jep

kompetencë një institucioni që i themelon ose që i përcakton me akte nënligjor cilat janë institucione me status të veçantë që me ja jap mundësinë Qeverisë që me akt nënligjor me e ndryshue se Qeveria mund të ndryshon e themelon agjenci, Kuvendi e themelon Agjencinë për Byronë për Konfiskimin e Pasurisë, Qeveria mundet me e ndryshuar listën e agjencive me status të veçantë me akt nënligjor. Kështu mundeni me e lënë përndryshe nuk mund t'i referoheni një dispozite e cila është veç draft nuk është e votuar në Kuvend.

Kryetari, Valon Ramadani: Tash e kërkuar fjalën deputeti Isaku, pastaj këshilltarët.

Nijazi Isaku: Faleminderit!

Unë po ndërlidhna me deputetin që foli pak më herët për agjencionin. Nuk besoj që ka me pas më formime të agjencioneve se e dimë që janë të stërngarkuara me agjencione dhe jemi kampion për agjencione Kosova e ne jena në procesin e racionalizimit edhe jena tu i ndryshuar, kështu që kjo nuk vlen besoj.

Valon Ramadani: Fitorja e ka fjalën.

Fitore Metbala: Vetëm te pjesa e krijimit të agjencioneve të reja nuk mendoj që është ajo problemi me qenë se po në atë nen në paragrafin 4 është e paraparë që me rastin e krijimit të agjencive, institucioneve, funksioneve apo pozitave të reja në të cilat krijohen ato përjashtimisht institucioneve të pavarura presidencës dhe të tjerave kërkohet nga Ministria Përgjegjëse për Administratë Publike përcaktimi i kategorisë së zyrtarëve publik në bazë të emërtesës dhe ekuivalencës. Pra, për të rejat të ardhshmet që krijohen është e parapame.

Besnik Tahiri: Veç me e thjeshtësuar pak këtë punë.

Fitore nuk jem tu fol për agjencione, më fal a e përfundove Fitore.

Kryetari, Valon Ramadani: Besnik më fal, ndërhyrjet kështu kanë me na bllokuar punën, a po kupton. Unë çdo herë kush po e kërkon fjalën sidomos deputetët kush do tjetër ja ndali me e krye një herë deputetë, ky reagimi kështu nganjëherë po na qetë.

Fitore e mundesh me e përfundue.

Besnik Tahiri: *(Diskutimi pa mikrofon)* S'është kjo puna e agjencive, një institucion është që nuk ekziston një ligj, ju keni referuar një ligji që nuk ekziston, ja heke duhet me na tregu a me lënë a mos me lënë...

Kryetari, Valon Ramadani: Përfundoje Fitore pastaj këshilltarët.

Fitore Metbala: Kjo çka thash unë ndërlidhet pikërisht me atë çka po thotë zoti deputet, sepse ne jemi tu e përmend që me ekuivalencë është e paraparë me u rregulluar kjo çështje edhe nëse ju

vendosni në këtë moment me votue që Byroja me u largu prej këtu pra përmes ekuivalencës në paragrafin 4, ata mundën më vonë në momentin që ju votohet projektligji me kërkim nga ministria përgjegjëse me ju caktim përcaktimi i kategorisë të atyre zyrtarëve.

Kryetari, Valon Ramadani: Mirë, atëherë prej këshilltarëve e kanë kërkuar fjalën. Ti japim epilog kësaj pune.

Fitore Metbala: jo ne jemi tu thonë që ka mundësi me u rregullu nëse hiqet.

Valon Ramadani: jo po dëgjojmë edhe këshilltarët çka po na thonë se tash e kanë kërkuar fjalën.

Muhamet Bytyqi: Të nderuar deputetë,
Neve e kemi analizuar se vetë kemi thanë me e fshi për shkak se projektligji nuk mund të përmbaj një institucion i cili është projektligj. Çka nëse dështon në lexim të dytë.

Paragrafi 4, Fitorja u mundua me e arsyetuar edhe nëse fshihet dispozita nuk i mohohet statusi i veçantë Byrosë në momentin e themelimit. Do të ketë zhvillim .. të administratës. Njazi Isaku e tha që do të krijohen e do të quhen agjencione, tash nuk i betonon ti këto agjencione institucionet s'kanë me lëviz.....

Kryetari, Valon Ramadani: Kështu Muhamet, më fal që po të ndërpres po unë mendoj që s'ka nevojë me diskutue këtë pikë më shumë, mendoj që duhet me u hekë të fshihet ky nenë. A ka nevojë me qitë në votim, a jeni unanimitet për këtë. Ka nevojë me qitë apo.

Paragrafi 1.8 të punësuarit në Byronë Shtetërore për Verifikim dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme të fshihet.

Kush është për? Besnik a je për këtë. 7 për, kundër, abstenim.

Atëherë 7 për.

Vazhdojmë tutje.

Kriteret e përgjithshme.

A mundesh me na sqaruar nenin 9 që mos t'i lexoj këtë pjesë masi veç edhe ashtu po doni ju me komentuar.

Vazhdojmë te neni 9.

Nëse mund të na bindni për t'i hequr.

Faton Hamiti: Shumë shkurt te neni 9, ne e kemi gjet fjalën “përshtatshmëri” që është përdorë aty, .. përgjithshme që i ka përcaktuar ky projektligjit për disa pozita kërkohet edhe

përshtatshmëria. Kusht i cili parashihet të rregullohet me akt nënligjor thotë. Rekomandohet që të përkufizohet se çka nënkuptojnë “përshtatshmëri”, për arsye se mund të shmanget keq interpretimi kur ne e përkufizojmë për shembull ja jep qëllimin për çfarë arsye përshtatet për pozitën specifike apo diçka tjetër dhe në një farë forme përdorimi i tij eventual mund të .. në favore të dikujt tjetër për interesa për shembull i përshtatshëm i pa përshtatshëm. Dhe nëse është menduar kualifikim apo përshtatje në aspekt personal atëherë le të përkufizohet, nuk e di a e kam të qartë, thue për shembull është i përshtatshëm, s’është i përshtatshëm është abstrakte për çka përshtatja e kjo i jep konotacion nganjëherë.

Kryetari, Valon Ramadani: Veç edhe te pika 2 menjëherë që mos të kthehemi te paragrafi 6.

Faton Hamiti: Ne kemi thanë që të parashihet së paku kritere minimale për zbatimin e paragrafit 6.

Paragrafi 6 i këtij neni përjashton plotësimin e kritereve të parapara me paragrafët paraparak të këtij neni kur është fjala për themelimin .. punë për zyrtarët e kabinetit.

Tash, këtu te zyrtarët e kabinetit kanë thënë që s’ka kritere mundet me marrë kush çka do. Ne së paku për shkak të integritetit të institucioneve është mirë që të shihen disa kritere minimale në bazë të cilës dikush nga ata merret në kabinet, për arsye se ai zhvillon takime të ndryshme përfaqëson institucionin do të ketë një farë lloj së paku një integritet në bazë të cilit a jo veç cilido kabinet me marrë kenë do normal që i bie në përgjegjësinë e tij po në një farë forme ai përfaqëson edhe në institucione, në organizata jashtë e shoqëron stafin e kabinetit. Kjo ishte arsyeja pse.

Kryetari, Valon Ramadani: Mirë a ka mundësi me na arsyetua këto prej ministrisë dikush. Po Bardhyli.

Zëvendësministri, Bardhyl Dobra: Sa i përket përshtatshmërisë, përshtatshmëria nuk nënkupton aftësitë profesionale të një individi që vlerësohen për nga edukimi, përvoja, njohurit po një grup karakteristikash që lidhen drejtpërdrejtë me personin që mban statusin në fjalë.

Specifikisht ka me u rregulluar me akt nënligjor s’ka asgjë të bëjë me gjana personale.

Kryetari, Valon Ramadani: Vazhdo te pjesa e dytë menjëherë, neni 9 aty ku ju kanë referuar analizat.

Zëvendësministri, Bardhyl Dobra: Ndërsa sa i përket çështjes së zyrtarit të kabinetit nëpunësit të kabinetit nuk ka interes asnjë titullar me marrë dikon që...

Kryetari, Valon Ramadani: Mirë, atëherë sipas kësaj që e dëgjova unë prej zëvendësministrit këtu nuk duhet me ndryshue, po nuk duhet me ndryshu nuk di pse kemi nevojë më shumë me sqarue. A ka dikush nevojë për sqarim shtesë. Po fjalën e ka deputeti Isak Shabani.

Isak Shabani: Unë kërkoj që kjo fjalë “gjendet një përkufizim për përshtatshmëri çka nënkupton. Nuk dua me akt nënligjor nesër me qit diçka kujt i konvenon, nuk po dua me lënë të hapur me aktin nënligjor përshtatshmërinë e përshtatshme. Unë propozoj që mu heq përshtatshmëria ose le të përkufizohet.

Besnik Tahiri: ... është e përkthyer anglisht është “suti boll”, që i bie s’ka fort gjuhë shqipe kjo, kjo përshtatshmëria nuk është fjalë e mirë me ju thanë të drejtën. S’kam një farë propozimi çka me thanë ndoshta kërkohet përmbushja e kriterëve e kisha heq përshtatshmërinë e kisha lënë mund të kërkohet përmbushja e kriterëve për emërimin në pozitë edhe këtu e ke përmbushja e kriterëve, kjo termë përshtatshmëri është goxha problem edhe juve ju bie keq se i bie që për pa kon i përshtatshëm politikisht nuk bëhet, po i bie edhe juve si shumicë ju bie keq kjo po propozim nuk kam.

Kryetari, Valon Ramadani: Po vazhdojmë i kemi dy propozime.

Propozimi që është i Qeverisë dhe propozimi i këshilltarëve.

Po jo, e thatë sqarimin nuk mendoj që ka nevojë nga tri herë me fol për një çështje.

Nëse veç duhet pa tjetër, ama kështu ne kemi me mbet gjatë. Tash po mendoj janë kështu dy propozime, propozimi që është vazhdon kjo s’ka nevojë, ky tjetren nëse ka nevojë e qesim në votim nëse s’ka dakordim, shkon në votim ecë tutje, nuk kalon vazhdojmë te pika tjetër.

A po tërhiqeni prej propozimit a qysh? Hajde.

Faton Hamiti: Është shumë i gjerë, shumë gjithëpërfshirës dhe mund të përdoret si pretekst sa herë të dojë dhe ne s’mund me parashikuar çka do shkruhet në aktin nënligjor që do nxjerr me këtë.

Problemi janë dy zgjidhje sipas nesh.

E para, le të përkufizohet në cilin aspekt,

E dyta, në paragrafin 5 thotë, Përshtatshmëria apo kriterë specifike, hiqe përshtatshmërinë leje kriteret specifike si është aty. Ky është propozimi ynë, mirëpo.

Kryetari, Valon Ramadani: Mirë atëherë ne konkret i kemi dy propozime qysh i thash.

Unë për shembull mendoj duhet me vazhduar me propozimin qysh është i Qeverisë.

Kush është për propozimin që e ka dorëzuar Zyra ligjore?

Kush është kundër?

Abstenim? S’ka.

Vazhdojmë tutje.

Neni 33

A ka mundësi për nenin 33 me na sqaruar.

Të sqarohet për cilat kategori është menduar të nënshkruhet ajo deklaratë për konfidencialitet. Paragrafi 5 i këtij neni thotë që zyrtari publik me themelimin e marrëdhënies së punës nënshkruan deklaratë për konfidencialitet, të sqarohet nëse kjo është menduar për të gjithë zyrtarët publik apo vetëm për pozita specifike. Për shembull unë mendoj këtu që duhet me thanë po.

Unë pak u nguta ndoshta se e dhashë vetëm mendimin temë, po a ka mundësi me dhënë prej ministrisë, edhe jo, po. S'ka nevojë për votim.

Vazhdojmë tutje.

Neni 35

Ushtruesja e detyrës. A mundeni me na sqaruar te neni 35 çka keni, veç ta lexoj koka pak më e gjatë.

Faton Hamiti: Ne kemi rekomanduar ndryshimin e paragrafit 3 të këtij neni i cili rregullohet aspekti i pozitës ushtruesi i detyrës.

Të keni parasysh se nganjëherë po prolongohet zgjedhja e zyrtarit në pozitë, ndërsa po pason me ushtrues detyre pa një afat të caktuar.

Ju keni paraparë që afati mund të jetë 6+6, ndërsa ne kemi rekomanduar që mos të jetë ushtrues detyre i njëjti person që ka qenë në pjesën e parë të gjashtëmujorit. Kjo ka qenë një propozim i yni për arsye se tash mos me u marrë shumë me fjalë po abuzohet shpesh me pozitën e ushtruesit të detyrës.

Kryetari, Valon Ramadani: Atëherë a ka diçka me shtu me thanë ministria te kjo pika, ju qëndroni në versionin që keni qenë.

A ka dikush prej deputetëve që e donë fjalën, zoti Haxhiu e ka fjalën.

Mirë se erdhe deputete Bajrami. Na ke munguar dje se në fillim ke po në pjesën tjetër më nuk të pamë.

Bekim Haxhiu: Faleminderit!

Edhe propozimi në ligj po edhe përvojën time të gjatë në institucione, po e jap një gjë përvojën e gjatë në institucione.

Kushdo që është ministër nesër, kushdo që është shef i agjencie nesër do të donte me pas sa më shumë mundës me e majtë dikon në ushtrues detyre. Abuzimi më i madh edhe shtytja e personave zyrtarë drejt shkeljes ligjore bëhet në kohën sa janë ushtrues detyre, është mënyra për me ju presion për me i realizue udhëheqësit e institucioneve qëllimet e tyre.

Bile mendoj që asnjëherë mbi tre muaj ditë derisa mund të zgjatë një procedurë e zgjedhjes së rregullt me konkurs të një pozite të lartë nuk do të duhej të ishte me ushtrues detyre tre maksimum tre, por jo asnjëherë i njëjti person sepse kështu kanë keqpërdorur e kanë abuzuar me pozita zyrtare prej fillimit e deri sot dhe kanë qenë një prej vërejtjeve kryesore të auditorit në të gjitha raportet e auditimit të institucioneve të Republikës së Kosovës.

Vendosni një kriter ligjor kryetar sepse ky kriter ligjor ka me ju shërbye tjerëve që janë edhe e parandalon të keqen. Nëse e leni kështu 6+6 po ka pas edhe në të kaluarën që ka ndejtë edhe nga një vjet e ka dy ushtrues detyre veç kështu është keqpërdorë edhe nëse jeni amin qoni dorën me lanë bile nga një vjet bonja nëse doni me jap aminin keqpërdorimeve që ministrat, drejtorët e agjencive me ushtru ndikim e len sekretarin e ministrisë ushtrues detyre nga një vjet e dy qe qashtu abuzon më së lehti me të ose le drejtorin e prokurimit ushtrues detyre abuzon me të. Ndalen abuzimin përmes ligjit, qitni kritere ligjore.

Kryetari, Valon Ramadani: Mirë, atëherë shkurt, nëse ka ministria për mua është e qartë.

Fitore Metbala: shumë shkurt me e sqarua që ky kriter ligjor është kufizimi në kohë dhe çdo mendim i marr mbas një viti të ushtrimit të atij funksioni me ushtrues detyre konsiderohet vendim i paligjshëm për këndo që e mbanë atë pozicion.

Megjithatë është shumë me rëndësi me e cekë që për momentin edhe nëse kjo normë e ushtruesit të detyrës nuk po vendoset mundohet veç me ju përmend Ligjin për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore që e parasheh zëvendësimin madje pa afate. Pikërisht për këtë arsye që mos me vendos zëvendësime pa pikë afati po vendoset ushtruesi i detyrës me afat dhe çdo vendim i marrur pas një viti mu konsideruar vendim i paligjshëm, se besoj që dikush me shumë dëshirë po donë me marrë vendime të paligjshme si t'i kalon data po është, është norma.

Kryetari, Valon Ramadani: Mirë atëherë unë po mendoj që duhet me shku në votim për këtë pikë. Shabani e ka fjalën.

Isak Shabani: Sa i përket kësaj ndoshta pajtohem edhe po them plotësisht me Bekimin kolegun që thotë që me mujtë me i shkurtuar afatet. Përndryshe jam kundër kësaj prezantimit të Zyrës

ligjore për arsye që po thotë gjashtë edhe pas gjashtë muaj ditëve me u ndërru tjetër ushtrues detyre. Mendoj kjo është absurditet po them nga përvoja jem që disa herë kam qenë ushtrues detyre, tamam e kam mësuar profesionin gjashtë muaj ditë tash me thanë ti ndërrohu hajde një tjetër merr qatë detyrë për mua nuk mendoj që është .. kështu që mendoj me mbet nëse mbetet.

Kryetari, Valon Ramadani: Deputeti Veliu, e ka fjalën.

Agim Veliu: Unë nuk mendoj që është mirë me pas afatgjatë ushtruesi i detyrës me i shikuar sa janë afatet normale të procedurave që duhet me u zhvillu për një vend pune, sa është afati i konkurrimit, sa zgjatë intervistimi me u mundu me llogarit një afat që është i arsyeshëm edhe me vendos, përndryshe nuk është mirë me lënë 6+6 e më duket afat i gjatë.

Kryetari, Valon Ramadani: Po edhe një herë Fitorja.

Fitore Metbala: Në .. aktuale afatet që janë paraparë për ankimim kanë qenë dukshëm më të shkurta tetë ditë. Në këtë projektligj afatet janë vendos të ankimimit të gjitha tjerat në përputhje me Ligjin e procedurës administrative që nënkupton se të gjitha afatet po zgjaten minimum deri në 30 ditë e deri në përfundim të çdo veprimi administrativ eventualisht 45 ditë.

Marrë parasysh që një procedurë rekrutimi zgjatë diku deri në gjashtë muaj në të gjitha fazat ankimimi, verifikimi paraprak, vlerësimi profesional eventualisht një dështim i një procedure nënkupton edhe një gjashtëmujor tjetër rifillimin ose ri zhvillimin e asaj procedure. Për atë u vendos maksimumi një vit dhe jo më shumë. Faleminderit!

Kryetari, Valon Ramadani: Nëse mundesh...

Faton Hamiti: Racional ishte me kë, një shtytje që sa më shpejt me plotësue atë detyrë, kjo është arseja pse ne i kemi referuar këtij amendamenti. Ka qenë një arsyeshmëri mbrapa pse e kemi bë.

Kryetari, Valon Ramadani: Mirë. Unë jam që me mbet versioni qysh ka ardhur prej Qeverisë.

Kush për versionin që e ka dorëzuar Zyra ligjore?

Kush është kundër?

Kush abstenon?

Sa vetë votuan?

2 për, 4 kundër, mbetet versioni qysh është i Qeverisë.

Neni 46.

Fjala për ju është këshilltarë.

Faton Hamiti: Të nderuar deputetë, kjo faktikisht është biseduar shumë për nenin 46 besoj që janë ezauruar është folur mjaft, ne veç kemi dashtë me ditë, nëse kam vëmendjen tuaj, vetëm kemi dashtë me ditë qëllimin fundamental sepse kjo në një farë forme ne e kemi paraparë që rrezikon stabilitetin e institucionit, kemi thanë në një farë forme me mandate rrezikohet edhe memoria institucionale, mendoj që është fol shumë nuk ka nevojë më shumë secili ka dhënë arsyetimin e vetë po kjo është arsyeja pse e kemi ngrit ne shqetësimin, sepse ne ekskluzivisht ju kemi referuar nga perspektiva jonë nuk kemi lexue sigmën, kemi lexuar po s'kemi reflektuar asnjë gjë prej tyre.

Kryetari, Valon Ramadani: S'ka diskutim te pika 46.

Besim Muzaqi: A po e voton këtë?

Kryetari, Valon Ramadani: S'ka nevojë, nëse s'ka dilema ajo ecë tutje.

A po doni me qitë në votim, ani.

Zoti Shabani, unë e thashë folni për nenin 46 e dhanë këshilltarët, deputetët s'kanë kurrfarë reagimi te kjo pikë, nëse ka e merr fjalën, flasim. Zoti Shabani që tha se nëse s'ka dilemë këtu vazhdon versioni i Qeverisë.

Fjalën e ka zoti Shabani.

Isak Shabani: Të lutem, unë plotësisht e përkrahi mendimin e tyre ... edhe do të votoj kur të vjen puna ..

Kryetari, Valon Ramadani: Atëherë shkojmë në votim.

Kush është për nenin 46 që është propozuar prej Zyrës ligjore?

Kush është kundër?

Abstenim, s'ka.

4 me 3. Bie se propozim.

Vazhdojmë, neni 52

Nëse mundeni për ta sqaruar.

Faton Hamiti: Te neni 52 i cili flet për vlerësimin e rezultateve në punë janë disa vërejtje.

Ne kemi rekomanduar që të shtohet një paragraf pas paragrafit 15 të këtij neni në të cilën do të parashihej arsyetimin në formën e vlerësimit sepse 13.1 thotë arritje e jashtëzakonshme. Unë mendoj për çdo vlerësim që është në nivelin e kënaqshëm dhe mbi nivelin e jashtëzakonshëm të arsyetohet cili është ajo arritje që një zyrtar vlerësohet jashtëzakonshëm për performansë. Kjo në një farë forme të krijohet aty një farë raporti servil mes mbikëqyrësit dhe zyrtarit, do ishte mirë të arsyetohet me argument cili është arritje e jashtëzakonshme, e para.

Nëse doni vazhdojmë me të dytën.

Kryetari, Valon Ramadani: Po, vazhdo!

Faton Hamiti: Gjithashtu shprehja vlerësim i veçantë thuhet bëhet një vlerësim i veçantë. Çka është nënkuptuar me vlerësimin e veçantë, është përdorë disa nene, për shembull 52, paragrafi 15, 16, neni 74 paragrafi 1.3 edhe ne kemi propozuar që të përkufizohet çka është vlerësimi i veçantë dhe në cilat raste përdoret.

Këtu është paraparë që zyrtari i pakënaqur me vlerësimin që e bënë mbikëqyrësi të dërgohet faktikisht të dërgohet në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil, ndërsa ne kemi thënë që është mirë të shteret shkallshmëria brenda institucionit një herë sepse shumica prej institucioneve qysh ju kanë ofruar edhe dëshmi ka shkallshmëri të nivelit drejtues është menaxheri i parë, menaxheri i dytë e tutje, ndoshta është një farë ngarkese është Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil me dërguar diçka me automatizëm me qenë i pakënaqur. Le të ekzistoj prapë një vlerësim i ndërmjetshëm një shkallshmëri në vlerësim. Kjo është për me pasuri formën e vlerësimit dhe arsyen kur ta vlerësosh dikun me shprehë kënaqësinë dhe pakënaqësinë.

Pjesa tjetër është, ne kemi bënë mendoj që kemi mendue me avancue pak përpara gjë që nuk është shumë praktikë po në institucione ndërkombëtare është mirë që edhe mbikëqyrësin me e vlerësuar zyrtari në një farë forme sepse secili kemi nevojë për përmirësime dhe secili kemi vërejtje për të cilat nganjëherë duhet me ja dhënë edhe me shkrim. Ky është mendimi jonë pse e kemi thënë për këtë nen. Janë katër pika ju andaj vlerësojeni.

Kryetari, Valon Ramadani: Mirë se erdhe deputete.

Faleminderit, shumë i nderuar!

Hajde kryetare.

Mirë a ka diçka prej ministrisë?

Meliza Qorraj: Po mendoj edhe ne pajtohemi parimisht, jemi në rregull që me pas arsyetim për pjesën e vlerësimit të jashtëzakonshëm sepse me të drejtë duhet me pas një arsyetim tepër të bazuar nëse dikush e merr notën arritje e jashtëzakonshme.

Sa i përket çështjes së KPMSHCK-së kjo bie në kundërshtim me Ligjin për procedurën e përgjithshme administrative sepse e drejta në ankesë gjithashtu nënkupton që ankesa mos me u prolongue. Nëse organi i shkallës së parë është vendimi i mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë ajo shkon tek organi i shkallës së dytë që është Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës e që organi i shkallës së tretë

në këtë rast ish bë domethënë dyshkallshmëria duhet me u ruajt nëse dom me qenë në harmoni me Ligjin e përgjithshëm të procedurës administrative.

E kemi diskutuar edhe me këshilli, edhe kjo është e vetmja mënyrë që mundemi me e ruajt që zyrtarëve publik mos mu ju prolongue procedurat që ata me shkue me vite e vite derisa të mbërrijnë te nj vendim i cili ka me qenë vendim i formës së prerë dhe i zbatueshëm për ta.

Neni 52 gjithashtu e parasheh vlerësimin që quhet vlerësim 360 shkallësh e që ju e keni propozuar për gjithë mbikëqyrësit të cilët kanë në vartësi zyrtarë edhe zyrtarët kanë me jap vlerësimin mbi mbikëqyrësin edhe është në ligj veçse e përfshirë kjo metodë e vlerësimit.

Faton Hamiti: Sa i përket asaj që i bie në kundërshtim ose jo me Ligjin e procedurës së përgjithshme administrative nuk bie në kundërshtim absolutisht. Domethënë ekzistojnë dyshkallshmëritë, ekzistojnë afatet prolongimi dhe mos prolongimi domethënë kur ka afate nuk mund të quhet prolongim.

Te kjo pjesa tjetër domethënë mënyra se si e the tek rubrika e fundit. A mundeni me na sqaruar ku është e vendosur kjo, ne nuk e kemi pa.

Meliza Qorraj: Të shkojmë te paragrafi 8 i nenit 52 thotë performanca e nënpunësit civil të kategorisë së ulët mesme, të lartë drejtuese vlerësohet nga mbikëqyrësi drejtpërdrejtë, udhëheqësi më i lartë administrativ dhe nënpunësi që ka në vartësi. Që i bie zyrtarët që i ka vartësi e njëjta që e keni propozuar.

Kryetari, Valon Ramadani: Isak Shabani, deputeti e ka kërkuar fjalën.

Isak Shabani: Do të jem i shkurtër.

Sa i përket kësaj çështje që e ka ngritë edhe Zyra ligjore arritja e jashtëzakonshme edhe unë propozoj gjithashtu me qen përkufizim. Çka nënkupton arritja e jashtëzakonshme sikurse ajo te përshtatshmëria.

Fitim Haziri: Këtu po dakordohem te arritja e jashtëzakonshme që edhe Qeveria tha për ta bërë një riformulim, edhe pajtohemi me këtë.

Kryetari, Valon Ramadani: A mundesh edhe një herë versionin e Qeverisë? A rrini në versionin qysh e keni pru a ndryshoni.

Meliza Qorraj: Ne jemi të pajtimit po besoj edhe ashtu e kemi mendu me rregullu me akt nënligjor që çdo vlerësim arritje e jashtëzakonshme duhet me qenë vlerësim i rrallë sepse

nënkupton që dikush ka jap jashtëzakonisht shumë për institucionin edhe patjetër që duhet me u arsyetua....

Kryetari, Valon Ramadani: Domethënë ju jeni në versionin qysh ka ardhur i shkruar...

Meliza Qorraj: Jo, jo pajtohem, plotësisht pajtohem që me u arsyetue.

Kryetari, Valon Ramadani: Le ta formulojë...,

Ja, e formulova.

Po, hajde, veç pak ka mundësi vëmendjen.

Meliza Qorraj: Paragrafi 14 i nenit 52 i Ligjit për zyrtarët publik riformulohet si në vijim: Rastin e vlerësimit në nivelet sipas paragrafit 13, ... domethënë kjo mbetet e njëjtë qysh është. Shtohet fjalia: Për vlerësimin në nivelet sipas 13 nënparagrafi 13.1 të këtij neni mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë në bashkëpunim bënjen e institucionit duhet të arsyetoj vlerësimin.

Faton Hamiti: A bën kështu, a bën të jetë paragraf i veçantë, ta shtojmë një paragraf aty, kështu që mos të... ose më mirë kishte me u përshtat këtu. Në rastin e vlerësimit në nivelin sipas paragrafëve ... nënparagrafi 13.1 mbikëqyrësi në rastin...

Besnik Tahiri: Faleminderit, Valon!

Dëgjoni, në momentin kur në një ligj ekziston fjala arritje e jashtëzakonshme detyrimisht në atë ligj duhet të jetë një arsyetim i jashtëzakonshëm të kundërtën shefi, përgjegjësi është bajest është i njëanshëm. Pra, paragrafi që duhet ju me propozuar lidhet me elementet që e bëjnë arsyetimin e jashtëzakonshëm për arritjen e jashtëzakonshme kaq thjeshtë është kjo punë. Është arsyetimi i jashtëzakonshëm edhe kjo lidhet me sistemin e performansës.

Kryetari, Valon Ramadani: Mua më duk që keni një farë dakordimi në mes Zyrës Ligjore dhe zyrtares së ministrisë, nëse është dakordim ta kemi një formulim të qartë ta votojmë e të ecim tutje.

(Ndërprerje e incizimit)

Faton Hamiti: Ka arsyeshmëri tek ato rubrika absolutisht po. Po këtu qëllimi është mu vu theksi sidomos tek arritjet e jashtëzakonshme që me pas ndoshta deputeti një vlerësim të jashtëzakonshëm.

(Diskutime pa mikrofoni)

Fitore Metbala: Çdo vlerësim argumentohet në paragrafin 11, mos të shtojmë paragrafë pa nevojë nëse në 11 kemi thënë që secili vlerësim

Besnik Tahiri: Unë jam për mos me shtu.

Kryetari, Valon Ramadani: Mirë atëherë vazhdojmë.

Besnik pajtohem edhe unë me ty. Vazhdojmë qysh është versioni i Qeverisë.

Domethënë nuk pranohet kjo, vazhdojmë me opsionin e Qeverisë veç nëse donë dikush me qitë në votim që i bie s'është dakord. S'ka najë farë reagimi.

U krye diskutimi me këtë s'kemi çka më, për këtë pikë u krye. Po a ka mundësi kur ka qëndrim ndryshe veç me thanë. Po donë me e qitë në votim, në rregull.

Kush është për versionin...

Isak Shabani: Unë kërkoj te përkufizimi.

Çka nënkupton arritja e jashtëzakonshme?

Kryetari, Valon Ramadani: Sa vetë kemi votuar.

Atëherë pasi s'po merr pjesë opozita, duhet të bëjmë pauzë 5 minuta derisa të kompletohet. Pesë minuta!

* * *

Kryetari, Valon Ramadani: Prandaj thashë, shkruaje në grup edhe një herë që po fillojmë. Edhe ashtu pauza ishte 5 min. Ne u vonuam nja dy minuta më shumë, po...

Janë anëtarë funksionalë të komisionit, më mirë presim një minutë. Kështu e kemi një koordinim ne, pak më shumë se sa që... A di, më mirë presim një minutë se...

Ju lus edhe një gjë, të gjitha komisionet e përhershme kanë caktuar mbledhje dhe janë duke na pritur neve kur t'i kryejmë këto pika. I përfundojmë ne. Si të përfundojmë kjo përcillet për në komisionet tjera. Kështu që, kushdo që ka pasur të flasë pesë minuta, e përfundon me tre. Edhe ashtu media s'paska kamera, që a din... se kur po janë kamerat nganjëherë po është më...

Po vazhdojmë!

Kush është për propozimin e Zyrës Ligjore?

Kush është kundër?

Abstenim? S'ka.

Konstatojmë që nuk kalon.

Vazhdojmë te propozimi i Isakut.

A ka mundësi me... OK.

Kush është për propozimin e deputetit Isak Shabani?

Kush është kundër?

Abstenim s'ka.

Konstatojmë që edhe ky propozim nuk kalon.

Vazhdojmë te neni 60.

Nëse ka mundësi, ose që po e lexoj shpejt, se s'paska shumë.

Të shmangen referencat jo të sakta. Referenca e përdorur në paragrafin 10 të këtij neni duket të jetë i gabuar, sepse paragrafi 8 i këtij neni nuk ka ndarje në nënparagrafë. Propozojmë që të korrigohet kjo referencë, duke e zëvendësuar atë me nënparagrafin 9.2.

A ka mundësi prej Qeverisë një mendim. Edhe ashtu është e qartë kjo, s'ka nevojë për sqarim prej Zyrës Ligjore.

Meliza Qorraaj: Saktë e kanë.

Kryetari, Valon Ramadani: Domethënë, është e saktë, pajtohet edhe Qeveria për këtë.

Kush është për, që ky nen të vazhdohet?

Kush është kundër?

Abstenim s'ka.

Shtatë janë për.

Vazhdojmë tutje.

Neni 67 – Lista e pritjes.

Të zëvendësohet fjala “pikës” me paragrafin si në nënparagrafin 3 të këtij neni. Edhe kjo mendoj që... por, po e dëgjojmë Qeverinë nëse...

Meliza Qorraaj: Është teknike. Po, po, kanë të drejtë.

Kryetari, Valon Ramadani: Atëherë, kush është për? Shtatë. Kundër s'ka, abstenim s'ka.

Vazhdojmë tutje.

Neni 68 – Llojet e pezullimit. Po!

Faton Hamiti: I nderuar kryesues,

Ne për shkak të ngutisë na ka ikur edhe një detaj.

Kemi një vërejtje te 67. i njëjti, paragrafi 4,

Kryetari, Valon Ramadani: Veç pak, është... ku është qajo? Jo, jo veç pak, nëse s'është shkruar, s'po vazhdojmë tutje. E ato që i kemi të shkruara, se i kemi lexuar ne sot e mbrëmë, domethënë nëse ka pasur diçka tjetër, është dashur me e bo me shkrim.

Vazhdojmë tutje.

Të zëvendësohet... Jemi duke folur për nenin 68 – Llojet e pezullimit. Propozojmë riformulim të dispozitës së paragrafit 1 të këtij neni dhe njëkohësisht përkufizimin e shprehjes “pezullim”.

Paragrafi 1 i këtij neni ka karakter përkufizues, andaj propozojmë që shprehja “pezullim” të përkufizohet me nenin përkatës 4 të këtij ligji. Ndërsa, dispozita e paragrafit 1 të ndryshohet si në vijim: Pezullimi në shërbimin civil bëhet duke vazhduar pastaj me radhitjen e nënparagrafëve si në projektligj.

A ka mundësi një mendim prej Qeverisë?

Meliza Qorraj: Më së pari po flas veç për përkufizimin.

Sipas legjislacionit në fuqi, përkufizohen veç shprehjet të cilat nuk kuptohen. Pezullimi është shprehje juridike, e cila është e qartë për...

Kryetari, Valon Ramadani: Mirë. A mundesh për këtë rast, për këtë nen, çka mendon.

Meliza Qorraj: Më fal, se unë s'i kam parë më herët. Në paragrafin 1 – Pezullimi në shërbimin civil bëhet... jo. Pezullimi është ndërprerja e përkohshme... Jo, jo, ne qëndrojmë pas versionit tonë.

Kryetari, Valon Ramadani: OK. Atëherë, kush është për versionin e Zyrës Ligjore?

Kush është kundër?

Abstenim?

Konstatohet që 6 janë kundër, një abstenim.

Vazhdojmë tutje.

Neni 91 – Kohëzgjatja e marrëdhënies së punës. Të shmanget përdorimi i referencave jo të sakta. Të zëvendësohet referimi në nënparagrafin 7.1 e përdorur në paragrafin 5 të këtij neni, me referencë në paragrafin 3.1.

Komenti prej Qeverisë?

(Ndërprerje e incizimit)

A ka mundësi të na jepni qëndrimin?

Meliza Qorraj: Pajtohemi.

Kryetari, Valon Ramadani: Qeveria pajtohet.

Atëherë, kush është për versionin e Zyrës Ligjore?

Kundër s'ka.

Abstenim s'ka.

Pranohet me vota unanime.

Vazhdojmë te pesë vërejtjet lidhur me versionin në gjuhën angleze dhe serbe.

5.1 - vërejtje lidhur me versionin në gjuhën angleze. Raporti në gjuhën... Çka është kjo? veç pak, këtu s'kemi çka.

Faton Hamiti: Këtu e kemi arsyen... kjo këtu është. Kemi thënë këtu, shihni, vërejtjet tjera eventuale. Qe ku e ke aty.

Vërejtjet eventuale e kemi këtë që po do ta ngrejë kolegu. Nëse doni me... është e rëndësishme.

Kryetari, Valon Ramadani: Veç pak, kjo është në vullnetin e deputetëve. nëse deputetët mendojnë që ka për vërejtje tjera, a mund të deklaroheni, deputetë, ose kush është, se kemi ne amendamente tjera që i kemi këtu.

Unë e kisha lënë kështu. Shohim nëse mbërrijmë me kohë i kryejmë këto, kthehemi edhe një herë. Kthehemi edhe një herë te kjo në fund, edhe për këtë çështje, po edhe ndonjë çështje tjetër nëse ka nevojë.

Po vazhdojmë se i kemi amendamentet e deputetëve, plus i kemi dy deputetë prezentë. Por, ju qëndroni këtu për këto që po i thoni, po edhe për çështje tjera që janë brenda këtij versionit. Besoj që i diskutojmë në fund, pasi që t'i trajtojmë të deputetëve.

Kështu, vazhdojmë te zyrtarët publikë me... Grupi Multietnik ka propozuar një amendament për Projektligjin për zyrtarët publikë.

Zonja deputete, e ke fjalën, edhe se e ke nënshkrimin e deputetëve të grupeve tjera. Nëse mund të na e sqarosh amendamentin, që të mos e lexoj unë. Fidan Jilta.

Fidan Jilta: Faleminderit, kryesues!

Prej deputetëve të Grupit Multietnik, e keni para vetes edhe nënshkrimet, amendamenti te neni 10, neni 10 i Projektligjit propozohet të zëvendësohet me tekstin e ligjit aktual si në vijim: Përfaqësimi i komuniteteve në institucionet publike qendrore, minimum 10%-shi i vendeve të punës, në të gjitha kategoritë e zyrtarëve publikë duhet të plotësohen nga pjesëtarë të komuniteteve, të cilat nuk janë shumicë në Kosovë dhe që përmbushin kriteret e pranimit.

Ndërsa, në nivelin komunal plotësimi i numrit të vendeve të punës për pjesëtarët e komuniteteve bëhet në pajtim me përqindjen e popullatës në atë komunë.

Arsyetim: Neni 9 i Ligjit aktual parasheh si në vijim: Në institucionet publike qendrore minimum 10%-shi i vendeve të punës në të gjitha kategoritë e zyrtarëve publikë duhet të plotësohen nga pjesëtarë të komuniteteve, të cilat nuk janë shumicë në Kosovë dhe që përmbushin kriteret e pranimit.

Mirëpo, në projektligj që po diskutojmë sot është ndryshuar kjo, domethënë, le të përfshihet në të gjitha kategoritë. Faleminderit!

Kryetari, Valon Ramadani: A ka ndonjë koment Qeveria për këtë, ose...?

(Ndërprerje e incizimit)

Ka një propozim që e ka bërë edhe për të njëjtën temë, edhe Qeveria, edhe deputetja. Nëse ka mundësi, Qeveria të lexojë amendamentin për këtë çështje, nëse është e njëjta ishte dashur njëri të tërhiqet, nëse është e njëjta çështje. Me sa e pash unë, është e njëjta çështje, por le ta dëgjojë edhe një herë mirë deputetja, më pas le të vendosë kush prej këtyre dyjave po tërhiqet.

Zëvendësministri, Bardhyl Dobra: Po ne e kemi propozuar, siç e keni parë, edhe amendamenti 4, neni 10 i Projektligjit riformulohet si në vijim: Në institucionet publike qendrore minimum 10% e vendeve të punës në të gjitha kategoritë e zyrtarëve publikë duhet të plotësohen nga pjesëtarë të komuniteteve, të cilat nuk janë shumicë në Kosovë dhe që përmbushin kriteret e pranimit. Ndërsa, në nivelin komunal plotësimi i numrit të vendeve të punës për pjesëtarë të komuniteteve bëhet në pajtim me përqindjen e popullatës në atë komunë.

Kryetari, Valon Ramadani: A është në rregull? A është i njëjti, se...
Vendosni ju kush tërhiqet, që mos t'i qesim në votim të dyja.

Zëvendësministri, Bardhyl Dobra: Në fakt, veç në fund, "... në pajtim me përqindjen e tyre në atë komunë."

Kryetari, Valon Ramadani: Veç pak, se më duhet me e...

OK, atëherë Qeveria po tërhiqet prej amendamentit. Po mbetet amendamenti i deputetes. A jemi në rregull, deputete?

Fidan Jilta: Po.

Valon Ramadani: Mirë. Kush është për propozimin e deputetes Fidan Jilta të amendamentit?

A ka kundër?

Abstenim?

6 për, kalon.

Urime, deputete! Merre këtë.

Ku jemi tash? Ku është lista?

Besnik Tahiri s'është momentalisht këtu.

Mirjeta Heta (zyrtare, Administrata e Kuvendit): Vazhdojmë me Isak Shabanin. Kjo u krye, Besniku këtu, tash deputeti Isak Shabani.

Kryetari, Valon Ramadani: Ama veç ta lexoj cila është.

Renditja është e Besnik Tahirit, po ai nuk është këtu për momentin. Vazhdojmë me deputetin Isak Shabani.

Nëse mundesh, deputet, nëse je gati, ose po i lexoj unë, ose vazhdo ti arsyetona menjëherë cili është propozimi juaj. Fjala është për ju, deputet.

Isak Shabani: Kam propozuar një amendament, sa i përket Ligjit për zyrtarët publikë. Të fshihet paragrafi 1 – 13 të nenit 46, ku kemi të bëjmë me emërimin dhe mandatin në pozita të nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues të Projektligjit për zyrtarët publikë dhe propozohet një paragraf i vetëm në tekstin si në vijim: Emërimi dhe mandati në pozitat e nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues është i përhershëm.

Arsyetim: Propozimi së në projektligj, që bartësit e këtyre pozitave të kenë mandat të përkohshëm cenon sigurinë juridike të zyrtarëve dhe përbën njëkohësisht edhe shkelje të të drejtave të tyre nga marrëdhënia e punës.

Bartësit aktualë të këtyre pozitave kanë mandat të pacaktuar dhe emërimi i tyre nuk është i kufizuar në kohë. Propozimi që këto pozita të barten me mandat të caktuar politizon administratën, cenon pavarësinë e saj dhe dekurajon profesionistët që të zhvillojnë një karrierë në shërbimin civil.

Këtë arsyeshmëri ia bashkëngjis edhe duke e përfshirë atë të Bashkimit Evropian, i cili thotë që mandati i pozitive të nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues si hartues i ligjit i ka zhvilluar rregullime që nuk gjenden në asnjë nga vendet e Bashkësisë Evropiane dhe që janë të pazakonta edhe për sektorin privat. Asnjë administratë nuk i ndërpret marrëdhënien e punës një udhëheqësi të njësisë me performancë të mirë, vetëm sepse duhet t'i ofrohet një mundësi një kandidati tjetër, potencialisht më të mirë.

Futja e mandateve nuk do të adresojë asnjë nga dokumentet kryesore, me të cilat përballet administrata e Kosovës, ndërsa do të krijojë destabilitet dhe pasiguri.

Në fund po e përsëris atë që e kam përmendur edhe dje. Bashkimi Evropian ka thënë “Rekomandojmë fuqishëm kundër nisjes së një eksperimenti të tillë në Kosovë.” Faleminderit! Do ta arsyetoj në Kuvend, se me siguri këtu s’votohet.

Kryetari, Valon Ramadani: Mirë. Kush e do fjalën për?

Atëherë, kush është për amendamentin e propozuar nga deputeti Isak Shabani?

Kush është kundër?

Kush abstenon?

Konstatoj që me 6 vota kundër, 2 për, nuk kalon.

Mirë. Vazhdojmë me... Derisa të vijë deputeti Besnik Tahiri, po vazhdojmë me amendamentet që i ka propozuar Qeveria. Na i arsyeton dhe vazhdojmë pastaj me votime. Plus, na ka mbetur edhe një çështje prej Zyrës Ligjore që e lamë çelë, ose çdo çështje tjetër që mendon se është mirë të diskutohet.

Fjala është për Qeverinë.

Zëvendësministri, Bardhyl Dobra: Amendamentet për Projektligjin nr. 08/L-197 për zyrtarët publikë.

E keni edhe dokumentin para jush.

Amendamenti 1 është neni 39, pas paragrafit 7, paragrafët në vazhdim të rinumërohen.

Arsyetim: neni 39 pas paragrafit 7.2 është paragraf 7 në renditje të tekstit dhe duhet të jetë paragraf 8 dhe paragrafët në vijim të rinumërohen, sepse pas paragrafit 12 të të njëjtit nen mungon paragrafi 13.

Kryetari, Valon Ramadani: Kush është për këtë amendament të propozuar nga Qeveria?

Kundër? Abstenim? S’ka. me 6 vota për miratohet.

Vazhdojmë me amendamentin tjetër.

Bardhyl Dobra: Amendamenti 2.

Neni 81, paragrafi 3.2 bëhet 3.1, ndërsa paragrafi 3.3 bëhet 3.2

Arsyetim: Neni 81, paragrafi 3, nënparagrafi 1 është pa tekst në të dy versionet.

Kryetari, Valon Ramadani: Kush është për propozimin e Qeverisë për këtë amendament?

Kundër? Abstenim? S'ka. 6, miratohet.

Vazhdojmë!

Amendamenti tjetër.

Zëvendësministri, Bardhyl Dobra: Neni 84, paragrafi 2 – referencat për nënparagrafët 1.1 dhe 1.2 zëvendësohen me 2.1 dhe 2.1.

Arsyetim: Neni 84, paragrafi 2 është teknik, por që duhet të përmirësohet referenca nga 1.1 dhe 1.2 duhet të bëhet 2.1 dhe 2.2.

Kryetari, Valon Ramadani: Kush është për amendamentin e propozuar nga Qeveria?

Kush është kundër? Abstenim? Për këtë amendament janë 7 vota për, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Vazhdojmë tutje:

Zëvendësministri, Bardhyl Dobra: Neni 99, paragrafi 2 i projektligjit riformulohet si në vijim: Më së voni një vit pas hyrjes në fuqi të këtij ligji për të gjitha pozitat e nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues do të shpallet procedura e rekrutimit sipas radhës së planifikuar përmes konkursit të hapur dhe publik, përjashtimisht për pozitat të cilat kanë qenë të lira dhe janë plotësuar gjatë fazës transitorë të rekrutimit sipas nenit 98 të këtij ligji.

Arsyetim: Në këtë mënyrë, në mënyrë që për institucionet të jetë rekrutimi më fleksibil si dhe të kenë afate më fleksibile, propozojmë këtë ndryshim.

Kryetari, Valon Ramadani: Kush është për këtë amendament të propozuar prej Qeverisë.

Kundër? S'ka. Abstenim s'ka. Miratohet me 6 vota për.

Vazhdojmë tutje.

Zëvendësministri, Bardhyl Dobra: Neni 4, paragrafi 3 riformulohen termat, shprehjet dhe shkurtesat e përdorura në këtë ligj për institucionet e administratës shtetërore e kanë të njëjtin kuptim me atë të përcaktuar në ligjin përkatës për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe të agjencive të pavarura dhe legjislacionit relevant në fuqi.

Arsyetim: Me qëllim që të evitohen pasaktësitë në përdorim të termeve, si dhe të jetë në harmoni me standardet e hartimit, propozojmë këtë riformulim të nenit.

Kryetari, Valon Ramadani: Kush është për propozimin e amendamentit nga Qeveria?
Kundër s'ka, abstenim s'ka, miratohet me 6 vota për. Vazhdojmë tutje.

Zëvendësministri, Bardhyl Dobra: Neni 46, paragrafi 10 riformulohet me qëllim të referencës së gabuar, deri në emërimin në një pozitë të kategorisë profesionale nëpunësi civil vendoset në listën e pritjes dhe gëzon të drejtat ashtu siç përcaktohet në nenin 67 të këtij ligji.

Arsyetim: Me qëllim të caktimit të referencës së saktë.

Kryetari, Valon Ramadani: Kush është për këtë propozim të amendamentit të Qeverisë?
Kundër s'ka, abstenim s'ka, me 6 vota për miratohet. Vazhdojmë tutje.

Zëvendësministri, Bardhyl Dobra: Neni 49 paragrafi 12 riformulohet me qëllim të evitimit të referencës së gabuar. “Deri në emërimin në një pozitë të kategorisë profesionale nëpunësi civil vendoset në listën e pritjes dhe gëzon të drejtat ashtu siç përcaktohet në nenin 67 të këtij ligji.”

Arsyetim: Me qëllim të caktimit të referencës së saktë.

Kryetari, Valon Ramadani: Kush është për propozimin e amendamentit nga Qeveria?
Kundër s'ka, abstenim s'ka, me 6 vota për miratohet.
Vazhdojmë tutje.

Zëvendësministri, Bardhyl Dobra: Neni 62, paragrafi 6, riformulohet me qëllim të evitimit të referencës së gabuar. “Anëtarët e jashtëm që emërohen nga titullari a institucioni tjetër shtetëror, sipas paragrafit 9.2 të këtij neni, përzgjidhen në bazë të një procedure transparente publike dhe konkurruese.”

Arsyetim: Me qëllim të caktimit të referencës së saktë.

(Ndërprerje e incizimit)

Kryetari, Valon Ramadani: A ka mundësi për sqarim?

(Ndërprerje e incizimit)

Vazhdojmë. A i keni dokumentet tash. Merreni kohën, lexoni edhe po vazhdojmë. Këtë gjë ke mundur të ma thuash në fillim të mbledhjes, të thoshe “Ndalu pak, se unë s’i kam letrat.” Merreni kohën, lexoni. Tash e vazhdojmë.

Agim Veliu: Te shtëpia e merr e lexon...

Kryetari, Valon Ramadani: Jo more, te shtëpia.

Meliza Qorraj: Kanë të drejtë kolegët, është menduar për nenin 60, paragrafi 6, çështje të njëjtë të cilën e kanë ngritur edhe këta, por si duket është gabim teknik. Domethënë, ne tërhiqemi nga amendamenti, sepse është amendamentuar.

Kryetari Valon Ramadani: Po. Fjalën e ka zëvendësministri.

Zëvendësministri, Bardhyl Dobra: Amendamenti 10 pra tërhiqet.

Kryetari, Valon Ramadani: Amendamenti 10 tërhiqet. Vazhdojmë te amendamenti 11. Ju lutem për qetësi.

Zëvendësministri, Bardhyl Dobra: Neni 6, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 riformulohet si në vijim: 1.2, anëtarët e shërbimit të jashtëm.

Arsyetim: Sipas Ligjit përkatës për shërbimin e jashtëm përcaktimi i saktë është sipas amendamentit të propozuar.

Kryetari, Valon Ramadani: Mirë, atëherë kush është për amendamentin e propozuar të Qeverisë?

Kundër s’ka, abstenim s’ka, me 6 vota për miratohet. Veç pak, a votoni kundër apo abstenim? Për amendamentin 11 të Qeverisë.

Atëherë, a ka nevojë edhe një herë ta hedh në votim? Po, thuaje. E ka një vërejtje deputeti Shabani.

Isak Shabani: Unë po e arsyetoj edhe atë dje që e kam thënë, se jemi duke nxituar dhe po gabojmë. Neve po na e lexoni paragrafë pa e pasur mundësi me pa se si ka qenë në ligj. S’po mund as t’i shfletojmë kur po e qet në votim. Të lutem! Kjo është shumë e padrejtë për neve në komision, kur po na pamundësohet me dhënë mendimin.

Kryetari, Valon Ramadani: Mirë. Merreni kohën e juaj për të analizuar... Mirë, a ka nevojë dikush tjetër për ... Derisa të analizohet neni me amendamentin, kur të jeni gati kallëzoni, e hedh në votim.

(Ndërprerje e incizimit)

Ka përfunduar koha për analizë të nenit.

Kush është për që amendamenti 11...

Veç pak, qysh? I ke, i ke, ngjitur i ke komplet deri në fund.

Mirë. Atëherë, po vazhdojmë.

Kush është për amendamentin 11 të propozuar nga Qeveria? Besnik, për amendamentin 11. OK.

Kush është kundër? Abstenim? Me 6 vota për miratohet amendamenti 11.

Vazhdojmë me amendamentin 12.

Zëvendësministri, Bardhyl Dobra: Paragrafi 3 i nenit 16, riformulohet si në vijim: Njësia për menaxhimin e burimeve njerëzore në nivelin komunal i zhvillon procedurat për pranimin në punë për zyrtarët publikë në përputhje me përcaktimet e këtij ligji.

Arsyetim: Për qëllim të saktësimit të kompetencave.

Kryetari, Valon Ramadani: Derisa të bëhet analiza e nenit me amendamentin, pastaj përgatitemi për votim.

(Ndërprerje e incizimit)

Mirë. A u mor votimi? A ishte në rregull? A e keni analizuar. A vazhdojmë me votim? Derisa s'ka kundër, ne po vazhdojmë.

Mirë. Atëherë, ne po vazhdojmë me votim.

Kush është për amendamentin 12, të propozuar nga Qeveria?

Kundër s'ka, abstenim s'ka, me krejt votat miratohet propozimi.

E kemi propozimin e amendamentit nga Besnik Tahiri, deputeti që kur i ka ardhur momenti...

Isak Shabani: Kryetar, këtu qenka edhe një nen.

Kryetari, Valon Ramadani: Cili bre?!

Isak Shabani: 99, amendamenti 6, a u propozua a, a kaloi a?

Kryetari, Valon Ramadani: Mos është ai i pagave, këqyre mirë.

Isak Shabani: A po shihni qysh na i keni mbështjellë, pash zotin! Hyni në amendamentin 46, dëgjo, dëgjo.

Kryetari, Valon Ramadani: Veç pak, jo, jo, nuk e pranoj këtë send. Unë prej atij momenti që më the ti shko ngadalë, unë më ngadalë ku me shkua më. A e keni marrë kohën, a e keni analizua? Po. Hajde shkojmë në votim, tash jo valla pak shpejt. A din, qysh me thënë!!!

Po, qysh s'ka mundësi!? Sa të duash herë. Fjala është për ty, zoti deputet.

Isak Shabani: Veç a e ke vërejtur. Kemi ardhur në fund, qe amendamentin 3, jo te amendamenti 12, në fund tash që e votuam edhe thoni, ngom, kthenu në paragrafin 3, neni 16. Tash ktheheni këtu në amendamenti 6, kthenu në nenin 99, në vend që me shku në renditje krejt neneve ku ka komente, e keni ndryshu edhe na keni shkaktuar huti.

Kryetari, Valon Ramadani: Veç pak, s'ishte Besnik Tahiri këtu. OK, qe për këtë punë po e kthejmë edhe një herë nenin 12, amendamentin 12. Ka nevojë, ka. qe po dua me shkua krejt në vij. Po, ti a po dëgjon deputetin.

(Ndërprerje e incizimit)

Kështu. Unë jam duke e udhëhequr mbledhjen, deputetë, unë mendoj që ky propozim i amendamentit 12 duhet të hyjë edhe një herë në votim. Zoti Shabani, merre kohën, analizoje nenin. Derisa të na thotë... Zonja deputete, a ka mundësi, ose po e marrim pauzë, nuk jeni duke lejuar të vazhdojë mbledhjen, as Arbëresha, as Hykmetja. Unë propozoj, që derisa Isak Shabani, deputeti të thotë që e ka marrë kohën dhe e ka analizuar, kjo...

Në mos u pajtofs, Arbëreshë, e qesim në votë pra. Ky është mendimi im. Nëse ke diçka tjetër, e shton. Isak Shabani e pati ankesën, nëse ka diçka të shtojë, mirë, nëse jo, vazhdojmë. Deputet, fjala është për ty.

Isak Shabani: Jo, jo, unë plotësisht pajtohem me deputeten. U kry kjo punë tash. U votua një herë e s'ka këtu amendament.

Kryetari, Valon Ramadani: Ti më ktheve mua e tash prapë... Në rregull është. OK, Vazhdojmë. Qeveria e ka edhe një amendament shtesë, e ka kërkuar. Vazhdojmë.

Zëvendësministri, Bardhyl Dobra: Faleminderit!

Ju propozoj që neni 6 të amendamentohet si në vijim: të shtohet edhe një nënparagraf tek paragrafi 2 i nenit 6, jo nënparagraf, por vetëm të shtohet edhe një fjali: Në rast të rregullimit me ligj të veçantë për shërbyesin civil me status të veçantë, dispozita mbizotëruese është mbizotëruese ndaj dispozitave të ligjit të veçantë.

Pra, propozimi është: në rast të rregullimit me ligj të veçantë për shërbyesin civil me status të veçantë, dispozita mbizotëruese janë dispozitat e ligjit të veçantë.

Kryetari, Valon Ramadani: Deputetë, a e keni të qartë? A ka nevojë me i përsëritë edhe një herë nenet? Domethënë, në rregull jemi, apo jo? Merre mikrofonin, Besnik, nëse don. Fjalën e ka Besnik Tahiri.

Besnik Tahiri: ... e kuptova unë, shërbimin e jashtëm nuk vlen ky ligj, po vlen rregullimi i ligjit tjetër, kjo është.

Kryetari, Valon Ramadani: Derisa hymë në debat të kësaj pike, po. Vazhdo, zonja deputete.

Hykmete Bajrami: Unë mendoj që një amendament, ose një sqarim, i tillë është komplet i panevojshëm, përderisa nëse s'gaboju në nenin 6 ju i keni cekur institucionet të cilat përjashtohen në këtë ligj dhe do të rregullohen me ligje të veçanta. Tash, pse ke nevojë më vonë të tregosh që kanë me mbizotërua. Domethënë, në momentin kur ke thënë: Fusha të caktuara për institucione të caktuara kanë me u rregullua me ligje të veçanta, ky farë shpjegimi tash edhe amendamenti komplet është i panevojshëm. I ke thënë një herë ato. Në momentin kur thuash "Për Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe stafin dhe agjencitë e saj, për Ministrinë e Mbrojtjes dhe agjencitë e saj, këto e këto kompetenca kanë me u rregullua me ligje të veçanta, ajo nënkuptohet që kanë me mbizotërua dispozitat e atij ligji.

Ju veç duheni me thënë, kur ka kolezion në mes të ligjeve që mbizotërojnë, ajo kishte me qenë ndoshta më...

Kryetari, Valon Ramadani: Mirë. Fjala është e zëvendësministrit për sqarim.

Zëvendësministri, Bardhyl Dobra: Ne qëndrojmë prapa propozimit. Është thjesht për të evituar dykuptimësi dhe propozojmë të shtohet ky paragraf.

Kryetari, Valon Ramadani: Edhe një herë. Përsëriteni edhe një herë përkufizimin.

Zëvendësministri, Bardhyl Dobra: Po! Në rast të rregullimit me ligj të veçantë për shërbyesin civil me status të veçantë, dispozita mbizotëruese janë dispozitat e Ligjit të veçantë.

Kryetari, Valon Ramadani: Po! E ka kërkuar prej Zyrës Ligjore, urdhëro, fjala për ty!

Muhamet Bytyqi: E kuptoj plotësisht. Atëherë, ky propozim bie në kundërshtim komplet me frymën e ligjit, se po do të nxjerrë një kategori të veçantë jashtë ligjit. Këtu e ka përkufizuar, sa i përket përjashtimit të nëpunësve civilë me status të veçantë, elemente të marrëdhënies së punës atë që e ka prej frymës së parë, që ke thënë që vetëm kushtet, të drejtat specifike për institucione do të rregullohen.

Sa i përket kategorizimit e këto, është barrikadim, ky është ligji që duhet të ndërtojë standardet dhe ato frymën e ligjit. Edhe ashtu i ke, zëvendësministër, përjashtues. Elementet e veçanta sa i përket marrëdhënies së punës në vijim në mënyrë taksative i ke përmend. Kushte të veçanta për shtesa të rekrutimit, të drejtat dhe detyrimet specifike, rregullat e veçanta... tash çka kërkohet përjashtimisht me qatë ligj të veçantë edhe është parim në drejtësi, se ligji i veçantë mbizotëron në raport me ligjet tjera.

Tash, nuk e di pse do të japim një të tillë, nuk po i besoj për besë, mos po na nxjerr telashe në zbatim mandej, ose mos po krijohet një hendek që me kalua nëpër institucione të veçanta.

Kryetari, Valon Ramadani: Mirë. Atëherë, unë mendoj që ka ardhur koha tash që të shkojmë në votim për këtë amendament të propozuar prej Qeverisë.

Kush është për këtë amendament?

Kush është kundër?

Kush abstenon?

3 kundër, asnjë abstenim.

Vazhdojmë tutje.

Më fal, Besnik, ti që ke dalë një herë prej rendit, pastaj... e ka kërkuar fjalën zëvendësministri.

Zëvendësministri, Bardhyl Dobra: Vetëm desha, në fakt u fol më herët për tërheqjen e paragrafit 1.8 të nenit 6 për Byronë shtetërore.

Kryetari, Valon Ramadani: Veç të marrim pak kohë e ta shohim cilin edhe një herë, se...

Kush e ka propozuar këtë? Zyra Ligjore, a po?

Zëvendësministri, Bardhyl Dobra: Po! Kështu që, në fakt ne po propozojmë që të mbetet në ligj, të mos tërhiqet nga projektligji, kështu që ju lus ta rikonsideroni.

Kryetari, Valon Ramadani: OK. Atëherë, kush është për versionin që të hiqet propozimi që ka qenë prej Zyrës Ligjore?

Kush është për?

Kush është kundër?

Abstenim s'ka.

6 për, 3 kundër, mbetet propozimi i Qeverisë.

Adnan, mirë se erdhe kryetar! Veç vazhdo, në rregull është.

Atëherë, çfarë propozimi ka Besniku?

Në fund, deputeti që i propozon amendamentet është Besnik Tahiri. Ju lutem për vëmendje, se nuk po dëgjohet deputeti.

Besnik Tahiri: I nderuar, s'ka kushte për punë.

Faleminderit!

Amendamenti i parë lidhet me Ligjin e pagave. A s'kemi ardhur? Ani.

Amendamenti i parë lidhet me nenet 44, 46, për procedurat e emërimit të nëpunësve të ulët dhe të mesëm drejtues.

Propozoj të rishkruhet tërësisht dhe të kthehet rregullimi siç është tani në Ligjin për zyrtarët publikë, pra të kthehet sistemi i karrierës, lëvizjes brenda kategorisë dhe ngritjes në detyrë, siç është tek neni 38 dhe 39 i Ligjit për zyrtarët publikë, i cili është në fuqi. Pra, kjo lidhet me diskutimin që e kemi pasur dje, që është ezauruar dhe pres prej teje me e votua këtë. Eh.

Amendamenti 2,

Të fshihet neni 99, të fshihet paragrafi 2 – 9, pasi që janë tërësisht në kundërshtim me Kushtetutën dhe me parimet e së drejtës ligjore të fituar.

Amendamenti 3,

Te rekrutimi i pozitave të nivelit të lartë drejtues, te neni 47, lista fituese të përbëhet nga tre kandidatë që kanë fituar më së shumti vota, nga pragu prej 70%, por jo të gjithë kandidatët mbi 70%. Përzgjedhja në parim të bëhet e kandidatit që ka fituar më së shumti vota e nëse përzgjidhet kandidati i dytë, ose i tretë, të kërkohet arsyetimi me shkrim për qëllimin e sigurimit të pranimit të meritokracisë. Faleminderit!

Kryetari, Valon Ramadani: Faleminderit, i nderuar deputet!

Para se ta hedhim në votim, duhet me marrë kohë një herë, qysh e patëm edhe për ato amendamentet tjera. Si deputetët, si Qeveria, për mua është shumë me rëndësi mendimi i

Qeverisë për këtë amendament, se mundet edhe me... qysh me thënë, është determinuese edhe qysh kam me e votua unë këtë amendament, si deputet që jam, pa pasur nevojë të më bëjë presion dikush, unë vendosi vet si deputet se qysh votoj. E dëgjoj deputetin, e dëgjoj Qeverinë, Zyrën Ligjore, kushdo që jep mendim për një çështje, por unë votoj qysh të bindem.

A ka mundësi Qeveria të na japë mendimin për këtë amendament, amendamentin e parë të Besnik Tahirit?

Zëvendësministri, Bardhyl Dobra: Ne qëndrojmë prapa versionit që e keni në projektligj. Jemi duke e bërë një reformë rrënjësore të administratës publike, e cila ka për qëllim profesionalizimin e saj. Aktualisht, siç e kemi përmendur edhe dje, kemi në pozitat menaxheriale në të gjitha nivelet shumë pak gra, pra përqindjet janë, jo shqetësuese, por alarmante dhe me një sistem i cili është çfarëdo tjetër, përveç sistem i karrierës. Nuk mund të ketë promovim të grave, nuk mund të ketë promovim të komuniteteve, apo edhe të profesionistëve që janë në nivelin profesional, sepse ato pozita menaxheriale sot janë të përherëshme. Pra, thënë ndryshe, kjo është sikurse në sistemet aristokrate, ku trashëgohen dhe mbahen përjetësisht pozitat.

Qëllimi i reformës që ne po propozojmë është që të profesionalizohet administrata, të krijohen mundësi për të gjithë ata që duan të kontribuojnë dhe të mos mbeten peng e udhëheqësve të tyre, të cilët ose nuk kanë ambicie të ngritën tutje në detyrë, ose nuk janë të interesuar që t'u japin mundësi talenteve që janë në nivelin profesional që të ngritën në detyrë.

Kjo vlen po ashtu, edhe për ata që janë jashtë sistemit. Aktualisht, është e pamundur që të kemi rekrutime nga jashtë në këto pozita, sepse thuhet që janë pozita karriere dhe duhet vetëm të ngritën nga niveli profesional, por që ajo ngritje nuk ndodhë për shkak të pamundësive që ky ligj që kemi sot i ka krijuar.

Pra, në mënyrë që të ngritët dikush në detyrë, fatkeqësisht duhet që dikush të pensionohet, ose të vdesë që të lirohet ajo pozitë, në mënyrë që ta kemi. Ne qëndrojmë prapa propozimit tonë.

Kryetari, Valon Ramadani: Kështu, mu duk mua që deputeti Tahiri i lexoi tri amendamente.

Besnik Tahiri: Po. Unë për të parin. Për të parin kisha pasur qejf për transkript t'i lë edhe unë disa fjalë. Të lutem!

Kryetari, Valon Ramadani: Po, patjetër. Fjala është për Besnik Tahirin, deputetin.

Besnik Tahiri: Shikoni, unë po e nis, për hir edhe të transkriptit, se mendoj që ky transkript do të nevojitet edhe për ankimimin në Gjykatë Kushtetuese.

E para, sistemi i ndërtuar deri më tash në baza të meritokracisë, në shërbim të administratës publike, një herë e përgjithmonë kalon prej sistemit hierarkik meritokratik në një vendim të Qeverisë tek nivelet e ulëta dhe të mesme. Pra, partia politike vendos për këtë temë.

E dyta, informacionet që unë i kam është që përgjatë gjithë procesit SIGMA në grupet punuese i ka dhënë të gjitha paralajmërimet, këshillimet e veta, në mënyrë që kjo të mos ndodhë. Komentet dhe këshillat janë injoruar dhe nuk janë pyetur, nuk janë inkorporuar në procesin e ligjvënies.

E treta, këshillat nuk janë marrë edhe kur këto kanë ardhur në Kuvend. Mos harroni, kryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca, ka marrë një letër nga Bashkimi Evropian, duke i shpjeguar që ky ligj, ky nen dhe ky sistem tanimë i ngritjes në Administratë Publike bie ndesh me krejt angazhimin e BE-së dhe mjetet financiare që i kanë dhënë. Dhe mbi të gjitha, do të thotë është bërë në ditën... Ligji ka kaluar në ditën e deklaratës, e aplikimit për vend kandidat.

Tutje, problemi shkon më andej, se vendimmarrja ka me pas ndikim, jo vetëm tek hierarkia në shërbim civil, por edhe tek nivelet e larta të agjencitë. Pra, me këtë realisht po shembet një sistem dhe po ndërtohet një sistem politik, i cili nuk ka me u ndryshua më kurrë, se asnjë parti s'e ndryshon, për shkak se kurrkush s'do t'ia shkëpusë vetes mundësinë për të marrë vendime e me punësua mbi baza politike. Faleminderit!

Kryetari, Valon Ramadani: Faleminderit, i nderuar deputet!

Po, Fitim, a e dëshiron fjalën? OK, atëherë në këtë... po, veç një moment. Debati tashmë është hapur. E arsyetoi deputeti. Fjalën e ka kërkuar edhe deputeti Agim Veliu, pastaj Qeveria.

Agim Veliu: Faleminderit, kryetar!

Unë bisedova edhe me ju gjatë pauzës, që kam përgatitur disa amendamente, po për shkak se kam qenë në një udhëtim.

Kryetari, Valon Ramadani: Më fal deputet, mendova që po flet për këtë pikë, për këtë amendament.

Agim Veliu: Jo, jo për këtë pikë, por po lidhem.

Kryetari, Valon Ramadani: A lidhet? Amendamenti juaj ka të bëjë edhe me këtë?

Agim Veliu: Po. Kam qenë dje jashtë Kosovës dhe ka ndodhur një keqkuptim, te grupi atje nuk janë protokolluar. Për këtë nen kam paraqitur edhe unë një amendament, po nuk është protokolluar.

Kryetari, Valon Ramadani: Po mirë, a bën kështu? Më fal, deputet! Po e përfundojmë ne me deputetin Tahiri, pastaj ti e vazhdon amendamentin tënd si deputet.

Agim Veliu: Po e njëjta është. Desha të them te neni 99, që nëse shkon kështu qysh po mendoni...

Kryetari, Valon Ramadani: Po, më fal, deputet. Ta përfundojmë te deputeti Tahiri, pastaj ti e merr fjalën, e paraqet amendamentin tënd. Zoti Agim, ti e lexon amendamentin tënd pas deputetit Tahiri. Zoti Veliu, ti e lexon amendamentin pasi ta kryejë amendamentin e vet Besnik Tahiri.

Kështu, për këtë amendament, jo veç pak, se zëvendësministri e ka kërkuar një minutë për të sqaruar diçka, ndoshta edhe mundet me e determinua votën e...

Zëvendësministri, Bardhyl Dobra: Faleminderit!

Vlen të përmendet fillimisht, që siç u cek edhe dje, Bashkimi Evropian nuk ka direktivë për administratë publike. Domethënë, nuk ka direktivë për administratë publike. SIGMA i ka disa parime të veta, të cilat është duke i rishikuar, sepse janë jashtë realitetit të sotëm. Komentet që i ka dërguar Bashkimi Evropian kanë qenë në numër prej 13-ve. Vetëm tri prej tyre nuk janë pranuar. SIGMA ka dërguar 93 komente, vetëm 14 prej tyre nuk janë pranuar.

Pra, i kemi shqyrtuar në detaje komentet, edhe të SIGMA-s, edhe të Bashkimit Evropian, edhe të të gjitha organizatave vendore, ndërkombëtare, të gjithë qytetarët që kanë dërguar komente. Pra, jemi kujdesur që t'i analizojmë të gjitha një nga një. Mirëpo, e kemi një realitet në Kosovë, i përmenda shifrat, përmenden raportet e progresit, meqë po e përmendim kaq shumë Bashkimin Evropian, thonë që administrata është skajshmërisht e politizuar, thonë që ka mungesë profesionalizmi në administratë publike dhe një seri tjera shkeljesh që kanë ndodhur gjatë këtyre viteve sa ekziston raporti i progresit për Kosovë.

Bashkërisht me projektligjin ne e kemi bashkëngjitur atëherë edhe një tabelë, e cila është një përmbledhje e raporteve të progresit nga viti 2012 e tutje. Pra, ky projektligj vjen si rrjedhojë e gjendjes jo të mirë në administratë publike. Sikur të kishte qenë gjendja e mirë, nuk do ta kishim ndryshuar. Nuk ka vend tjetër që nivelet menaxheriale janë me mandate të përhershme, ju lutem!

Kryetari, Valon Ramadani: Mirë. Tash është momenti i votimit i këtij amendamenti.

Kush është për amendamentin e propozuar nga deputeti Besnik Tahiri, amendamenti nr.1?

Kush është kundër?

Abstenim s'ka.

Atëherë ky amendament nuk kalon.

Deputeti i ka lexuar tri amendamentet, na duhet qëndrimi i Qeverisë për amendamentin nr.2. Nëse s'ka, veç kallëzo. Shumë mirë.

Atëherë, amendamenti 2.

Kush është për amendamentin e propozuar nga deputeti Besnik Tahiri?

Kush është kundër?

Abstenim s'ka.

Nuk miratohet.

Kush është për amendamentin 3, të propozuar nga deputeti Besnik Tahiri?

Kush është për?

Kush është kundër?

Abstenim s'ka.

Nuk miratohet.

Vazhdojmë te deputeti Agim Veliu.

Agim Veliu: Unë, sikurse ju thash, kam menduar të paraqes amendament te neni 99, dispozitat kalimtare, ndryshohet si në vijim: Nëpunësit civilë e kanë fituar të drejtën e kontratës pa afat me Ligjin në fuqi nr. 06/L-114 për zyrtarët publikë, si dhe me Ligjin e mëparshëm për shërbimin civil nr. 03/L-149. E drejta e fituar për punësim përmes procedurave ligjore nuk mund t'i merret askujt me miratimin e këtij ligji.

Arsyetim: E drejta e fituar për punësim, sikurse dihet, mund t'i merret të punësuarve vetëm pasi që të plotësohen kriteret e caktuara ligjore dhe vetëm përmes procedurave të parapara me ligj, dhe në asnjë mënyrë en-block, për të gjitha pozitat drejtuese në shërbimin civil të administratës shtetërore dhe komunale.

Kryetari, Valon Ramadani: Faleminderit, i nderuar deputet!

Neve na duhet një koment prej Qeverisë, së paku mua, ose deputetëve tjerë.

Rreth amendamentit që është propozuar prej deputetit? Po, urdhëro!

Hykmete Bajrami: Faleminderit!

Ne e kemi pasur edhe dje një diskutim të gjerë rreth kësaj edhe argumentet, të cilat edhe më herët...

Kryetari, Valon Ramadani: Veç që s'ke ndej deri në fund, tani, veç e ke krye fjalimin edhe ke shkua, nëse e ke fjalën për mbledhjen e komisionit?

Hykmete Bajrami: Unë jam deputete me mandat edhe, kryetar, kur të dua vij edhe kur të dua shkoj, nuk mund të ma caktosh kohën.

Kryetari, Valon Ramadani: Po, mirë, qashtu është, po nuk është fer me ardh me i thënë gjërat edhe me vazhdua. Po, në rregull, vazhdojmë, s'ka problem.

Hykmete Bajrami: Dëgjo, poenta është që ju këtu...

Kryetari, Valon Ramadani: Në momentin që kanë shkuar mediat, ke shkuar edhe ti.

Hykmete Bajrami: Absolutisht, nuk është lidhur ajo me media. Nuk është lidhur me mediat absolutisht, nuk ka pasur të bëjë me mediat, por jam në Komisionin për Reformën Zgjedhore. Të lutem shumë, se besoj që nuk je në nivel për të më cilësuar dhe për të më bërë vlerësime të tilla. Janë të tjerë ata që më vlerësojnë mua. E kam të pestin mandat.

Kështu. Ne kemi pasur diskutime, edhe sot nuk ka media, por po dua të diskutoj. Domethënë, nuk lidhet diskutimi im asnjëherë me mediat.

Kryetari, Valon Ramadani: ... media, po.

Hykmete Bajrami: Mirëpo, argumentet që i keni... Mos më ndërprit, të lutem, se nuk është kulturë!

Argumentet që po i shfaqni, se kjo bëhet për t'i avancuar dhe për të rritur barazinë gjinore në institucione e këto, absolutisht nuk qëndrojnë. Sepse, në asnjë nen të ligjit nuk ka masa favorizuese që nesër paskan me u favorizua gratë nëpër pozita të tilla.

Tjetra është, po thirrni që i keni adresuar komentet e BE-së dhe po harroni që të gjithë ne këtu, edhe në shqip, edhe në anglisht, e kemi bre një letër të Zyrës së BE-së që iu ka dërguar kryetarit të Kuvendit...

Kryetari, Valon Ramadani: Deputete, a mundesh me u kthye në temë, çka propozoi zoti Veliu, je duke folur jashtë temës.

Hykmete Bajrami: Jo, nuk jam jashtë temës. Jam pikërisht në temë, po ju që s'kuptoni është diçka tjetër.

Kryetari, Valon Ramadani: Dje kam toleruar... veç pak, dje kam... qetësi veç pak.

Hykmete Bajrami: Po, nuk ke more të drejtë, nuk ke të drejtë.

Kryetari, Valon Ramadani: Veç pak, unë dje e kam toleruar deputeten, sot ti e keqpërdor fjalën dhe thua që dje, ose sot, unë nuk jam për të cilësuar...

Hykmete Bajrami: A tash e ke problemin që s'ka media!?

Kryetari, Valon Ramadani: Veç pak. Fol, mundësisht në temë, çka ka folur Agim Veliu...

Hykmete Bajrami: Në temë jam, në temë jam.

Absolutisht, domethënë ato që i kam folur dje. Jam kundër marrjes së mandatit në mënyrë arbitrare, sepse kjo është e kundërligjshme. Ky ligj ka me shkua në Gjykatë Kushtetuese. Këtë ligj po e kundërshton BE-ja. Ju keni aplikuar për BE-në edhe...

Kryetari, Valon Ramadani: Jo, jo ne, Kosova ka aplikuar.

Hykmete Bajrami: ... jeni në një rrugë e cila është kontra BE-së. Ju që po i bëni, sepse fotografitë janë tuajat, që keni dalë në aplikacione.

Kryetari, Valon Ramadani: Po, ama s'ka aplikuar Vetëvendosja për BE, por Kosova.

Hykmete Bajrami: Me aplikacione keni dalë ju dhe po punoni kundër standardeve të BE-së. Kjo është ajo që po e themi, sepse këtu po thuhet që këto janë praktika që nuk i bën asnjë vend i BE-së dhe asnjë vend i OECD-së. I kemi bre letrat përpara, mos u mundoni të na hidhni hi syve, se kinse po i bëni për barazi gjinore, se paska pak gra në pozita udhëheqëse, se kinse po doni të stimuloni diasporën të vijë, e gjëra të tjera.

Nuk janë këto argumente, absolutisht nuk janë argumente. Janë të paqëndrueshme dhe këtë ligj në momentin që ky atakohet në Gjykatë Kushtetuese, domethënë ky ligj rrëzohet. Dhe, po e bëni jofunksionale komplet një administratë. Sot ka mekanizma, që përmes vlerësimeve e degradon personin, e largon prej pune dhe të gjitha këto gjëra ndodhin.

Nuk e ka kurrkush pozitën e përgjeshme derisa nuk performon.

Kryetari, Valon Ramadani: A ke amendament konkret, deputete, se je duke na mbajtur në debat kot, a po kupton.

Hykmete Bajrami: Amendamenti është i zotit Veliu, të cilin po e përkrah.

Kryetari, Valon Ramadani: Po, mirë de, e përkrah dhe po vazhdojmë.

Hykmete Bajrami: Për ata hapet debati për amendament, në mënyrë që...

Kryetari, Valon Ramadani: Kemi pasur debat dhe për këtë temë, tash jemi te amendamentet.

Hykmete Bajrami: ... me e mbështet qëndrimin. OK, po dhe paska pasur media e sot s'ka media. Tash, nuk po di kur po të përshtatet, a më kupton. Je komplet nën çdo nivel.

Kryetari, Valon Ramadani: Faleminderit, e nderuar deputete! Zoti Veliu, a ke diçka shtesë?

Agim Veliu: Jo.

Kryetari, Valon Ramadani: Kush është për propozimin e deputetit Veliu të amendamentit që sapo e prezantoi?

Kush është kundër?

Kush abstenon?

Mirë. Atëherë, 3 kundër, një abstenim, 4 për.

Më fal, 3 për,... qashtu më the ti, tash e incizova unë këtu.

... që nuk kalon propozimi.

Vazhdojmë te amendamenti tjetër. A pate edhe tjetër?

E tash, këtu është pak problemi. Unë kisha dashur që ky amendament të shkojë në Kuvend, po derisa nuk është i...

Veç pak, tash unë e pata një pyetje, ose nëse do... kush po do ta udhëheq mbledhjen. A po do, Fitim edhe Hykmet, ti je kryetar i Komisionit për Mbikëqyrje të Financave, jam shumë i sigurt që me të ardhë dikush me të reagu qashtu qysh po reagon ti, kurrë s'e le me fole, a më kupton, s'e le me fole. Tash, nëse nuk ju pëlqen udhëheqja, kallëzoni, hajde udhëhiq, unë dal qaty. Ama... a kupton... Unë jam duke thënë shumë qartë edhe shumë me vullnet tamam të anëtarëve të komisionit që jemi bashkë këtu. Unë kisha pasur qejf që ky amendament i propozuar prej deputetit, që sapo e tha në fillim që e ka kryer, e ka bërë gati, e ka dorëzuar te... ku di unë ku e ka dorëzuar, por nuk i ka protokolluar me kohë. Edhe, unë kisha pasur qejf që ky amendament të shkojë në seancë, po ky proceduralisht nuk mund të shkojë.

Bekim Haxhiu: Po, po, ka proceduralisht.

Kryetari, Valon Ramadani: Hajde, kallëzoni proceduralisht.

Bekim Haxhiu: Komisioni Funkcional në mandatin e tij ka të drejtë me e bë propozime aty për aty dhe me i qitë në seancë dhe nëse deputetët e komisionit kanë individualisht amendamente në

mbledhje mund t'i propozojnë në shqyrtim projektligjit edhe me dalë në seancë, nëse kanë mendim ndryshe me anëtarët tjerë të komisionit.

Kryetari, Valon Ramadani: Kjo është shmangie në njëfarë forme e kësaj procedurës.

Bekim Haxhiu: Jo procedurës, por Rregullorja e punës dhe e funksionimit të komisioneve parlamentare. Deputetët mund t'i protokollojnë, ne të tjerët, ne mund t'i protokollojmë propozimet tona në administratë, në Zyrën për parashtrës, dhe mund t'i parashtrojnë në komision, nëse janë anëtarë të komisionit. Agim Veliu është anëtar i komisionit i rregullt dhe ky ka të drejtë këtu me e propozua amendamentin dhe me e dërgua në seancë.

Kryetari, Valon Ramadani: Mirë. Atëherë, kështu. Unë e dua një sqarim prej administratës. Nëse është proceduralisht në rregull, unë jam dakord që të shkojë amendamenti edhe në seancë. Po, Mirjeta e ka fjalën.

Mirjeta Heta (zyrtare, Administrata e Kuvendit): Amendamentet të cilat i propozojnë deputetët individualisht duhet të regjistrohen në Zyrën për parashtrës. Anëtarët e komisionit që propozojnë këtu për këtu, nëse komisioni e voton atëherë bëhet si i komisionit dhe kalon në seancë plenare. Si deputet, nuk kalon. Ashtu është rregulli.

Bekim Haxhiu:... bëhet i komisionit, po nëse është individual,

Mirjeta Heta (zyrtare, Administrata e Kuvendit): Po s'është i regjistruar, zoti Bekim. Duhet të regjistrohet individualisht te Zyra për parashtrës. Nëse nuk është i regjistruar mund të propozohet në mbledhjen e komisionit. Nëse përkrahet nga anëtarët e komisionit shkon si e komisionit.

Kryetari, Valon Ramadani: Mirë. Me keqardhje deputet, po në bazë të kësaj procedure, me Rregullore qysh ka shkuar deri tash, nuk procedohet. A ke amendament tjetër, deputet?

Agim Veliu: Po kam, po s'po di a ka kuptim me...

Kryetari, Valon Ramadani: Nëse nuk ka vullnet për t'i lexuar të tjerat...

Agim Veliu: Atëherë, e kam pasur edhe amendamentin 2 te neni 98, që e bëri edhe Qeveria, është në rregull.

Amendamenti 3, neni 57, pika 2.5 të ndryshohet si në vijim: Masa disiplinore e pezullimit nga pozita pa pagesë deri në gjashtë muaj nga Komisioni Disiplinor aplikohet vetëm kur nëpunësi civil është subjekt i procedurës penale.

Arsyetimi: Një tjetër masë disiplinore e papranueshme, e cila me legjislacionin e mëhershëm nuk ka qenë, është pezullimi nga pozita pa pagesë deri në gjashtë muaj nga Komisioni Disiplinor. Kjo masë ka kuptim vetëm kur nëpunësi civil është subjekt i procedurës penale, por jo edhe të jetë masë disiplinore në kompetencë të Komisionit Disiplinor.

Amendamenti 4, neni 25, pika 8 të ndryshohet si në vijim: Nëpunësit civilë të kategorisë së nivelit të lartë, të mesëm dhe të ulët drejtues mund të jenë anëtarë të partive politike dhe mund të jenë anëtarë të organeve drejtuese qendrore dhe komunale të një partie politike.

Arsyetim: Ky projektligj, për dallim nga legjislacioni i mëhershëm, kufizon të drejtën politike të qytetarëve të Kosovës, të cilët janë të punësuar në shërbimin civil, duke ndaluar pozitat e mesme dhe të ulëta drejtuese të shërbyesve civilë të jenë anëtarë të organeve drejtuese qendrore dhe komunale të partive politike.

Amendamenti 5, neni 39, pika 2 plotësohet si në vijim: Punësimi në shërbimin civil bëhet në të gjitha kategoritë e shërbimit civil, nëpërmjet një procedure rekrutuese të hapur dhe publike, përveç kur parashikohet ndryshe. Po ashtu, nëpunësit civilë të një kategorie më të ulët, të cilët dëshmojnë performancë të mirë, të kenë mundësinë e ngritjes në detyrë. Faleminderit!

Kryetari, Valon Ramadani: Faleminderit, i nderuar deputet!

A ka dikush prej Qeverisë të shtojë diçka? Atëherë, kush është për amendamentin, po tash tre i propozoi. A ishin tre? A me i shti në pako të trijat?

Agim Veliu: Shtini në pako, s'është problem?

Kryetari, Valon Ramadani: Në pako. Mirë! Kush është për tri amendamentet e propozuara nga deputeti Agim Veliu?

Kush është për tri amendamentet e propozuara nga deputeti Agim Veliu?

Kush është kundër, abstenim s'ka. Nuk miratohet. Dy vota për, gjashtë kundër, nuk kalon. Amendamentet nuk kalojnë.

Urdhëro deputet.

Agim Veliu: Të kërkohet një sqarim nga Zyra Ligjore eventualisht.

Kryetari, Valon Ramadani: Ok. Nëse mundeni. Unë jam për ta kërkuar prej Zyrës Ligjore. Le ta kërkojë administrata, nëse lejohet ta konfirmojnë administrata, vazhdojnë tutje. Nëse jo, mbetet vendimi qysh është tash.

Komisioni nuk është kundër. Anëtarët e komisionit nuk pat ndonjë reagim që mos të shkojnë këto amendamente.

Nëse proceduralisht Zyra Ligjore e pranon këtë. po mirë, tash është kërkesë e deputetit, drejtojuni Zyrës Ligjore e vazhdojmë tutje.

A është Zyra Ligjore këtu?

Muhamet Bytyqi: Fatbardhësisht e kemi edhe përshkrimin e detyrave të punës.

Aspektin procedural sa i përket interpretimit të kërkesës për interpretim.

Koordinatori i komisionit parlamentar, përshkrimi i detyrave të punës: dhënia e këshillave ligjore e procedurale gojore e me shkrim që kanë të bëjnë me çështjet ligjore e procedurale për punën e komisionit, përgatitja e raportit me rekomandime ... për çështje që shqyrtohen në komision, ofrimin e ndihmës së drejtpërdrejtë në përpunimin e legjislacionit të propozuar.

Kryetari, Valon Ramadani: Veç pak a ka mundësi të na sqarosh ku po lidhet kjo se nuk e kam të qartë unë.

Muhamet Bytyqi: Është Rregullorja e Punës, përshkrimi i detyrave të punës të kolegëve tanë që e dha Mirjeta arsyetimin.

Kryetari, Valon Ramadani: Nuk e di a e ke të qartë cila ishte kërkesa. Kërkesa është që nuk është protokolluar me kohë kur ka qenë afati.

Veç pak.

Muhamet Bytyqi: Të rangohen si amendamente për seancë.

Kryetari, Valon Ramadani: Veç tregona a mundet a jo?

Muhamet Bytyqi: Para se të vijmë në përfundim, neve duhet të adresohemi dhe të kërkojmë prej organit kompetent që ka për obligim të japë këshilla ligjore për komisionin. Përgjegjësia e jona në raport me shqyrtimin e Projektligjit është akt i nënshkruar dhe ne s'mund.

Kryetari, Valon Ramadani: Muhamet a mundesh koncretisht, a ka të drejtë a jo?

Muhamet Bytyqi: Jo, i nderuar. Nuk ka kompetencë unë si këshilltar juridik të them ka të drejtë deputeti a s'ka të drejtë.

Kryetari, Valon Ramadani: Mirë, faleminderit!

Vazhdojmë tutje.

Administrata merret me këtë çështje. Deri të enjten ka kohë nëse ju drejtohen me shkrim. Nëse mund të bëhet kjo punë, mirë, nëse jo, vazhdojmë qysh është procedura.

Pyetja është e qartë, në 12 dje është dashur të dorëzohet amendamenti, edhe pas afatit.

Ajo u krye, në komision e parashtrori, s'kaloi. Po kjo nuk shkon në seancë. Unë e kam të qartë idenë prej fillimit, a po kupton. Unë e kam të qartë.

Agim Veliu: Komisioni nuk ka kundër që të shkojnë si amendamente të miat nëse interpretimi i zyrës Ligjore është ok.

Kryetari, Valon Ramadani: A e kuptove Mirjetë pyetjen edhe njëherë. Kjo e ndihmon procedurën.

Po ama kjo nuk e ndikon këtë, se afati është shkurtuar me votim në Kuvend dhe ajo ka vazhduar.

Agim Veliu: Unë kam qenë dje jashtë vendit, jashtë Kosovës, për atë s'kam mund të vijë.

Kryetari, Valon Ramadani: Për mua është e qartë. Administrata e komisionit e formulon pyetjen në këtë formë ku e shtron edhe në fund që edhe komisioni është në rregull që ky amendament të shkojë edhe në seancë.

Agim Veliu: Ok. Faleminderit!

Kryetari, Valon Ramadani: A ka tjetër? s'ka. Tjetër çështje s'ka. Atëherë, kështu. Besniku nuk është këtu po ne po vazhdojmë, kuorum kemi.

Kush është që këto amendamente të vazhdojnë për komisionet e përhershme?

Kush është për Projektligjin me amendamente të propozuara nga Komisioni për Administratë Publike, Zhvillim Rajonal, Qeverisje Lokale dhe Media?

Kush është për? T'i procedojmë për komisionet e përhershme.

Ok. Kush është kundër?

Abstenim s'ka.

Me 6 vota për, 2 kundër, ky projektligj procedohet për procedurat tutje. Tash po e dini cilat janë ato tutje.

Pesë minuta pauzë që të fillojmë me Ligjin për pagat.

* * *

Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Komisionit, z. Valon Ramadani.

Kryetari, Valon Ramadani: Vazhdojmë me amendamentet për Ligjin për pagat.

Po fillojmë me amendamentet e Ligjit të pagave për sektorin publik.

Deputeti Kujtim Shala ka propozuar dy amendamente në Projektligjin për pagat për zyrtarët publikë, por i ka tërhequr për procedimin e mëtutjeshëm. Të dyjat? A vetëm njëren?

Mirë, te Kujtim Shala tërhiqen amendamentet 1 dhe 2.

Vazhdojmë. Besnik Tahiri ka propozuar një amendament për Projektligjin për pagat për zyrtarët publikë. Për momentin s'është këtu. Shkon në fund atje, sikur herën e kaluar.

Deputeti Isak Shabani ka propozuar gjashtë amendamente në Projektligjin për pagat në sektorin publik.

Deputet a je i gatshëm t'i paraqesësh para Komisionit? Po Qeveria besoj tash e ka vëmendjen t'i dëgjojë, edhe deputetët gjithashtu, këshilltarët ligjorë.

Isak Shabani: Unë e kam propozuar amendamentin e parë. Pas nenit 34 të shtohet një nen i ri 35 si në vijim: Neni 35: shtesat për nëpunësit e administratës së Kuvendit. Nëpunësit civilë të administratës së Kuvendit të Republikës së Kosovës për shkak të natyrës dhe kushteve specifike të punës së Kuvendit dhe disponueshmërisë së përhershme ku tejkalon kufirin e orarit të rregullt

të punës të përcaktuar me ligj, përveç pagaës bazë përfitojnë një shtesë të posaçme deri në 30 për qind të pagës bazë sipas kriterit të caktuar me akt të miratuar nga Kryesia e Kuvendit.

Administrata e Kuvendit ka detyra specifike dhe orar të punës dhe orari i punës bazohet në parimet e përgjegjësisë personale dhe disponueshmërisë së përhershme që nënkupton që nëpunësi publik i Kuvendit të jetë i gatshëm në çdo kohë, pavarësisht kohës së pushimeve, festave apo orarit të vonshëm dhe t'i përgjigjet detyrave me performancë të lartë dhe përgjegjësi shtetërore. Çdo dokument shtetëror procedohet në Kuvend, meqë Kuvendi është institucioni i parë shtetëror, prandaj kërkohet që nëpunësi i Kuvendit të ketë një status të veçantë.

Ndër arsyetimet e tjera kisha përmendur këtë, bazuar në praktikën parlamentare të shteteve të ndryshme, nëpunësi i administratës së Kuvendit ka status të veçantë, përfshirë edhe pagat dhe kompensimet ku në këtë bazë nëpunësit e administratës së Kuvendit janë kompensuar që nga v. 2014. Organizimi i punës së shërbimeve të administratës së Kuvendit, të drejtat dhe obligimet e tjera janë rregulluar me akt të veçantë të miratuar nga Kryesia me propozim të Sekretarit të Kuvendit.

Kryesia e Kuvendit me akt të veçantë, bazuar në kompetencat e përcaktuara në Rregulloren e Kuvendit dhe në legjislacionin për shërbimin civil ka vendosur për kushte specifike, për orar të punës dhe për kompensimin e nëpunësve të administratës së Kuvendit.

Nëpunësi civil i administratës së Kuvendit në çdo kohë ka detyrim t'i përmbushë detyrat e tij duke u siguruar që kërkesat e punës së Kuvendit të përmbushen brenda afateve specifike. Administrata e Kuvendit ka detyra specifike andaj edhe orari i punës bazohet në parimet e përgjegjësisë profesionale dhe disponueshmërisë së kahershme dhe mund të tejkalojë kufirin e orarit të rregullt të punës të përcaktuar me ligj.

Projektligji nr. 08/L-196 për pagat në sektorin publik nuk ka pasur parasysh të drejtat dhe përgjegjësitë e nëpunësve të administratës së Kuvendit, të drejta këto të parapara me Rregulloren e Kuvendit të Republikës së Kosovës, Ligji nr. 03/L-149 për shërbimin civil, Ligjin nr. 06/L-114 për zyrtarët publikë dhe aktet e tjera të cilat parashohin si vijon.

Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Kosovës ka hyrë në fuqi më 9 gusht 2022 dhe në nenin 12 është përcaktuar struktura organizative e administratës së Kuvendit. Kryesia e Kuvendit është përgjegjëse për funksionimin dhe organizimin e administratës së Kuvendit, siç përcaktohet në paragrafin 3.4 të nenit 19 të Rregullores së Kuvendit si vijon: Bazuar në natyrën dhe kushtet specifike të punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, me propozim të Sekretarit të Përgjithshëm, me akt të veçantë rregullon organizimin dhe funksionimin e administratës së Kuvendit, klasifikimin e pozitës, koeficientin, gradën, kompensimin e rekrutimit, të orarit të punës dhe pushimin vjetor.

Prandaj, unë propozoj që ky amendament të përkrahet.

Kryetari, Valon Ramadani: Faleminderit i nderuar deputet!

A ka ndonjë koment Qeveria?

Meliza Qorraj: Për ta sqaruar, kjo shtesë e cila është propozuar prej deputetit Shabani është në funksion të kompensimit për punën jashtë orarit të punës. Ne e kuptojmë që specifikat e institucionit të Kuvendit, kjo ndoshta pak më ndryshe sesa institucionet e tjera shtetërore, gjithsesi ashtu qysh është edhe legjislacioni për punë, kemi paraparë që puna jashtë orarit të punës të trajtohet në mënyrë të njëtrajtshme për gjatë gjithë sektorit publik, ashtu qysh parashihet kushdo që punon jashtë orarit të rregullt të punës i cili përcaktohet me aktin e brendshëm, d.m.th. me rregulloren e brendshme që është 8 deri 4, paguhet për punën jashtë orarit 20 për qind mbi pagën bazë, për punën gjatë festave dhe në fundjavë paguhet 50 për qind mbi pagën bazë, ndërsa për kujdestari është 30 për qind. Nëse nuk e kam pështjellë punën jashtë orarit me punën. D.m.th. për të pasur rregullim të njëtrajtshëm, kjo rregullohet edhe me legjislacionin relevant për punë, ndërsa Ligji për paga nuk ka krijuar kushte të ndryshme nga ato që i ka paraparë Ligji i pagave dhe rekomandojmë fuqishëm që të vazhdojmë të jenë të njëtrajtshme për gjithë sektorin publik.

Kryetari, Valon Ramadani: Faleminderit e nderuar!

Po pa problem. Deputeti ka të drejtë.

Isak Shabani: Sa i përket kësaj që lexoi kolegja, po pajtohem që neni 36 është përfshirë edhe kjo. po ju kisha lutur, lexojeni edhe paragrafin 3 të këtij neni 36. Vlera totale e kompensimit për punën shtesë të orarit të rregullt nuk mund të jetë më e lartë se një për qind e fondeve totale të përdorura nga organizata buxhetore në kategorinë e shpenzimeve, paga dhe shtesa të atij viti fiskal. D.m.th. ka mundësi me këtë të bie jo njëzet, po 0.1 për qind nëse s'ka të hyra, nëse s'ka grubmullim. Kështu që po më duket pa arsye është kjo, se bie në kundërshtim me atë paragrafin përpara.

Kryetari, Valon Ramadani: Ju lutem qetësi. Po, patjetër.

Meliza Qorraj: Ne kemi marrë edhe komente prej Fondit Monetar Ndërkombëtar që të ketë tek të gjitha shtesat dhe kompensimet kufizime buxhetore që mos të tejkalohet buxheti. Ashtu qysh kemi rekomanduar te të gjitha institucionet, rekomandojmë shumë edhe Kuvendit që organizimin e punës ta bëjë në atë mënyrë që të menaxhojë në mënyrë efikase edhe burimet njerëzore, edhe ato financiare.

Sidoqoftë, në rastet kur kjo nuk arrin t'i përmbushë kërkesat e Kuvendit, paragrafi 4 thotë që: institucionit, në këtë rast Kryesia e Kuvendit, mund ta tejkalojë kufizimin buxhetor prej...

Kryetari, Valon Ramadani: Ju lutem qetësi, se nuk po dëgjohet. Veç pak, Melizë.

Nëse ka mundësi edhe një herë të përsëritet kjo pjesë. Arbëreshë edhe Hykmet nëse ka mundësi vëmendjen se unë nuk dëgjova asgjë prej.

Edhe njëherë duhet ta përsëritësh. Më fal, po unë s'kam dëgjuar asgjë.

Meliza Qorraj: Pa merak! Ne d.m.th. gjatë diskutimeve që kemi pasur me Ministrinë e Financave po edhe me organizatat të cilat e ndihmojnë Qeverinë në menaxhimin sa më të mirë të financave publike, është kërkuar që gjithmonë të ketë shumë kujdes, sidomos te shtesat që janë për punën jashtë orarit për këto kompensimet, për shkak se janë jashtëzakonisht të larta në numër e shpeshherë të paarsyetuara. Për këtë arsye, e kemi vendosur kufizimin prej 1 për qind, duke e pasur parasysh që ka raste sikurse që është shëndetësia ose qysh mund të jetë Kuvendi kur kjo shtesë për shkak të seancave të shumta që zgjasin jashtë orarit të rregullt të punës, në paragrafin 4 e kemi paraparë që Qeveria ose organet kompetente të institucioneve që kanë pavarësi prej Qeverisë, me vendim të organeve kryesuese të këtyre institucioneve, kufizimi prej 1 për qind mund të tejkalohet, gjithmonë kjo duhet të bëhet në harmoni me Ligjin përkatës për menaxhimin e financave publike.

Isak Shabani: Krejt në fund, edhe diçka nëse bën. Edhe një fjalë e kam, nëse bën. Veç edhe një fjalë e kam.

Kryetari, Valon Ramadani: Si s'bën, ti je propozues i amendamentit.

Isak Shabani: Kur po thirresh në paragrafin 4, këtu thotë: veç në situata emergjente ka të drejtë ta kalojë këtë. prandaj, kjo po më duket që s'duhet të qëndrojë.

Kryetari, Valon Ramadani: Po vazhdo, Melizë.

Meliza Qorraj: Situata emergjente, sepse prapë jemi të mendimit që planifikimi i mirë i resurseve njerëzore e lejon që fondet 1 për qind të jenë të mjaftueshme. Ne e kemi diskutuar me shumë organizata buxhetore që mund ta bëjnë p.sh. për punëtorë të caktuar ta bëjë organizimin në atë formë që të rregullohet dhe të mjaftojë 1 përqindëshi. Ne i qëndrojmë prapë kësaj, sepse është mënyra e vetme për të siguruar që menaxhimi i fondeve publike do të jetë në harmoni me Ligjin për financat publike.

Kryetari, Valon Ramadani: Faleminderit! i nderuar deputet, a ke diçka.

Po mendoj që për te kjo pikë e ka arsyetuar deputeti dhe duhet të shkojmë në votim. po si s'ke të drejtë? Ama shkurt.

Besnik Tahiri: Jemi duke folur, që tash kur thotë përqindja kjo, përqindja ajo, duhet ta kthejmë në terma praktikë. Në terma praktikë, buxheti është 2.2, a është ashtu. Një për qind i 2.2 është 22 mijë. Kur ta ndash 22 mijëshin në dymbëdhjetë muaj, i bie 1800 euro. 1800 euro, sa jeni këtu staf krejt? D.m.th. jemi duke folur për 250 staf. 1800 nga do t'i shqyesh për 250 njerëz. Çka po sqarojmë ne në qoftë se ka mundësi, në qoftë se jemi në debat. D.m.th. ne jemi duke folur, folëm dje kur thamë që stafi rri pas orarit të punës, pas orarit të punës institucioni përgjegjës merr detyrime për të bërë kompensime. D.m.th. është e pamundshme.

Të gjithë ne e dimë që stafi merr, rri me neve në seanca, në komisione e kështu me radhë. Kur i shohim numrat p.sh. një përqindëshi kushtimisht për ndonjë buxhet të madh ka kuptim, mirëpo në rastin konkret 2.2 milionë, 22 mijë euro është njëpërqindëshi, kur e ndaj në dymbëdhjetë muaj është 1800 euro. Këtë 1800 euro do ta ndash te 250 njerëz. Hajde po themi që 250 nuk rrinë krejt, qe për realitet po themi që s'rrinë, po edhe njëqind nëse rrinë, jemi duke folur për 18 euro. Faleminderit!

Kryetari, Valon Ramadani: Po, faleminderit shumë deputet!
Atëherë vazhdojmë në votim. kush është për amendament?

Urdhëro!

Kush është për amendamentin 1 të propozuar nga deputeti Isak Shabani?

Kush është kundër?

Abstenim?

Abstenim s'ka. Konstatoj që me 3 vota për dhe 6 kundër nuk kalon ky amendament.

Unë propozoj që të kthehet rendi i ditës tash te Besniku.

Vazhdo Besnik.

Besnik Tahiri: A jeni dakord ta dëgjoni këtë amendament. Amendamenti im e kam thënë edhe dje edhe sot me një kërkesë të thjeshtë. Te neni 9 i projektligjit, te paragrafi i ri të shtohet paragrafi i ri 9.3, veç një fjali: vlera e koeficientit të jetë 129 euro. S'kemi çka. Unë mund të vazhdojë edhe për transkriptin të flasë që d.t.th. kjo vlerë për dy elemente është me rëndësi për

mua. E para, te sektori i sundimit të ligjit kur frikësohem se do të kontestohet në Gjykatë Kushtetuese, e përfron parashikueshmërinë. E dyta, duke e marrë inflacionin dhe duke e marrë kalkulimin me këtë numër, realisht pagat vijnë në një masë goxha mirë të rregulluar në sektorin publik. Kaq është. 129.

Kryetari, Valon Ramadani: Atëherë, kush është për propozimin e Besnik Tahirit për amendamentin?

Ok, a ka mendim Qeveria për këtë amendament?

Meliza Qorraj: Sigurisht. Ky 129 i mungon një vlerësim financiar për të cilin ne nuk mund ta dimë a i tejkalon kufizimet buxhetore prej 745 milionë të cilat janë të planifikuara në ligjin tashmë të miratuar për buxhetin. E para. E dyta, për ta ruajtur, për të pasur një siguri të financave publike që mos të vihet te një situatë ku do të ketë më shumë të planifikuara në Ligj të pagave sesa janë të planifikuara në Ligj për buxhetin, është tejet e rëndësishme që koeficienti të vendoset prej Ligjit për buxhetin, sepse vetëm në këtë formë ruhet siguria financiare dhe stabiliteti financiar i shtetit.

Zëvendësministri, Bardhyl Dobra: Vlera totale në buxhet është 745 milionë, ndërsa vlera e koeficientit caktohet me Ligjin për buxhetin. Ligji për buxhet është miratuar, por pasi të kalojë, veç pak, pasi të kalojë ky ligj, ai mund të amendamentohet. S'është problem. E sjell atë pikë.

Kryetari, Valon Ramadani: Besnik pse 129? Pse jo 139 qysh e ke pasur herën e kaluar?

Besnik Tahiri: 129, qe po të tregoj shkurt.

Kryetari, Valon Ramadani: Besniku e ka fjalën për arsyetim edhe një herë atë që e tha, edhe vazhdojmë në votim.

Besnik Tahiri: 129 në krejt kalkulimin që unë e kam bërë, pagat në sektorin publik realisht, kryesisht secila pagë ka rritje, me 129 po se po, po edhe me 120 pak a shumë që po flitet.

Tash, me 129 te sektori i sundimit të ligjit ku unë frikësohem që aty do të kontestohet ky ligj dhe te disa agjenci të pavarura, agjenci ekzekutive ku prapë ka rënie të pagës, 129 e përfron edhe parashikueshmëria me një rritje ... periodike vit për vit e bie te paga që duhet. Ky është argumentimi im.

Ndërsa, kalkulimi, ju e keni 746 më duket, ky është 810.

Kryetari, Valon Ramadani: Atëherë propozoj që të shkoj në votim ky amendament i Besnik Tahirit.

Kush është për amendamentin e deputetit Besnik Tahiri?

Kush është kundër?

Abstenim s'ka.

Konstatohet që 3 për, 6 kundër. Ky amendament nuk kalon.

Kthehem te amendamentet e propozuara nga deputeti Isak Shabani. Amendamenti nr. 2 i deputetit Isak Shabani.

Isak Shabani: Sa i përket amendamentit, unë e kam për këtë çështje të cilën e ngriti edhe kolegu Besnik. Unë kam propozuar që vlera monetare e koeficientit bazë të jetë 130 euro. Rritja vjetore e koeficientit të përcaktohet për çdo vit me Ligjin për ndarje buxhetore dhe vazhdon renditja e paragrafëve të tjerë ashtu siç janë në projektligj.

Përcaktimi i vlerës monetare të koeficientit bazë është e domosdoshme që të jetë pjesë e Ligjit për paga për sektorin publik. Projektligji rregullon pagat, mënyrën e llogaritjes së pagave, ndarjen e koeficientëve dhe klasave, shtesat e tjera dhe po mungon vetëm vlera e koeficientit.

Unë po e jap edhe mendimin e ligjit të Sigmës, e cila ka dërguar edhe ajo neve si komision. Te mungesa e vlerës monetare të koeficientit në ligj ka ngritur shqetësimin e sigurisë juridike edhe Gjykata Kushtetuese e Kosovës të ligji i kontestuar.

Edhe ligji aktual nuk vendos mbi vlerën e koeficientit, megjithatë vlera do të përcaktohet me ligjin për buxhet vjetor, neni 9 dhe nëse miratohet para ose paralelisht me Ligjin për pagat, siguria juridike mund të mos kundërshtohet më. Por, projektligji u miratua, unë e kisha lutur ministrin, zv.ministrin e Punëve të Brendshme, aty e përmendi pak pa mikrofon si planifikon që koeficienti të paraqitet pas miratimit të këtij ligji, si do të shkojë procedura për ta ditur ne si qytetarë jemi të interesuar, sidomos nëpunësit dhe zyrtarët publikë ta vërejnë a ta dinë sa është koeficienti.

Kryetari, Valon Ramadani: Atëherë, fjalën e ka Qeveria për këtë amendament. Pas kësaj është mirë të shkohet në votim, se veç numri po dallon 129, 130, ai debat është ezauruar.

Zëvendësministri, Bardhyl Dobra: Siç parashihet në Ligjin për pagat në sektorin publik, vlera e koeficientit caktohet me Ligjin për buxhetin të cilin e bën Kuvendi i Kosovës. Qartë.

Isak Shabani: A po flitet vitin e ardhshëm. Projektbuxheti është miratuar. A pritet vitin e ardhshëm a çka është në pyetje. Qysh realizohet kjo?

Zëvendësministri, Bardhyl Dobra: Unë ju ftoj që sa më shpejt ta miratojmë në mënyrë që të hyjë në fuqi brenda muajit.

Kryetari, Valon Ramadani: A ta sqaroj vetëm pak këtë, nëse është e njëjta mirë, nëse jo, na e thuaj Hykmete.

Ne duhet ta kryejmë këtë ligj para Vitit të Ri që të shkojë të hyjë në fuqi ky pas një muaji. Jo ky hyn. Hyn se nuk përcaktohet me këtë. në këtë ligj. Tash nëse shkon në Kushtetuese, ajo është tjetër temë. Edhe të caktohet koeficienti, nëse shkon në Kushtetuese, ky nuk mund të hyjë në zbatim.

Shumë qartë, tash s'po më kujtohet cili nen është këtu, thotë që koeficienti, neni 9: koeficienti caktohet me Ligjin për buxhet. Ligji është votuar, po ai mund të vijë në rishikim, një amendamentim, një nen. Një nen ku rregullohet edhe vazhdon tutje.

Hykmete a ke diçka shkurt.

Hykmete Bajrami: D.t.th. në këtë kontekst që Ligji për buxhetin ka ndryshuar. Aty thuhet që caktohet me Ligjin vjetor të buxhetit, vetëm në rast se sillet në amendamentim. Unë jam shumë e sigurt që në qoftë se ju flisni me Ministrinë e Financave, ata do të parapëlqenin që ju të caktoni vlerën e koeficientit se sa të sillet komplet ligjin në amendamentim, se është punë shtesë për Ministrinë e Financave. Sa ka hyrë ligji në fuqi, të sillet amendament. D.m.th. koordinohuni me ta, sepse sigurisht kur është draftuar ligji, është menduar që buxheti do të kalojë më vonë, se buxheti zakonisht bëhet në fund të vitit, është menduar ashtu.

Tjetra, është ajo që më herët u potencua nga zv.ministri që tha 745 milionë është buxheti për pagat dhe ky është kostimi i ligjit. Po i bie që Qeveria e ka një koeficient. Përndryshe s'do të mund ta caktonte atë. Ndërkohë që ministri i Financave ka thënë në seancë që janë edhe mjetet e kontigjencave të cilat mund të përdoren për zbatimin e ligjeve të cilat do të hyjnë në fuqi gjatë v. 2023.

Atë që e ceku deputeti që tha koeficient bazë, unë mendoj që është jashtëzakonisht e rëndësishme që komisioni funksional ta përcaktojë një koeficient bazë, i cili do të variojë vit pas viti me Ligjin e buxhetit sipas rritjes ekonomike ose eventualisht sipas normës së inflacionit, do të reflektojë dhe do të ruajë fuqinë blerëse. D.m.th. do të ishte mirë që të ketë koeficient bazë, po mandej për lëvizjen e këtij koeficienti të vendosë Qeveria me Ligj periodik të buxhetit varësisht sipas rritjes ekonomike duke e reflektuar edhe normën e inflacionit. Kjo do të ishte më e mira besoj edhe për Qeverinë, po edhe për të gjithë.

Kryetari, Valon Ramadani: Faleminderit deputete!

Fjalën e ka kërkuar edhe deputetja Arbëreshë Kryeziu, pastaj Agim Veliu.

Ok. Atëherë nëse e ka kërkuar përpara. Vazhdo deputet Veliu, se unë nuk e kam kapur momentin cili ka qenë përpara, po vazhdo deputet Veliu.

Agim Veliu: Jo, unë meqë ishte fjala për këtë amendament, në mbështetje të kolegëve të mi, edhe unë e kam përgatitur po të njëjtin, çuditërisht me vlerën e njëjtë me kolegun që e kam afër, 130 euro. Po meqë ne të tre jemi llapjanë, Besniku 129.

Kryetari, Valon Ramadani: Faleminderit i nderuar deputet! Veç një minutë.

Vazhdon deputetja Arbëreshë Kryeziu, pastaj shohim a po shkojmë në votim apo vazhdojmë në debat. Po zonja deputete!

Arbëreshë Kryeziu-Hyseni: Tash te çështja e koeficientit, pikërisht për faktin se koeficienti nuk është fiks, sepse ndryshon varësisht prej rritjes ekonomike prej viti në vit, nuk mund të jetë koeficienti sot të caktohet prej neve si deputetë, edhe as në anën tjetër nuk mund ne të flasim në emër të Ministrisë së Financave sot këtu. Ne jemi duke thënë që Ministria e Financave do të duhej të vendoste koeficientin. Ne e kemi vlerën totale në buxhet që shkon për Ligjin për pagat që i dedikohet këtij ligji dhe në bazë të asaj vlere totale, bëhet shpërndarja e mjeteve që e nxjerr atë koeficientin që ne po e kërkojmë. Ne jemi duke debatuar për një diçka që e dimë që e s'do të mund ta nxjerrim sot këtu. Nuk mund ta përcaktojmë deputeti në këtë mënyrë që ti 129, ti 130, zgjate dorën për 129.5. koeficientin do ta përcaktojë Ministria e Financave, pasi që ne ta kalojmë projektligjin të enjten në seancë. Nuk di pse po humbim kohë të debatojmë më shumë për këtë çështje, kur e dimë që e ka thënë edhe vetë ministri në seancë që koeficientin e përcakton Ministria e Financave. Ne nuk e dimë cili është koeficienti. Kemi miratuar buxhetin, e kemi hapur rrugën për të përcaktuar koeficientin, le të caktohet pas të enjtes.

Kryetari, Valon Ramadani: Po veç shkurt, Hykmete dhe Bekimi.

Hykmete Bajrami: Kështu, deputetët, po mendoj zyrtarët publikë e kanë një pagë, ata e kanë një pagë sot të cilën e dinë prej kur i kanë nënshkruar kontratat e tyre, ose prej avancimit të fundit. Nuk është kjo. unë mendoj që mosçaktimi i një koeficienti bazë i mban peng, është pasiguri për zyrtarët publikë që çdo vit atyre t'u caktohet paga. Duhet pasur koeficient bazë, edhe mandej duhet pasur një përqindje të caktuar, të cilën Qeveria e cakton me ligj të buxhetit. Në anën tjetër, në qoftë se Qeveria e ka vendosur koston e komplet pagave në sektorin publik 745 milionë sa është ajo, është vetëm 75 milionë më e lartë se këtë vit që jemi, d.m.th. në vitin 2022.

Atëherë i bie që Qeveria e ka koeficientin. Atë që po e themi, Qeveria në ligjin amë për nenin 9 të Ligjit për paga ka thënë e cakton me Ligj të buxhetit. Ligji i buxhetit ka kaluar. Absolutisht mua po më duket procedurë e panevojshme. Ne jemi plus në sesion dimëror. Kthehemi diku në javën e tretë si Kuvend prej pushimit, ju po prisni që të amendamentohet Ligji i buxhetit në mënyrë që më 1 shkurt të hyjë Ligji i pagave në fuqi, sepse neni i fundit i Ligjit të pagave thotë që ky hyn në fuqi një muaj pas publikimit në Gazetën Zyrtare, dhe i bie që brenda këtij viti do të publikohet në Gazetën Zyrtare.

I bie që më 1 shkurt Ligji duhet të jetë në fuqi. Jo more nuk është. Ok. Ju bëjeni si të doni, po këto janë procedura komplet të panevojshme, ndërkohë që ka nevojë për stabilitet. Ka nevojë për një koeficient bazë. Secili zyrtar ka nevojë ta dijë cila është paga e tij e cila nuk lëviz pavarësisht gjërave. Në qoftë se kemi situata të jashtëzakonshme, atëherë Qeveria ka të drejtë edhe të mos japë paga fare.

Kryetari, Valon Ramadani: Faleminderit! deputeti Haxhiu e ka fjalën, edhe shkojmë në votim.

Bekim Haxhiu: Kjo është mirë që të jetë veç për procesverbal, për shkak që nëse më vonë e sheh të rrugës i nderuar kryetar, që amendamenti për të njëjtën çështje kam amendament për nenin 9. Mund edhe ta lexoj amendamentin. Si ta vlerësoni ju kryetar, unë për këtë punë kam ardhur prej orës 9 për amendamentet të cilat i kam propozuar. Mirëpo ky projektligj e ka një opinion për vlerësimin e ndikimit buxhetor nga organi propozues. Këtu thotë që organi që e ka propozuar për këtë projektligj pra nuk do të krijojë kosto shtesë buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës krahasuar me projeksionet buxhetore dhe kategorimin e shpenzimeve paga dhe shtesa të parapara mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023.

Ky është një prej projektligjeve shumë substanciale, e cila vjen pa një analizë të mirëfilltë dhe pa deklaratë financiare. Kjo le të mbetet e evidentuar këtu, sepse ky projektligj kalon pa deklaratë financiare të analizuar dhe të prezantuar para deputetëve që do të duhej ta kishin deputetët. Një gjë të tillë. E kanë faqen pasuese komplet shumën sa është e ndarë e planifikuar me buxhet për paga, numrin e të punësuarve, po nuk ka koeficient.

I nderuar kryetar, unë po e lexoj amendamentin tim që të mos kthehem pastaj.

Kryetari, Valon Ramadani: Kryeje, pastaj shkojmë vetëm në votim te amendamenti.

Bekim Haxhiu: Propozimi im është ky: Bazuar në propozimin të paktën që realisht të mos të krijojmë konfuzione, ndoshta për shkak të llogarive që i ka bërë edhe Qeveria rreth pagës minimale, e cila është propozuar 264 euro, ndërsa sipas vlerësimit që i kam bërë, pra kam propozuar që vlera monetare e koeficientit të jetë 132 euro.

Pika 2: pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, vlera e koeficientit nga paragrafi 1 në vitet në vijim përcaktohet me vendim të Qeverisë, bazuar në rritjen ekonomike vjetore dhe Ligjin vjetor të buxhetit të Republikës së Kosovës. përcaktimi i vlerës së koeficientit bëhet në pajtim me legjislacionin për menaxhimin e financave publike.

E rëndësishme është që ky ligj të ketë koston financiare prej fillimit të miratimit të tij. Duhet të dihet saktë për shkak se Ligji i buxhetit është votuar. Nuk është përcaktuar ajo. Kjo çështje mund të rregullohet dhe e ka obligim ky komision ta përcaktojë. Do të jeni temë e debatit në Kuvend dhe jashtë tij nëse komisioni kalon ligj pa vlerë të koeficientit. Atëherë ndërrojeni, bëjeni ligjin jo për pagat, por ligjin për koeficientët e pagave, sepse vlerë s'ka.

Kryetari, Valon Ramadani: Vazhdojmë me votimin e amendamentit 2 të deputetit Isak Shabani, pastaj të deputetit Bekim Haxhiu për të njëjtën çështje.

Amendamenti 1 i Isak Shabanit.

Kush është për?

A ka kundër?

Atëherë 3 vota për, 6 kundër. Amendamenti i parë i Isak Shabanit nuk kalon.

E qesim në votim amendamentin e Bekim Haxhiut.

Kush është për amendamentin nr. 1 të Bekim Haxhiut?

A ka kundër?

Atëherë 3 vota për, 6 kundër. Edhe ky amendament nuk kalon.

Kalojmë te amendamenti 2 i deputetit Isak Shabani.

Isak Shabani: Amendamenti 2, në shtojcën nr. 1.2 niveli lokal – të ndryshohet dhe kategorizimi të bëhet si në vijim: kryetari i kryeqytetit të ketë koeficientin 15. Kryetari i qytetit historik Prizrenit të ketë koeficientin 14. Kryetarët e komunave regjionale të kenë koeficientin të 13 dhe kryetarët e të gjitha komunave të tjera, klasa 4 koeficienti të jetë 12.

Arsyetimi: ndarja apo kategorizimi i kryetarëve të komunave në tetë kategori është e tepërt. Kryetarët e komunave kanë punë me përgjegjësi dhe zgjidhen drejtpërdrejt nga qytetarët.

Kategorizimi si është paraparë do të ndikojë në uljen e nivelit të përgjegjësisë si dhe do të zbehë nivelin e kandidaturave për zgjedhje. Prandaj, propozoj të përkrahet ky amendament.

Kryetari, Valon Ramadani: Faleminderit, i nderuar deputet!
Kush është për amendamentin nr. 2 të Isak Shabanit?

A ka kundër?

Konstatoj se me 3 vota për, 6 kundër, ky amendament nuk kalon.

Vazhdojmë te amendamenti nr. 3 i deputetit Isak Shabani.

Isak Shabani: Te shtojca 2.2 – administrata e gjyqësorit. Pozita profesionale të jenë të një klase dhe me koeficientë të njëjtë.

Arsyetimi: trajtimi dinjitoz i stafit profesional do të ndikojë në rritjen e nivelit të përgjegjësisë.

Kryetari, Valon Ramadani: Faleminderit i nderuar deputet!

Kush është për amendamentin nr. 3 të deputetit Isak Shabani?

Kush është kundër?

Atëherë, 3 vota për, 6 kundër. Ky amendament nuk kalon.

Vazhdojmë me amendamentin 4 të deputetit Isak Shabani.

Isak Shabani: Te shtojca nr. 3 – sistemi prokurorial. Pozitat profesionale 1,2,3 të jenë të gjitha në një klasë dhe koeficientë të njëjtë.

Kryetari, Valon Ramadani: Faleminderit i nderuar deputet!

Kush është për këtë amendament të deputetit Isak Shabani? Amendamenti nr. 4.

Kush është kundër?

Me 3 vota për, 6 kundër, ky amendament nuk kalon.

Vazhdojmë me amendamentin nr. 5 të deputetit Isak Shabani.

Isak Shabani: Të nderuar kolegë,

Te shtojca nr. 4 – Forca e Sigurisë së Kosovës. Pozita kadet të ketë koeficientin 3. Koeficienti 2 është tejet jovlerësues dhe jomotivues për të rinjtë që t'i bashkohen kësaj force. Andaj propozoj që të ngritet koeficienti nga 2 në 3 për këtë kategori.

Kryetari, Valon Ramadani: Faleminderit i nderuar deputet!

Kush është për këtë amendament të propozuar nga Isak Shabani?

Kush është kundër?

Konstatohet se me 3 vota për, 6 kundër, ky amendament nuk kalon.

Amendamenti 6 me radhë i propozuar nga deputeti Isak Shabani.

Isak Shabani: Amendamenti tjetër. te shtojca nr. 5.1 – Policia e Kosovës. Pozita kadet të ketë koeficientin 3. Koeficienti 2 është tejet jovlerësues dhe demotivues për të rinjtë që të jenë pjesë e kësaj force. Prandaj, propozoj që të ngrihet koeficienti nga 2 në 3 për këtë kategori. Besoj që po na bëjnë krenarë sot policët e Kosovës ku gjenden.

Kryetari, Valon Ramadani: Faleminderit i nderuar deputet!

Kush është për këtë amendamentin nr. 6 të Isak Shabani?

Kush është kundër?

Konstatohet se me 3 vota për, 6 kundër, ky amendament nuk kalon.

Vazhdojmë me deputetin Bekim Haxhiu, amendamenti nr. 2.

Urdhëro edhe njëherë, më fal!

Bekim Haxhiu: Po më duket Hykmetja i paska dy propozime.

Kryetari, Valon Ramadani: Atëherë me mirëkuptimin e deputetëve funksionalë vazhdojmë me deputeten Hykmete Bajrami. Po, Besnik është paraqitur.

Atëherë, tani është radha e deputetes Hykmete Bajrami, kryetare e Komisionit për Mbikqyrje të Financave Publike. Ka propozuar dy amendamente dhe është radha e arsytimit të amendamentit të parë. Fjala është për ju deputete!

Hykmete Bajrami: Faleminderit, kryetar!

Nuk e di cili amendament është i pari atje, po i kam në cilësi të kryetares së Komisionit, po ju tregoj që më janë drejtuar dy amendamente prej dy institucioneve të cilat kanë të bëjnë me fushëveprimtarinë e komisionit tonë, po amendamentet nuk i kam sjellë në cilësi të kryetares së Komisionit, për shkak se nuk kam arritur ta mbledhë komisionin për shkak të afateve. I kam sjellë në cilësi të deputetes. Njërën prej këtyre kërkesave e keni pasur edhe vetë, është prej Sindikatës së punëtorëve të Zyrës Kombëtare të Auditimit.

Kryetari, Valon Ramadani: Po amendamenti i parë është që koeficientët për stafin e njësisë qendrore harmonizuese të auditorëve.

Hykmete Bajrami: Atëherë po e lexoj këtë.

D.m.th. ju e pakëshit të parën, se unë fillova me të dytën. Kjo kërkesë ka shkuar fillimisht te Komisioni për Buxhet, Financa dhe Transfere dhe mandej ata e kanë parë që komisioni nuk e ka përcjellë te ju dhe e kanë sjellë te unë.

Flitet për rregullimin e koeficientëve sipas Ligjit të pagave dhe koeficientëve të propozuar në këtë ligj, Njësia qendrore harmonizuese e cila në njëfarë mënyre është institucioni ombrellë i auditorëve të brendshëm për krejt nivelin edhe qendror, edhe lokal. Thonë që sipas koeficientëve të propozuar, atyre u zbritet paga diku me 45 për qind. Edhe e kanë propozuar një listë të koeficientëve, në mënyrë që t'i ruajnë pagat aktuale. Sipas tyre, kjo listë e koeficientëve, vetëm do t'i ruante pagat aktuale.

Unë në amendament kam vendosur tabelën, ndërsa si arsyetim kam sjellë shkresën e tyre dhe thuhet kështu: drejtori i Njesisë qendrore harmonizuese – koeficienti 13, udhëheqësi i divizionit – koeficienti 12, ekspertët – koeficienti 11, drejtori i njesisë së auditimit të brendshëm variojnë koeficientët prej 10.9 deri 10.3, auditori i brendshëm mandej varësisht prej institucioneve varion koeficienti prej 9.9 deri 9.3 dhe auditori i brendshëm i ri janë koeficientët prej 7.9 që është në Presidencë deri 7.3 që është në njësi ekzekutive komuna-administratë e shërbimit publik. Sipas koeficientëve të propozuar në pagë, d.m.th. këtyre u ulët paga aktuale të cilën e kanë dhe unë ju inkurajoj që ju t'i mbështetni propozimet e tyre, ose nëse keni ndonjë propozim tjetër, por me koeficientë sipas Ligjit të pagave ka mundësi që komplet auditorët të largohen prej institucioneve.

Funksioni i auditorit të brendshëm, ju e dini të gjithë që është funksion jashtëzakonisht i rëndësishëm. Ata nuk duhet të dinë vetëm anën financiare, duhet të dinë faktikisht për punën në secilin departament në kuadër të organizatës buxhetore në të cilën punojmë. Atyre u nevojiten përpos diplomave universitare, edhe certifikime shtesë që janë jashtëzakonisht të vështira të

merren. Gjithashtu, sipas ligjit në fuqi të Zyrës Kombëtare të Auditimit u duhen trajnime. E kanë me kusht që të kenë trajnime deri në gjashtëdhjetë orë në vit.

Konsideroj që nëse jo si propozim i imi, ishte dashur që komisioni funksional ta rregullojë këtë fushë, në mënyrën çfarëdo që e mendoni, po për besë të ulen pagat e auditorëve të brendshëm për 300-400 euro është problem që mandej do të mund t'i mbajmë këta profesionistë nëpër institucione dhe të gjithë ata që kanë pasur ndonjëherë funksione ekzekutive e dinë sa të rëndësishëm janë këta njerëz brenda, se nuk të lënë të gabosh. Faleminderit!

Kryetari, Valon Ramadani: Faleminderit, e nderuar deputete!

Atëherë po shkojmë në votim.

Kush është për amendamentin e parë të deputetes Hykmete Bajrami?

Kush është kundër?

Konstatoj se me 3 vota për, 6 kundër, ky amendament nuk kalon.

Vazhdojmë me amendamentin nr. 2 të propozuar nga deputetja Hykmete Bajrami.

Hykmete Bajrami: Faleminderit, kryetar!

Atëherë këtu prapë është një kërkesë e cila ka ardhur te komisioni ynë në emër të Sindikatës së punëtorëve të Zyrës Kombëtare të Auditimit. Sipas tyre, këtu mungojnë komplet dy pozita, që është pozita e udhëheqësit të ekipit të auditimit si dhe drejtorit të Departamentit të auditimit. Ata gjithashtu kanë dorëzuar një tabelë me koeficientë, të cilën unë e kam vendosur në amendament dhe koeficientët janë kështu: auditori i përgjithshëm – 17, zëvendësauditori – 15.5, ndihmës auditori – 14, drejtori i departamentit të auditimit – 12, udhëheqës auditimi – 11, auditor specialist – 10.5, auditor senior – 10, auditor – 9 dhe auditor junior – 7. D.m.th. këto janë koeficientët e propozuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit. Edhe këta e kanë pak a shumë për t'i ruajtur pagat aktuale. Nuk flitet për ngritje të pagave të cilën po e kërkojmë. Faleminderit!

Kryetari, Valon Ramadani: Faleminderit e nderuar deputete për arsyetimin e amendamentit!

Kush është për amendamentin e dytë të deputetes Hykmete Bajrami?

Kush është kundër?

Konstatoj se me 3 vota për, 6 kundër, ky amendament nuk kalon.

Vazhdojmë me amendamentin nr. 2 të deputetit Bekim Haxhiu.

Bekim Haxhiu: Faleminderit, kryetar!

Amendamentet e mia lidhen dhe e kanë bazën te ky propozim tani. Është shumë e rëndësishme për sistemin shëndetësor dhe sistemin arsimor në kuadër të Fakultetit të Mjekësisë dhe Qendrës Klinike Universitare. E para, të njihet puna e integrua. Dikush bën pyetje pse objekti i Fakultetit të Mjekësisë sot ekziston në oborrin e QKUK-së. Pse s'është në kuadër të kampusit universitar? Sepse, nëse e keni ndonjë fotografi në të kaluarën të Qendrës Klinike Universitare, e keni parë që në hyrje ka shkruar Fakulteti i Mjekësisë-Qendra Klinike Universitare. Nuk mendohet që këto dy institucione të veprojnë të ndara.

Aktualisht sot, një mësimdhënës i Fakultetit të Mjekësisë që është specialist shkon në punë në ora shtatë në klinikë, mban ligjëratat ose ushtrimet me studentë dhe duke ofruar shërbimin shëndetësor, bën edhe punën praktike për studentë, ua demonstroi atë dhe në ora tre, respektivisht në ora katër, e përfundon orarin e punës. Ligji i punës thotë që një i punësuar mund të punojë një punë bazë tetë orë, edhe punë shtesë katër. Aktualisht ky personel e bën punën e integruar, por që s'i njihet me ligj. Prandaj, të gjitha paragrafët që janë propozuar në nenin 30 e kam riformuluar në tërësi që të rregullohet kjo çështje një herë e mirë. përndryshe, nuk ka logjikë më që të quhet Qendër Klinike Universitare nëse s'ka punë të integruar të mësimdhënies dhe të ofrimit të shërbimit shëndetësor dhe të punës praktike.

Kryetar, këtu i kam marrë me vete amendamentet edhe që i kam dorëzuar kur ka qenë ky projektligj në mandatin e kaluar në vitin 2018, në shtatëmbëdhjetë faqe dhe vlerësimi i shkollimit ia kam dorëzuar të nënvizuar listën e programeve të akreditimit nga Agjencioni i Kosovës për Akreditim, njohjen e profesioneve të cilat janë dhe shkollimin e tyre. Nuk mund të ketë, dhe lexojeni vendimin e Gjykatës Kushtetuese për ligjin e shfuqizuar për shkak të mosnjohjes së shkollimit. Po e marr shembull infermierët me shkollë të mesme në ligjin e kaluar me ata me fakultet e kanë pasur dallimin në koeficient 0,25, tash e kanë 0,30.

A mendoni që ky 0,05 për qind s'do ta shfuqizojë këtë ligj prapë? Është një vendim i Gjykatës Kushtetuese për këtë çështje. Për shkak se nuk është vlerësuar parimi: puna e njëjtë, paga e njëjtë. Po propozoj e para që në këtë ligj të njihet puna e integruar të ofrimit të shërbimit shëndetësor dhe do të doja vërtet edhe një mendim të zv.ministrit, z. Dobra, për shkak se ky mesa kam parë në CV-në e tij, ky i kam kryer studimet në Gent. Të na tregojë përvojën e Gentit. Qysh është i organizuar spitali universitar në Gent? Ndoshta e di, besoj. Nëse jo. Atëherë po të tregoj. I nderuar zv.ministër, rektori i Universitetit të Mjekësisë është edhe drejtor i spitalit të Gentit.

Njëkohësisht pra është edhe rektor, është edhe drejtor i spitalit. Veprojnë si dy institucione autonome, por ai e menaxhon. Kështu ka qenë për fat të keq kryetar, kështu ka qenë edhe para dyzet vitesh. Dikush ka pasur prindërit tanë më shumë vizion se ne, kur e kanë bërë një gjë të

tillë në kuadër të Fakultetit të Mjekësisë dhe Qendrës Klinike Universitare. Vetëm këtë po e kërkoj, e pastaj të tjerat vijnë e rregullohen. Nëse dëshironi asistentë shëndetësorë të këtë.

Kryetari, Valon Ramadani: Faleminderit i nderuar deputet!

Nuk di a pati ndonjë çështje të komentojë apo të thotë ministri ose të përgjigjet zv.ministri.

A vazhdojmë?

Isak Shabani: Në lidhje me këtë amendament.

Kryetar, edhe unë besoj që kush do ta vlerësojë drejt, nëse s'miratohet ky amendament do të kemi pasoja në të ardhmen që besoj që një kuadër i lartë që ligjëron në Fakultet të Mjekësisë nëse kjo nuk i mundësohet, do të këtë telashe dhe mos u befasoni kur nesër të kemi ndonjëfarë kolapsi edhe në Fakultet të Mjekësisë. Faleminderit!

Kryetari, Valon Ramadani: Faleminderit i nderuar deputet!

Edhe një herë më fal, zoti deputet!

Besnik Tahiri: E mbështes fuqishëm propozimin e prof. Dr. Bekim Haxhiut. Mendoj që duhet ta votoni këtë.

Kryetari, Valon Ramadani: OK. Faleminderit!

Po vetëm nëse mundesh shpejt. Pasi e ke kryer arsyetimin.

Bekim Haxhiu: Përtej dallimeve politike, të njëjtën çështje jua kam thënë kolegëve të mi kur kam qenë pjesë e mazhorancës. Mendojeni për fëmijët tanë pacientë, për ata që do të marrin shërbim shëndetësor.

Kryetari, Valon Ramadani: E mbaj në mend në Ligjin për pagat kur ka qenë.

Bekim Haxhiu: Besoj që e di kundërshtimin që e kam pasur që të mos kalohet në atë formë. Realisht kam arritur t'i sigurojë një pjesë të votave në seancë prej deputetëve, po jo të mjaftueshme të kalojë ky propozim që atëherë ka qenë shtatëmbëdhjetë faqe dhe ka qenë i kategorizuar.

Kryetari, Valon Ramadani: Tash është më i mirë.

Bekim Haxhiu: I kategorizuar ka qenë. Unë mendoj që ai është më i mirë. Pse kryetar mendoj? Edhe tani mendoj që ishte dashur nëse mendojmë sistemin shëndetësor si tërësi, duke qenë se jam njohës i fushës dhe që dymbëdhjetë vjet veç me sistemin shëndetësor merrem.

Çështja është kështu, nëse implementohet nesër Ligji i sigurimeve shëndetësore, çmimorja e shërbimit shëndetësor në nivelin primar, në nivelin sekondar, në nivelin terciar, përgatitja, te kush do ta marrësh shërbimin shëndetësor, do ta marrësh te një mjek i përgjithshëm, do ta marrësh te një doktor shkence, do ta marrësh te një profesor. Kjo i kalkulohet pacientit në faturë. Por ti, të njëjtën gjë nuk ia kalkulon mjekut në pagë. Nuk e vlerëson. Kushdo prapë nesër në cilëndo padi mund ta fitojë nëse nuk bëhet puna e integruar. Për të pasur një sistem, unë mendoj që puna e integruar, sepse ajo ndodh. Nëse dini, gjejini ju një mjek që punon në ora shtatë në mbrëmje në QKUK, ose në fakultet nëse e gjeni duke dhënë mësim, atëherë unë po tërhiqem prej amendamentit. Se ata veç e bëjnë punën e integruar dhe duhet t'u mundësohet me ligj.

Kryetari, Valon Ramadani: Mirë, faleminderit i nderuar për sqarimin shtesë.

Kush është për amendamentin nr. 2 të deputetit Bekim Haxhiu?

Kush është kundër?

Konstatoj që amendamenti nr. 2 i deputeti Bekim Haxhiu, me 2 vota për, 6 kundër.

Vazhdojmë me amendamentin nr. 3 të deputetit Bekim Haxhiu.

Bekim Haxhiu: Po, faleminderit!

Lidhet me atë të kaluarin, mirëpo ky është një ndryshim Qeveria ka paraparë 30 për qind të pagës shtesë për personelin akademik në arsimin universitar, përfiton edhe një 30 për qind të pagës shtesë. Unë mendoj që kjo duhet të jetë së paku dyzet për qind. Nëse kështu e kaloni, po ju paralajmëroj, ju sistemin shëndetësor dhe arsimor në mjekësi do ta shkatërroni. Kam propozuar që të jetë dyzet për qind. Po jua jap një shembull dhe ju më tregoni pastaj kështu, një asistent i Fakultetit të Mjekësisë në propozimin e juaj i bie t'i marrë edhe 260 euro shtesë që asistent duhet të jesh doktor shkence dhe të kesh publikime shkencore, së paku një të publikuar në skopus.

Unë po besoj ndoshta për shkak që s'e njihini sektorin, edhe nuk i dini problematikat. Asistent të bëhesh duhet të jesh doktor shkence dhe të kesh një publikim. Nëse për 260 euro, cilido kolegji ta merr këtë dhe ia jep titullin profesor asistent, ia jep pagën 1400 euro, qoftë Heimerer, ose Rezonanca, a AAB-ja, a Universumi, ta merr me 1400 euro. Mendoni ju që ai do të arrijë ky për 260 euro në Fakultet të Mjekësisë?

Mendoni ju që një profesor asistent që ka publikuar monografi, që ka bërë dy publikime shkencore të indeksuara në revista ndërkombëtare do t'ju rrijë juve për 375 euro shtesë? Kështu mendoni? Mendoni që një profesor i rregullt që ka botuar libra, do të rrijë për 446 euro? Po 1800 euro deri 2200 euro ia paguan sektori privat. Ai rri në punë të rregullt në QKUK me koeficientin 12 si specialist dhe shkon një punë tjetër në universitetet apo kolegjet private, i akreditojnë

programet atje. Çka kemi bërë? Vitet e ardhshme do të mbyllim Fakultetin e Mjekësisë. Programin e parë që do të rrezikoni sivjet në Fakultetin e Mjekësisë në 2023. Nëse nuk ju del kështu, do të flasim prapë. Ama gabim e keni nëse e mendoni këtë çështje veç në aspektin politik. Edhe kush ka punuar në këtë ligj, ai nuk ia ka dashur të mirën sektorit të shëndetësisë as arsimit në Fakultetin e Mjekësisë.

Kryetari, Valon Ramadani: Faleminderit i nderuar deputet Haxhiu!
Atëherë vazhdojmë me votim të amendamentit 4.

Kush është për amendamentin 4 të propozuar nga deputeti Haxhiu?

Kush është kundër?

Konstatoj që ky amendament nuk kalon. Ose 3 vota i ka për, 6 kundër. Ky ishte amendamenti 3.

Vazhdojmë me amendamentin nr. 4. Pesë i ke komplet. Tash është radha te amendamenti nr. 4.

Bekim Haxhiu: *(Nuk dëgjohet, ndërprerje incizimi)*

Isak Shabani: Edhe një shtesë të vogël. A bën?

Kryetari, Valon Ramadani: Vazhdo! Po i bie shumë shkurt, pasi që mendoj mjaft e ka argumentuar kolegu. Do të ishte mirë p.sh. dy- tri çështje që i përmendi kolegu nga Ministria këtë të deklarohet, pse nuk janë përfshirë këto kategori: subspecialisti dhe kryefizioterapeuti. D.m.th. janë pozita, janë vlerësime, janë shkollime, pse nuk janë përfshirë këto. Këto duhet të futen këto në sitem. Mendoj që ka logjikë.

Bekim Haxhiu: Mos u hakmerrni atje për shkak timin se unë nuk e kam në plan të kthehem në klinikë të bëhem diçka. Nuk e kam ndërmend, mos u bëni merak për atë punë.

Kryetari, Valon Ramadani: Faleminderit, i nderuar deputet Shabani! Tash e ka kërkuar fjalën edhe deputeti Muzaqi.

Besim Muzaqi: Veç desha të saktësoj disa pasaktësi që kanë mundur t'i rrëshqasin ndoshta deputetit Haxhiu. Së pari, u përmendën farmacistët me aludimin se paskam ndikuar. Unë them të drejtën s'jam specialist i farmacisë. Nuk ka rëndësi kjo punë. kam master edhe në teknologji, po nuk e kam atë problem. Por farmacistët atje janë klasifikuar, magjistrat e farmacisë me koeficientin 7.4. Farmacisiti klinik i cili e ka kryer specializimin për farmaci klinike trevjeçar është në koeficientin 12, njëjtë sikurse edhe specialisti i farmacisë. Kështu që, te termi subspecializant ose ky term në krejt botën tanimë nuk përdoret, është obsolet, sepse specialist

mund të jeshë për një fushë më të gjerë ose më të ngushtë, edhe më të ngushtë, po prapë je specialist. Nuk ka subspecializim në nomenklaturën shëndetësore botërore.

Kryetari, Valon Ramadani: Këtë çështje mund ta diskutojmë tutje, po nuk mendoj që mund të na ndërrojë mendjen për votimin e këtij amendamenti. Unë pajtohem që duhet sqaruar këtë çështje, po ideja është që të ecim tutje se jemi në gjysmë të punës. I keni nga tridhjetë sekonda.

Bekim Haxhiu: Ministrin e Shëndetësisë e keni pasur këtu që ka dhënë dorëheqje, i cili i ka propozuar programet dhe specializimet, besoj tash në aspektin e kirurgjisë dhe të profesionalizimit nuk mund ta kontestojmë asnjëri, profesor Latifin. Mund të flasim tash për aspektin menaxherial të tij, ajo është diçka është tjetër. Por, në aspektin e njohurive të tij sa i përket kirurgjisë nuk mund të diskutojmë, të paktën ne.

Çka është e rëndësishme ta dimë, kryetar!

Kryetari, Valon Ramadani: Nëse mundesh shkurt, se e kaluam...

Bekim Haxhiu: Shtojcën e programeve të akreditimit të cilat janë publikuar në webfaqen e Agjencinë të Akreditimit. 360 kredi i kanë veç dy programe të studimeve themelore në Republikën e Kosovës, edhe në botë. Janë studimet në stomatologji dhe studimet në mjekësi të përgjithshme.

Programet e studimeve në farmaci janë me 300 kredi. Programet e studimeve në psikologji klinike që këtu i keni vlerësuar me koeficientin 7, i keni ndarë, është shkollim i njëjtë, me fizioterapi, me logopedi, me infermieri 180 kredi i kanë. Nëse e kryejnë edhe masterin i bën 300 kredi. Pra, fizioterapeuti master, farmacisti master, logopedi master, psikologu klinik master, i kanë 300 kredi. Shkollimin e njëjtë.

Nëse shkojnë në specializim, specializimet në këtë fushë janë 3-vjeçare, ndërsa në mjekësi të përgjithshme dhe stomatologji janë 5-vjeçare. Pra, një specialist i mjekësisë së përgjithshme i ka 3 vite shkollim më shumë sesa një farmacist specialist ose sesa një psikolog klinik specialist. Prandaj, edhe pagesa nuk duhet të jetë e njëjtë.

Kushdo që ua konteston këtë çështje, unë e di që do t'ua kontestojnë, e di saktë që do t'ua kontestojnë, por nuk mund t'i fshish prej sistemit të pagesave, koeficienteve 1 kategori të tërë të profesionistëve shëndetësore pse janë fizioterapeut pse më ka rastisur mua që të jem fizioterapeut. Është gabim kjo qasje.

Kryetari, Valon Ramadani: Faleminderit, i nderuar deputet!

Deputet Muzaqi propozoj që të vazhdojmë me votim.

Besim Muzaqi: Më fal! Veç desha të them te pozita kryefizioterapeut ose kryeinfermier është pozitë drejtuese, nuk është pozitë profesionale. Kryefizioterapeut bëhet dikush që zgjidhet prej kolegëve për t'i udhëhequr.

Kryetari, Valon Ramadani: Do të mblidhemi një ditë ekstra këtu dhe do ta shikojmë qysh janë, por sot po mendoj që është mirë të shikojmë në votim. Atëherë, kush është për amendamentin numër 4 të deputetit Haxhiu? Kush është kundër? Konstatoj që me 2 vota për, 6 kundër, ky amendament nuk kalon.

Vazhdojmë me amendamentin e fundit të propozuar nga deputeti Bekim Haxhiu, numër 5.

Bekim Haxhiu: Faleminderit, kryetar!

E imja si deputet është që t'i bëj propozimet për ta rregulluar sistemin edhe po më vjen mirë që edhe Qeveria nuk ka komente, por që qëndrimi politik e mbizotëron arsyen edhe pse çështjet janë të rëndësishme.

Lidhet ekskluzivisht me Fakultetin e Mjekësisë, mirëpo edhe me sistemin arsimor. Ju si komision i keni dy mundësi, e keni mundësi që t'i ngrini koeficientet në tërësi për të gjithë të punësuarit në sektorin publik në mësimdhënie që janë, ose mund t'i ndani të veçantë koeficientet për Fakultetin e Mjekësisë.

Pse, kryetar, duhet të jenë të veçantë? Më vonë mund ta arsyetojë këtë. Për t'u bërë profesor në Fakultet të Mjekësisë duhet ta kesh edhe shkollimin specialistik. Janë 5 vjet shkollim më shumë sesa një profesor në ekonomik ose juridik, edhe do duhej ta kenë koeficientin e parë, për shkak që puna e njëjtë, paga njëjtë, u jemi përmbajtur propozimeve që për krejt Universitetin e Prishtinës, të punësuarit në sektorin e mësimdhënies e kam bërë një renditje.

E thashë arsye se pse profesori asistent ta ketë koeficientin 12.5 në Fakultet të Mjekësisë, por edhe në universitet është për 0.5 më i lartë se koeficienti i mjekut specialist. Aktualisht, të gjithë specialistët që janë në marrëdhënie pune, që janë profesorë e marrin pagën primare në Fakultetin e Mjekësisë.

Agjencioni i Akreditimit për ta akredituar një program kërkon që pagën primare bazuar në deklarinimin e ATK-së ta ketë në fakultet. Me këtë propozimin tuaj, ku paga e një profesori asistent është koeficienti 10.4, të gjithë të punësuarit në mësimdhënie në Fakultet të Mjekësisë do të kalojnë në pagë primare në QKUK, edhe do ta humbasin marrëdhënien e rregullt të punës në universitet. Kjo do ta pamundësojë akreditimin e programeve në Fakultetin e Mjekësisë. Fakulteti i Mjekësisë është i vetmi institucion në Republikën e Kosovës që e ka të akredituar programin e studimeve në mjekësi të përgjithshme, dhe nëse këtë e rrezikoni, atëherë unë nuk e

di se cila është logjika që të kemi Ligj të pagave që e shkatërron sistemin arsimor dhe që e shkatërron sistemin shëndetësor.

Ndoshta ka ndonjë arsytim prej Qeverisë, bash kisha pasur dëshirë ta dëgjoj.

Kryetari, Valon Ramadani: A ka ndonjë koment? Jo. Propozoj që ky amendament të shkojë në votim. Amendamenti i 5-të i deputetit Bekim Haxhiu. Kush është për? Kush është kundër? Konstatoj se me 3 vota për, 6 kundër, ky amendament nuk kalon.

Tani jemi deputeti Rashit Qalaj. Deputeti Rashit Qalaj i ka propozuar 8 amendamente. Unë po i lexoj, e as shkojmë pas çdo amendamenti.

Deputeti Qalaj i ka propozuar 8 amendamente. Nuk ka ardhur sot që t'i mbrojmë. Unë po propozoj që 8 amendamentet të shkojnë në pako në votim.

E lexoj unë secilin amendament. Atëherë, po vazhdoj, amendamenti 1. Atëherë, po vazhdoj, amendamenti 1. Jo s'mund të mos i lexoj. Atëherë, po e lexoj veç amendamentin pa arsytim. Amendamenti 1. Neni 24 i projektligjit, ku flitet për shtesat për kushte të tregut, të ndryshohet si në vijim: shtesa përcaktohet në mënyrë nominale me përqindje sikur që është përcaktuar te shtesa për të zgjedhurit, neni 23, shtesa funksionale për nëpunësit e arsimit universitar neni 32, dhe shtesa për nëpunësit e sistemit shëndetësor, neni 23.

Atëherë, kush është për amendamentin e parë të deputetit Rashit Qalaj? Kush është kundër? Konstatoj se me 3 vota për, 6 kundër, ky amendament nuk kalon.

Vazhdojmë me amendamentin numër 2. Neni 26, paragrafi 2 i projektligjit, shtesa për kushtet specifike të punës të ndryshohet si në vijim: shtesa e përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni është deri në 50% e pagës bazë. Kush është për amendamentin 2, të deputetit Rashit Qalaj? Kush është kundër? Konstatoj se 3 vota janë për, 6 kundër. Ky amendament nuk kalon.

Vazhdojmë te amendamenti 3. Neni 36 i projektligjit, kompensimi për kujdestari, punën gjatë natës dhe jashtë orarit të punës të ndryshohet si në vijim: të fshihet paragrafi 2 i nenit 36 i këtij projektligji, i cili paraqet kufizim të kompensimit vetëm në përqindje prej 1% të fondeve totale të organizatës buxhetore. Kush është për amendamentin numër 3 të deputetit Qalaj? Kush është kundër? Konstatoj se me 3 vota për, 6 kundër nuk kalon.

Vazhdojmë te amendamenti numër 4. Shtojca numër 5 e draftligjit, grupi dhe klasa për stafin e uniformuar të ndryshohet si në vijim: të gjitha pozitat të përcaktohen në së paku 7 kategori, të cilave duhet t'u caktohet rrezikshmëria nga 20 deri në 50% apo të rrikategorizohen në kuadër të

përcaktimit të koeficientit të bëhet një harmonizim mes gradave në dy institucionet, atë të policisë dhe të Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Kush është për amendamentin numër 4 të deputetit Qalaj? Kush është kundër? Konstatohet që me 3 vota për, 6 kundër, nuk kalon amendamenti numër 4.

Vazhdojmë me amendamentin numër 5. Shtojca numër 8 e projektligjit, nëpunësit e shërbimit civilë, nëpunësi i administratës së shërbimit publik dhe nëpunësitë teknikë dhe mbështetës të ndryshohet si në vijim: stafi në kuadër të policisë, përfshirë pozitat profesional 1, profesional 2 dhe profesional 3, për shkak të specifikave duhet të jetë i ranguar në nivelin e njëjtë me stafin e gjykatës dhe të prokurorisë siç është bërë në stafin në gjykatave dhe të prokurorisë. Kush është për amendamentin numër 5 të deputetit Qalaj? Kush është kundër? Konstatohet që me 3 vota për, 6 kundër, ky amendament nuk kalon.

Amendamenti i 6. Në këtë projektligj të shtohet edhe një nen, ku të gjithë pjesëtarëve të policisë t'u paguhet shujta ditore dhe udhëtimi të gjithë atyre që udhëtojnë larg vendbanimit për të cilët nuk ka mundësi t'u sigurohet udhëtimi nga institucionet.

Isak Shabani: Unë e arsyetoj këtë amendament.

Kryetari, Valon Ramadani: Po s'është amendament yti, ky është i Rashit Qalajt.

Isak Shabani: S'ka lidhje, unë arsyetoj. S'po e di a jeni të vetëdijshëm për çka votohet. Po kemi debatuar për njëri-tjetrin, gjithmonë e kemi përkrahur.

Kryetari, Valon Ramadani: OK! Fjalën e ka deputeti Shabani. Urdhëro!

Isak Shabani: Të nderuar kolegë, po e dini për çka është fjala, nuk po dua ta banalizoj, për policë të Kosovës. Po kërkojmë t'ua sigurojmë një shujtë, të garantohet me këtë projektligj. E dimë se në çfarë gjendje janë policët e Kosovës sot. Unë apeloj ta votojmë bile këtë amendament.

Kryetari, Valon Ramadani: Faleminderit, i nderuar deputet Shabani! Kush është për amendamentin numër 6 të deputetit Qalaj? Kush është kundër? Konstatohet se me 3 vota për, 6 kundër, ky amendament nuk kalon.

Amendamenti numër 7. Të caktohet vlera e koeficientit me qëllim që të dihet saktë se cila do të jetë paga bazë. Kush është për amendamentin numër 7 të deputetit Qalaj? Kush është kundër? Konstatohet se me 3 vota për, 6 kundër, ky amendament nuk kalon.

Amendamenti numër 8, shtojca 14.4, ekspertët të shtohen dhe ekspertët në uniformuar. (Policia). Kush është për amendamentin numër 8 dhe të fundit të deputetit Rashit Qalaj? Kush është kundër? Konstatohet se me 3 vota për, 6 kundër nuk kalon amendamenti i deputetit Qalaj.

Vazhdojmë deputeti Jahja Kokaj. Ka propozuar amendament për Projektligjin për pagat në sektorin publik. Ju lutem për vëmendje! Amendamenti numër 1. Propozoj që të rritet numri i koeficienteve të pagës për 1.5 për prof. asistent, prof. i asociuar, prof. ordiner, si dhe të rritet koeficienti për 1 për fizikanët që punojnë në Radiologji, QKUK. Kush është për këtë amendament të deputetit Kokaj? Kush është kundër? Konstatohet se me 2 vota për, 6 kundër, ky amendament nuk kalon. A ka mundësi 20 sekonda veç të mbushna frymë pak! Jemi si ka fundi.

Atëherë, unë po vazhdoj t'i lexojë amendamentet që i ka propozuar Qeveria. Nëse ka diçka prej Qeverisë, koment, ose deputetëve...Urdhëro! Ja ky është Qeveria. Amendamenti 1 i propozuar nga Qeveria, neni 3 i Projektligjit nr.08/L-196 për paga në sektorin publik paragrafi 3 riformulohet si në vijim: shprehjet, termat dhe shkurtesa e përdorura në këtë ligj kanë të njëjtin kuptim me atë të përcaktuar me ligjin përkatës për zyrtarët publik dhe legjislacionin tjetër në fuqi.

Arsyetim

Me qëllim që të evitohen pasaktësitë në përdorim të termave si dhe të jetë në harmoni me standardet e hartimit, propozojmë këtë riformulim të nenit.

Kush është për këtë amendament numër 1 të propozuar nga Qeveria? Faleminderit! Kush është kundër? Kush abstenon? Me 7 vota për ky amendament kalon. Vazhdojmë te amendamenti numër 2. Neni 7 të Projektligjit nr. 08/L196 për paga në sektorin publik, paragrafi 1 i shtohen fjalët si dhe legjislacionin relevant në fuqi me arsyetimin për arsye se fushëveprimi i projektligjit nuk mbulon vetëm zyrtarët publikë, është e nevojshme të shtohet fjalia e propozuar.

Kush është për amendamentin numër 2 të propozuar nga Qeveria? Kush është kundër? Abstenim nuk ka. Me 7 vota për kalon amendamenti numër 2. Vazhdojmë me amendamentin numër 3. Neni 26 paragrafi 4 i Projektligjit nr.08/L-196 për pagat në sektorin publik, fjala sipas nenit 40 fshihet, dhe zëvendësohet me fjalën sipas nenit 42. Kush është për amendamentin numër 3 të propozuar nga Qeveria? Kush është kundër? Kush abstenon? Me 7 vota për kalon ky amendament. Asnjë kundër, asnjë abstenim.

Amendamenti numër 4. Neni 36, paragrafi 4 i Projektligjit nr.08/L-196 për pagat në sektorin publik, riformulohet si në vijim: përjashtimisht nga paragrafi 3 i këtij neni, në situata emergjente Qeveria me vendim mund ta tejkalojë këtë kufizim, ose titullari, organi udhëheqës në Presidencën e Republikës së Kosovës, Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, sistemin

e drejtësisë, Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe institucionet e pavarura kushtetuese me vendim mund ta tejkalojë këtë kufizim.

Ky përjashtim duhet të jetë në harmoni me Ligjin përkatës për menaxhimin e financave publike. Kush është për këtë amendament? Pra, amendamentin numër 4. Kush është kundër? Kush abstenon? Me 6 vota për, 1 abstenim, ky amendament kalon.

Vazhdojmë me amendamentin numër 5. Neni 37, paragrafi 4 i Projektligjit nr.08/L-196 për pagat në sektorin publik riformulohet si në vijim: kushtet, mënyra, vlera e kompensimit dhe procedura për përfitimin e kompensimit sipas paragrafit 1 dhe 2 të këtij neni për nëpunësit në Presidencën e Republikës së Kosovës, Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, sistemin e drejtësisë, Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe institucionet e pavarura kushtetuese rregullohen me këtë ligj dhe me akt të veçantë të miratuar nga organet kompetente të institucioneve.

Kush është për amendamentin numër 5 të propozuar nga Qeveria? Kush është kundër? Kush abstenon? Atëherë, 6 për, 1 abstenim...Abstenim ishte Besniku! Në fund e çoi dorën. Edhe njëherë po përsëris votimin për amendamentin numër 5. Kush është për? Kush është kundër? Kush abstenon? Me 6 vota...Jo, s'votove tash. Unë isha duke e përcjellë. Tash në këtë të fundit që e përsërita, s'votove. Po deklarohet kundër. Atëherë, 6 vota për, 1 kundër, ky amendament me numër 5 i propozuar nga Qeveria kalon.

Vazhdojmë me amendamentin numër 6, shtojca numër 10.3. Kuvendi i Kosovës, shtohet pozita drejtues i lartë 2, klasa Q2, koeficienti 10, fusha e zbatimit në Kuvend. Pozicioni numër 3 këshilltari juridik në Kuvend dhe pozicioni numër 4, drejtues i ulët, ndryshojnë renditjen, klasat dhe numrat rinumërohen dhe rregullohen si më poshtë, tabelën po besoj që e shihni.

A ta lexoj edhe arsyetimin? Drejtues i ulët 2 është shtuar me qëllim që të reflektojë rregullimin e Kuvendit sipas Rregullores së Punës së Kuvendit përmes së cilës parashihet edhe drejtori i përgjithshëm. Meqenëse këshilltari juridik në hierarki është i kategorisë profesionale, rirendit nën drejtuesin e ulët.

Besnik Tahiri: Këtu duhet të diskutojmë pak. A bën një fjali?

Kryetari, Valon Ramadani: Po qysh s'bën o zoti deputet. Fjalën e ka Besnik Tahiri.

Besnik Tahiri: Këtu e kemi një problem i cili lidhet me pozitën e këshilltarëve juridikë. Tash, në qoftë shkojmë te shtojca qysh e kemi pasur, ua kemi zvogëluar rrogën. Unë jam në rregull ta barazoni se unë kam folur në Kuvend, Kuvendi me Presidencën, mirëpo jam kundër, se tash po bie ndesh propozimi që është diskutuar në debat publik, që është trajtuar në platformën për konsultim publik, që prezantuar dhe votuar në lexim të parë.

Tash po biem ndesh me koeficientit që e keni pasur. Ju barazoni Kuvendin, po mos i zvogëloni te këshilltarët juridik. Pse? Shikoni për shembull, në qoftë se shkojmë te Avokat i Popullit, në qoftë se shkoni te shtojca e Avokatit të Popullit. Po s' e keni, s' besoj që e keni këtë tabelën.

Renditja e këshilltarëve juridikë është më e madhe. Te Gjykata Kushtetuese e ke më të lartën. Tash pse vëlla po bëjmë diskriminim? Pse? Mbi cilin argument? Mbi cilën bazë? Te kushtetuesja e ke prej 8 deri 14 dhe tek Avokati 8 deri 9. Unë jam në rregull, unë jam për që të barazohet Presidenca me Kuvendin, e kam thënë në seancë, por jam kundër për shkak se është e padrejtë. Këtë nëse mund ta lini te koeficienti 8. Kaq.

Kryetari, Valon Ramadani: Tash është momenti i Qeverisë që ta sqarojë. Fjalën e ka Meliza.

Meliza Qorraj: Fillimisht, Kuvendi nuk mund të jetë në hierarki të njëjtë me Presidencën, sepse nuk janë institucione të barasvlershme. Kuvendi është në hierarki të njëjtë me Qeverinë, Ekzekutivin, edhe me Gjykatën Supreme që përfaqëson gjyqësorin. Në këtë rast, janë tri pushtete të barabarta të cilat krahasohen mes vete me mandate dhe kompetenca të ndryshme, po që balancojnë njëra-tjetrën.

E dyta, këshilltarët juridikë në Gjykatën Kushtetuese nuk janë shërbyes civilë ndryshe prej këshilltarëve juridikë në Kuvend. Ata janë nën kompetencat e drejtpërdrejta të kryetares së Gjykatës Kushtetuese dhe për aq sa vlerësojnë që është nevojshme zbatojnë rregullat e shërbyesve civilë, por sipas Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese, këshilltarët juridikë në Gjykatë Kushtetuese nuk janë shërbyes civilë dhe nuk krahasohen në asnjë moment me këshilltarët juridikë në Kuvendin e Kosovës.

E kemi bërë ndryshimin, propozimi ka ardhur për arsye se këshilltari juridik me aq sa e keni parë në rregullimin e Rregullores së fundit që është miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, rregullimi është i atillë që e parasheh strukturën; Sekretari, Drejtori i Përgjithshëm, Drejtorja dhe Njësia. Ndërsa për neve, që të jemi në harmoni me gjithë legjislacionin dhe me të gjitha shtojcat, kategoria e këshilltarit juridik është kategori profesionale. Nëse është ndryshe, ju lutem të na njoftoni.

Kryetari, Valon Ramadani: Unë mendoj që sqarimi ishte shumë i qartë. Ku ka pasaktësi?!

Bekim Haxhiu: Bashkëpunëtori profesional në gjykatë edhe në prokurori e ka koeficientin 8.5, nëse po thotë Qeveria që këto duhet të jenë në nivel të balancuar, Kuvendi, Qeveria, Gjykata Supreme. Bashkëpunëtori profesional në këto institucione e ka koeficientin 8.5, Qeveria tash ka propozuar këtu për këshilltarin juridik në Kuvend, pra, që është bashkëpunëtori profesional më i lartë 7.5, një koeficient më poshtë. Tash, një bashkëpunëtor profesional në gjykatë dhe prokurori

jep mendime për zbatimin e ligjeve ose shkeljeve ligjore të mundshme gjatë një procesi që ka ndodhur. Por, këshilltari juridik i Kuvendit jep vlerësime për ligjet do t'i zbatojnë ata prokurorë, gjykatës edhe bashkëpunëtorë profesionalë.

Nuk mund të nënvlerësohen bashkëpunëtorët profesionalë dhe këshilltarët juridikë në Kuvend në këtë nivel, sepse s'vjen askush që këto ligje kështu të na i lexojë dhe të na japë komente të cilat po na duhen neve si deputetë që të japim vlerësime. Kjo ishte e para.

E dyta, dallimi që është propozuar tash rishtas prej Qeverisë, drejtuesi i mesëm me drejtuesin e ulët është vetëm 0.6 e koeficientin, por dallimi tjetër, shiko në faqen tjetër, mes këshilltarit juridik që është gjithashtu bashkëpunëtor profesional, sepse po thotë, këshilltari juridik në hierarkinë e kategorisë profesionale me profesional 1, është 1.65, është dallim shumë i madh. Shumë i madh është ky dallim. Korrigjoheni, ju lutem!

Mirë. Faleminderit Qeveri që i keni sjellë edhe këto kategoritë e reja që janë, por korrigjohini, të mos lini këshilltarë juridik, bashkëpunëtor profesional në Kuvend të Republikës së Kosovës nën këtë nivel, nën 8.5, sepse s'na rri askush. Kush do të vijë me 4.3 t'i shqyrtojë ligjet këtu?! Ju lutem!

Kryetari, Valon Ramadani: I fundit për diskutim është Besnik Tahiri, pastaj shkojmë në votim.

Besnik Tahiri: Faleminderit! Shikoni, ta trajtojmë pak. Argumentet që i dha Meliza, për vlerësimin tim nuk qëndrojnë. E para, statusi i një zyrtari publik në shtet, në të gjitha institucionet shtetërore i rregullon një ligj, dhe ai ligj është Ligji për zyrtarët publikë. Ai ligj e rregullon edhe statusin e pagës së personelit në Gjykatën Kushtetuese për shkak s Ligji për paga e parash tek shtojca e Gjykatës Kushtetuese e parashet këshilltarin nga koeficienti 12 deri në 8.

Kryetari, Valon Ramadani: Ju lutem qetësi, se nuk po dëgjohet deputeti!

Besnik Tahiri: Në qoftë se Ligji për zyrtarë publikë e rregullon funksionin e një zyrtari të shtetit dhe derivat i këtij ligji pastaj vjen Ligji për paga, i cili në tabelën e vet e përcakton koeficientin e zyrtarit në fjalë. Kjo nënkupton që statusi është i veçantë. Meliza po i referohet aspektit të llogaridhënies. Po thotë, llogaridhënia dhe përgjegjësia e një këshilltari në Gjykatë Kushtetuese është më e lartë sesa e një këshilltari, i cili rregullon ligjëbërjen për deputetët.

Tash në hierarkinë llogaridhënëse deputeti, ajo që quhet principal teory, teoria e palës kryesore, deputetët janë pala kryesore e të gjitha institucioneve, edhe të atyre që votohen nga ky institucion. Derivat i palës i kryesore, i Kuvendit, është kryetarja e Gjykatës Kushtetuese. Domethënë, në hierarkinë e llogaridhënies shtetërore, të teorisë së palës kryesore, që është teoria që e rregullon politikën publike, dhe politika publike e prodhon ligjin, në hierarki është më i lartë

Kuvendi dhe deputeti se kryetari i Gjykatë Kushtetuese për shkak se ne e zgjedhim këtë institucion dhe këta njerëz. Pra, ky argument nuk qëndron.

Dhe, pastaj, për shembull, po e bëj një digresion të shkurtër, Valon. Digresioni i shkurtër, për shembull, Kodi Penal mund të mos na nevojitet kurrë asnjërit prej nesh, po Kodi Civil na nevojitet të gjithëve për shkak se e rregullon jetën civile. Sikurse Gjykata Kushtetuese në 10% të çështjeve, 99% të çështjeve nuk janë në trajtim në Gjykatë Kushtetuese përderisa legjislacioni që e rregullon funksionimin e jetës prej qytetarit e deri te Gjykata Kushtetuese, janë çështje që e prekin ekspertizën që buron prej një këshilltari juridik. Andaj, ky argument nuk qëndron. Dhe e fundit, që vlerësimin tim është argumenti më i fuqishëm. Në qoftë se kjo logjikë nuk paska qenë logjika e njëjtë, atëherë pse ne e kemi votuar në tabelë në leximin e parë këtë koeficient? Dhe, a ka pasur këtu, domethënë, cili ka qenë ndikimi.

Unë jam për ta barazuar, dhe nuk pajtohem assesi që Kuvendi është kategori me Qeverinë e Kosovës. Nuk mund të jetë Kuvendi i kategorizuar me Qeverinë, kur Kuvendi është shefi, është pala kryesore, tash e Qeverisë. Nuk është ky barazim. Kuvendi është i zgjedhur dhe Rregullorja është me 2/3 sikurse që zgjidhet presidentja. Për këtë arsye ky institucion i rrinë karshi, pandam këtij institucioni, dhe unë kërkoj prej deputetëve që ta trajtojnë këtë çështje prej kësaj perspektive.

A mund ta dimë për çka po flasim. Veç t'jua shpjegoj tash numerikisht për çka po flasim. Po flasim për tetë njerëz, po flasim për 0.5, në qoftë se është 120, 0.5 në 120 është 60, 6 herë 8 bëjnë 48 a po, 48 e 12 sa bëjnë, 6 000 mijë euro. Po flasim, të nderura deputetë, për 6 mijë euro. Për kaq jemi duke folur. Faleminderit!

Kryetari, Valon Ramadani: Faleminderit, i nderuar deputet për sqarimin! Atëherë, kërkoj votën ose po e qes në votim. Tash e kemi sqaruar. E lexova amendamentin, u ngrit çështja, u sqarua edhe njëherë prej Besnikut. Mendoj që tash është momenti i votimit. Kush është për amendamentin numër 6 të propozuar nga Qeveria? Kush është kundër? Abstenim s'ka. Atëherë, konstatoj që me 6 vota për, 2 kundër, ky amendament miratohet.

Vazhdojmë me amendamentin numër 7, shtojca numër 13, zyrtarët dhe nëpunësit e Kabinetit mes pozicionit numër 8 dhe 9, shtohet edhe pika 8 a këshilltar politik 1, shef Kabineti klasa c 8a, koeficienti 9.8, fusha e zbatimit në komunë, si në vijim: këshilltar politik 1, legjislacioni në fuqi parasheh edhe kategorinë e shefit të Kabinet të kryetarit të komunës, andaj i njëjti është shtuar. Kush është për amendamentin numër 7 të propozuar nga Qeveria? Kush është kundër? Abstenim? Atëherë, me 6 vota për, 1 abstenim, miratohet amendamenti numër 7.

Vazhdojmë me amendamentin numër 8, shtojca numër 9, nëpunësi publik i sistemit shëndetësor tek pozicioni numër 11, tek emërtimi i pozicionit, shtohet edhe psikolog klinik specialist.

Arsyetim

Sipas Ligjit nr.04/L-125 për shëndetësi neni 69, paragrafi 1, nënparagrafi 1.3 parasheh edhe psikologun klinik specialist. Kush është për amendamentin? Urdhëro?! Një koment. Fjalën e ka deputeti Haxhiu. Veç pak se nuk e nxora në votim hala. S'ka problem. Një koment e ka deputeti Haxhiu.

Bekim Haxhiu: Dëgjo! Asgjë personale nuk kam askënd këtu, kam ardhur që ta jap mendimin tim. Politikë bëjmë në seancë, s'ka problem edhe i arsyetojmë. Cila është logjika t'i votojmë psikologë klinikë të një fushe e t'ua pamundësojmë të drejtën të tjerëve të jenë, të mos ua vlerësojmë shkollimin.

Dikujt po do t'i vlerësosh që e ka kryer shkollën e njëjtë, po do t'ia vlerësosh edhe specializimin, e dikujt tjetër, nuk po do.

Kryetari, Valon Ramadani: Deputet ti do t'i diskutosh në amendamentet tuaja në seancë.

Bekim Haxhiu: Po, mirëpo ju e propozoni o kolegu im! Ky komision duhet të tregojë paksa integritet, përndryshe nëse Qeveria i sjellë ligjet kështu dhe çka thotë Qeveria votojnë deputetët, atëherë po e zhvlerësoni vlerën tuaj si deputetë edhe të këtij komisioni.

Kryetari, Valon Ramadani: Po ne jemi deputetë të kësaj Qeverie. Ajo mazhorancë është, nuk është dallim.

Bekim Haxhiu: Për nder, unë i kam kundërshtuar këto gjëra edhe kur kam qenë pjesë e mazhorancës nuk jam pajtuar kur dikush ka dashur ta bëjë një pabarazi kaq të madhe në sistem shëndetësor. Nuk jam pajtuar.

Kryetari, Valon Ramadani: Zoti Haxhiu, këto ndryshime që jemi duke i votuar tash, këto janë duke rezultuar pas dëgjimit publik që ishim bashkë atë ditë deri sot, nuk është krejt versioni që ka qenë atë ditë.

Bekim Haxhiu: Shiko i nderuar kryetar! Projektligjin e kam përpara, koeficientet që i ka propozuar Qeveria i kam përpara, kategorizimin përpara, është një propozim i ri ku po doni ta fusni edhe specialistin e psikologjisë klinike, OK!

Kryetari, Valon Ramadani: A jemi duke bërë mirë?

Bekim Haxhiu: OK që po doni ta fusni, por pse po ia mohon tjetrit shkollimin? Pse nuk është fizioterapeuti specialist? A mundet dikush prej Qeverisë të më tregojë?

Kryetari, Valon Ramadani: Edhe një komente shtesë po kërkohet prej Qeverisë. A do dikush të flasë? A vazhdojmë, deputet? Atëherë, po vazhdojmë me votimin e amendamentit numër 8. Kush është për? Kush është kundër? Abstenim nuk ka. Me 6 vota për, miratohet.

Amendamenti 9, shtojca numër 9, nëpunësi publik i sistemit shëndetësor tek pozicioni numër 19, tek emërtimi i pozitës shtohet edhe psikolog klinik në specializim.

Arsyetim

Sipas Ligjit nr.04/L-125 për shëndetësi neni 69, paragrafi 1, nënparagrafi 1.3 parasheh edhe psikologun klinik në specializim. A pati dikush pyetje? Zëvendësministër, urdhëro!

(Ndërprerje e incizimit)

Vazhdojmë me votimin. Nuk ka koment shtesë. Kush është për amendamentin 9 të propozuar nga Qeveria? Kush është kundër? Abstenim? Nuk ka. Me 6 vota për, asnjë kundër, asnjë abstenim, miratohet edhe amendamenti 9.

Tash i kemi edhe nja dy amendamente që i propozojmë. Kështu, propozim për Ligjin për paga në sektorin publik, shtojca 5.2, Inspektorati Policor i Kosovës, amendamentohet, shtohet pozita numër 1, drejtues i lartë, klasa f1, koeficienti 12, dhe tabela duket si në vijim: drejtues i lartë 12, drejtues i mesëm 8.5, drejtues i ulët 8, hetues inspektor 7.5.

Kam përshtypjen që kjo ka qenë lëshim prej Qeverisë ose prej ministrisë. A ka ndonjë sqarim? Po, ka sqarim prej ministrisë.

Meliza Qorraj: Draft i Ligjit për paga ka qenë gjatë gjithë kohës duke u tentuar të harmonizohet me draftin që e ka punuar grupi i Ligjit për zyrtarë publikë. Në fund fare e ka ndryshuar grupi i Ligjit për zyrtarë publikë, kategorizimin e Inspektoratit, por pa dashje nuk është reflektuar te Ligji për paga, dhe për këtë arsye duhet tashmë ta ketë reflektim te drejtuesit e lartë, sepse nuk është në shtojcën e Inspektoratit. Që të mos mbesë pozita e kryeshefit të IPK-së e pambuluar.

Kryetari, Valon Ramadani: Është fjala për IPK-në. Besoj që e keni të qartë deputetë. Nëse s'ka diskutim tjetër, unë kisha kaluar në votim të këtij amendamenti. Kush është për amendamentin për Inspektoratin e Policisë së Kosovës, IPK-në?

Atëherë, me 7 vota për, asnjë kundër, asnjë abstenim, ky amendament miratohet. E kemi edhe një amendament tjetër, që në fakt dje është diskutuar, në fakt, edhe prej Besnikut është ngritur si temë edhe prej disa deputetëve, s'po më kujtohet kush. Po mendoj që është mirë të formulohet kështu: neni 6, nëse mund ta gjeni ligjin, neni 6, paragrafi 6 i Projektligjit për pagat ndryshohet dhe fshihet fjala, në sektorin publik. Paragrafi pas ndryshimit duket kështu: paga bazë rritet në bazë të përvojës së punës në masën 6.1, 0.25% për çdo vit pune deri në 15 vjet punë, dhe 6.2, 0.5% për çdo vit të plotë pune mbi 15 vjet punë. E keni parasys, besoj që dje jemi pajtuar gati secili prej nesh.

Ata që vijnë prej sektorit privat t'u njihet përvoja e punës. Në këtë rast ka qenë e ndaluar, e tash ne veç e lejojmë.

Jo, jo s'po më kupton! Edhe njëherë po e sqaroj. Përvoja e punës të njihet, te shtesat është fjala. Për shtesa për përvojë të punës, t'i njihet edhe atij që ka punuar në sektorin privat. Kam përshtypjen që ky amendament do të votohet prej krejt deputetëve! Kush për amendamentin e propozuar? Kush është kundër? Abstenim s'ka. 7 vota për. Urdhëro!

Na ka mbetur edhe disa çështje prej Zyrës...Një përgjigje Meliza për deputetin Haxhiu.

Meliza Qorraj: Universiteti konsiderohet si administratë e shërbimit publik, sekretari është i pozicionuar te shtojca 10.6, kategoria drejtues i lartë 2 në agjencitë ekzekutive dhe administratë të shërbimit publik. Shtojca 10.6, pozicioni, klasa 4, koeficienti është 12, është drejtues i lartë, sipas klasifikimit të vendeve të punës.

Kryetari, Valon Ramadani: Më falni, ku kërkoj te Inspektorati, në fakt kanë qenë 2 amendamente, jo 1, unë e lexova veç të parin. I dyti është kështu... Më fal, mendova që po më thua mua, deputet. Se unë e lexova, thatë, a je i sigurt. Thashë, po. Po vazhdojmë, te shtojca numër 10, shtohen edhe dy fusnota dhe në fund të fjalisë shtohet edhe sqarimi si më poshtë: në këtë kategori përfshihen edhe të punësuarit në agjenci ekzekutive edhe agjenci të shërbimit publik, por që përjashtohen nga fushëveprimi i ligjit përkatës për zyrtarët publikë dhe punonjës...Më fal edhe njëherë! A ta lexoj edhe njëherë prej fillimit bre?!

Në këtë kategori përfshihen edhe të punësuarit në agjenci ekzekutive edhe agjenci të shërbimit publik, por që përjashtohen nga fushëveprimi i ligjit përkatës për zyrtarët publikë dhe punonjës apo ata që zbatojnë rregullat e shërbimit civil. A ka dikush ndonjë koment? Unë ia dorëzoj edhe me shkrim Mirjetës këtë që t'ua dorëzojë komisioneve të tjera.

Nëse ka nevojë që ta lexoj edhe njëherë, mundem më ngadalë, se ndoshta kam shkuar shpejt, por ato tjerat i keni pasur të shtypura e këtë nuk e patët. Nuk ka nevojë apo? Kush është për këtë amendamentin e dytë të IPK-së? Kush është kundër? Abstenim s'ka. 6 vota për. Ecim tutje.

Na ka mbetur edhe raporti i analizës së projektligjit. Atëherë kështu, aspekti formale-juridik, po i bie sikurse te ato falënderimet që ishin dje te ato të tjerat, struktura e projektligjit. A dalim te këto rekomandime lidhur me përmbajtjen e projektligjit, strukturën dhe formulimin gjuhësor-juridik. Vërejte të përgjithshme. Nuk janë identifikuar vërejtje të theksuara të cilat do të kishin nevojë që të paraqiten në këtë pjesë të raportit me përjashtim të disa të metave teknike, të cilat nuk u janë përmbajtur udhëzimit administrativ numër 03/2013 për standardin të akteve normative, si dhe numrat duhet të shkruhen me shkronja, ndërsa numrat e vendosur në kllapa, nenet kanë më shumë paragrafë sesa e parasheh ky udhëzim administrativ.

Po ashtu, përkundër që nenin 3, të paragrafit 2 të këtij ligji thuhet që përdorimi i emrit në njërën gjini nënkupton edhe gjininë tjetër. Është respektuar pothuajse në tërë tekstin e projektligjit, sikurse që nyjat nuk janë përdorur drejtë në gjini apo edhe diku po e diku jo, konsiderojmë që këto vërejtje duhet marrë parasysh gjatë takimit të grupit punues me qëllim që të shmangen këto të meta dhe ligji të miratohet në përputhje edhe me udhëzimin e lartpërmendur.

4.2, vërejtje konkrete.

Neni 6, paga bazë, propozojmë që pas paragrafit 6 të këtij neni të shtohet një paragraf i ri 7, me këtë përmbajtje: e drejta në përvojën e punës, e fituar sipas dispozitave të Ligjit nr. 03/L-149 për shërbimin civil të Republikës së Kosovës dhe të Ligjit për zyrtarët publik, i ndryshuar dhe plotësuar në ligjin do të ruhet edhe sipas këtij ligji. Pra, vërejtjet tona i referojmë në parim prapa veprimet që nënkupton një e drejtë e fituar nuk mund të mohohet. Edhe Avokati i Popullit ishte referuar në këtë parim në opinionin e vet, në lidhje me ditët e pushimit, opinionin e Avokatit të Popullit lidhur me llogaritjen e pushimit vjetor në bazë të përvojës së punës.

Këshilltarët e dëgjojnë sqarimin tuaj, edhe ne e dëgjojmë.

Meliza Qorraj: Te Ligji për zyrtarët publikë, te dispozitat kalimtare, themi që përvoja punës e fituar me Ligjin për shërbimin civil dhe Ligjin për zyrtarë publikë, ruhet edhe sipas këtij ligji, edhe meqenëse u amendamentua tashmë neni 6, paragrafi 6 edhe u fshi pjesa e përvojës së punës vetëm në sektorin publik, kjo veçse është e nënkuptueshme. Domethënë, ruhet. Ideja është që ligji e ruan përvojën e punës të fituar edhe sipas legjislacionit tjetër. Jemi në të njëjtën linjë me rekomandimin e...

Faton Hamiti: Të nderuar deputetë, është mirë pak të flas.

Kryetari, Valon Ramadani: Fjalën e keni ju. Jemi te pika 4.2.

Faton Hamiti: Nëse ka mundësi të flas pak për vete, sepse dua shkurt t'i bie. Kjo drejtori për të cilën ju po flisni sot, keni parasysh, është krijuar me vendim të Kryesisë së Kuvendit, me

aprovim të Ministrisë për Administratë Publike. Tash, po dua t'i tregoj do gjëra që i kryejmë ne, e le ta sjellë përshkrimin e vendeve të punës të atyre në institucione të tjera.

Që nga parashtrimi i projektligjit e deri në publikim në Gazetën Zyrtare, ne jemi përgjegjës që e bëjmë, ne. Tash ju vlerësojeni. Ne përfaqësojmë institucionin e Kuvendit në gjykata. më thoni ku përfaqësojnë ata që i përmendet ju, përveç këshillave që i japin. Jeni të pa njoftuar, e shoh që jeni të pa njoftuar, sepse jeni futur në lajthitje nga njerëz të caktuar.

Përfaqësimi i zyrtarëve në komisione hetimore dhe ad hoc. Ne përfaqësojmë zyrtarë në komisione hetimore dhe ad hoc. Mbështetje të delegacioneve në organizata ndërkombëtare. Ne i mbështesim delegacionet e Kuvendit të Kosovës, japim këshilla në organizata ndërkombëtare. Mund t'jua jap edhe këtë. Në Këshillin e Evropës, në Asamblenë Parlamentare, unë i nderuar, bashkë me kolegë përfaqësoj, ndoshta ju duket pak e çuditshme...

Kryetari, Valon Ramadani: Po dua një ndërhyrje kështu. Këto që ti po i thoni tash, këto gjëra është dashur të thuhesh në dëgjim publik.

Faton Hamiti: Dëgjo! Ne jemi të vëmendshëm, të kujdesshëm për shkak se në dëgjime...

Kryetari, Valon Ramadani: Se nëse tani flet për çështje që ti direkt punon për të, për mua është konflikt interesi. Për mua është konflikt interesi nëse ti flet çka punon ti. Duhet dikush tjetër të flasë.

Faton Hamiti: Në dëgjime publike është për publikun, ne jemi ata që vijmë nga jashtë institucioni...

Kryetari, Valon Ramadani: Mirë. Vazhdo përfundoje.

Faton Hamiti: Para dëgjimit publik ka qenë ndryshe, ka qenë 8. Merre shikojeni. Por, opinionet ligjore kur i referoheni në seancë dhe kudo, kërkojmë opinion ligjor prej Zyrës Ligjore, nuk ka Zyrë Ligjore, këshilltarët juridikë jemi ne që e bëjmë. Ta keni parasysht.

Neve na referoheni, të nderuar deputetë, jo dikujt tjetër, s'ka Zyrë Ligjore. Të ma dëshmojë dikush tjetër ku është Zyra Ligjore, përveç neve 6-7 që jemi që i kërkonim çdo moment. Tash ta keni parasysht që ju na keni degraduar si institucion së pari me Avokatin e Popullit, Gjykatën Kushtetuese. Nëse ju lejoni që stafin tuaj, nuk po themi të privilegjohemi, nuk po themi të na jepni mbështetje, por së paku ju deputetë duhet ta kuptoni rëndësinë që ka kjo.

Ne këto që i kemi bërë, i bëjmë, të garantoj që ata asnjëri s'punojnë jashtë orarit, të gjithë kanë toleranca në kohë. Tash, veç ta keni parasysht nuk ka të bëjë më shumë me pagë, se 30-40 ose 50

euro, degradimi, integriteti është në pyetje. E ju nëse e keni vlerësuar kështu, ju kërkoj, prapë keni mundësi që ta ndryshoni. Përndryshe, të më besoni që ndryshe ka qenë, kush ka ndërhyrë, le ta marrë përgjegjësinë. Shikojeni siç ka qenë.

Edhe në kuadër të vendimit të Kryesisë, ne kemi qenë në nivelin e njëjtë drejtues. Merreni dhe shikojeni, vendimet i kemi. Çka po themi ne është 100%, nëse dikush dyshon, urdhëroni pyetni. Me vendimin e administratës publike, këta që sot e mbrojnë, këta e kanë miratuar atë, kërkesën e Kryesisë. E njëjta kërkesë e Kryesisë është dërguar në emër të Sekretarit të Kuvendit.

E vetmja drejtori që e ka reformuar institucionin e Kuvendit të Kosovës, që kur është themeluar është kjo drejtori, dhe nga kur është themeluar, gjërat kanë ndryshuar në institucion. Ju nëse doni ta degradoni, ju lutem, të na hapni rrugë. Nëse flisni për brain game jeni duke folur për brain..., sepse jeni duke i humbur.

Dy veta e kanë lëshuar punën, të tjerët janë duke ndenjtur, nëse themi në gjuhë popullore, këmbëkacel, veç me ecë, sepse jemi degraduar. Nuk është te paga, është te niveli që ne dinjitet nuk kemi nëse ju nuk na çmoni, të mos presim dikush tjetër. Faleminderit! Nëse vërejtjet i doni, ne e vazhdojmë punën deri sa të jemi, kur s'jemi...

Kryetari, Valon Ramadani: S'ka problem, ne po i shqyrtojmë krejt këto që na kanë ardhur me shkrim. Tash jemi te vërejtja konkrete, neni 6. Jo, kjo përfundoi, por ne duhet...

Vazhdojmë te neni 26, shtesa, kushtet specifike të punës. Propozojmë që të verifikohet nga sponsorizuesi nëse referenca në paragrafin 4, të nenit 26 në nenin 40 është e saktë. Është korrigjuar, vazhdojmë tutje.

Në rrethana të veçanta. Zyrtarët publikë dhe kategoritë e tjera të të punësuarve që paguhen nga buxheti i shtetit, përjashtimisht funksionarëve publikë, përfitojnë edhe pagesa të tjera në rrethana të veçanta, dhe atë: kompensim me rastin e pensionimit, shpërblim jubilar çdo 10 vjet, kompensim për familjen në rast të vdekjes së zyrtarit publik dhe vdekjes së një anëtari të ngushtë të familjes së zyrtarit publik. Rregullohet edhe me të tjera ligje.

Next, kompensim për pensionim. Zyrtari publik që arrin moshën e pensionimit gëzon të drejtën e marrjes së një kompensimi në shumë prej 1 page bazë mujore të njehershme në vlerën e pagës së fundit bazë.

Shpërblimi i përvjetorit jubilar. Zyrtarët publikë të cilët janë në marrëdhënie të vazhdueshme pune u takon një shpërblim në vlerë prej 25% të pagës bazë pas çdo 10 vjetësh punë. Qeveria, deputetë? Vazhdojmë tutje.

Neni 44. Ndhimja për familjet në rast të vdekjes së zyrtarit publik dhe vdekjes së një anëtari të ngushtë të familjes së zyrtarit publik. Në rast të vdekjes së një zyrtari publik, familja e zyrtarit publik ka të drejtë të marrë pagesë të njëhershme në vlerë prej 1 page mujore bazë që i paguhet bashkëshortit ose bashkëshortes të zyrtarit publik ose anëtarit tjetër më të afërt të zyrtarit publik. Qeveria?

Meliza Qorraj: Ndoshta ka nevojë për një sqarim; si Qeveri nuk jemi kundër, si ministri që e kemi sponsorizuar ligjin nuk jemi kundër për asnjërin prej këtyre, por këto s'paguhen prej kategorisë paga dhe mëditje dhe për këtë arsye nuk e kanë vendin në Ligjin e pagave. Këto janë kompensime të cilat ndoshta më shumë do të duhej të bëheshin përmes dialogut social që veç do ta zhvillojë Ministria e Financave dhe të bëhet me Kontratë Kolektive ose diçka të ngjashme, por te Ligji i pagave nuk e kanë vendin.

Kryetari, Valon Ramadani: Vazhdojmë te pika 2. Në rast të vdekjes së një anëtari të ngushtë nga zyrtari publik, institucioni punëdhënës ndihmon zyrtarin publik me një pagesë të njëhershme në vlerë prej një page mujore bazë. Edhe kjo vlen njëjtë.

Vërejtjet e tjera eventuale do të adresohen gjatë grupeve punuese. OK! Disa nga vërejtjet nuk janë adresuar në raport, sepse shumica prej tyre vetëm janë adresuar në aktorë relevantë gjatë dëgjimit publik, sikurse janë dërguar tek Sekretaria e komisionit dhe në atë shkruar. Andaj, kontributi ynë nuk do të mungojë në trajtimin e atyre vërejtjeve përgjatë grupit punues.

5. Vërtetje lidhur me versionin në gjuhën angleze dhe në gjuhën serbe. Të gjitha ndryshimet në versionin e projektligjit në gjuhën shqipe do të merren parasysh në gjuhën angleze. Raportin për gjuhën angleze e bëri Vjollca Sogojeva.

Vërejtje lidhur me versionin në gjuhën serbe. Të gjitha ndryshimet në versionin e projektligjit në gjuhën shqipe do të merren parasysh në gjuhën serbe. Raportin në gjuhën serbe e përpiloi Sheqir Muharremi.

A ka mbetur ndonjë çështje? Qeveria, deputet?! OK!

Kush është që projektligji me amendamentet e propozuara në Projektligjin për pagat në sektorin publik të procedohet për komisionet e përhershme për shqyrtim? Kush është për? Kush është kundër? Abstenim e ke a po? Për komplet ligjin. Abstenim.

Atëherë, 6 vota për, kundër s'ka, 1 abstenim, konstatoj që ky projektligj është përcjellë për komisionet e përhershme. E kemi kryer atë! Atëherë, unë ju falënderoj! Këtë mbledhje nuk po e mbylli apo, se e kemi edhe drekën. E kemi drekën për ta ngrënë. Faleminderit!

Këtë mbledhje e mbylli, e shihemi në mbledhjet e radhës. Faleminderit prej secilit për kontributin! Besniku tash, po më kujtohet që Dimali ka qenë abstenim për Ligjin për pagat, edhe zyrtarët publikë. Mirupafshim!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*